




Performanca e Shërbimit të Prokurorisë në Shqipëri: Vlerësim i Mekanizmave kryesorë për një Sistem Efiçent dhe Efektiv



Qershor 2023



Qendra
për Studimin
e Demokracisë
dhe Qeverisjes

Performanca e Shërbimit të Prokurorisë në Shqipëri:

Vlerësim i Mekanizmave kryesorë për një Sistem Efiçent dhe Efektiv

Autorë:

Mirsada HALLUNAJ

Anila DOLLANI

Jonida JANI

Rishikimi i brendshëm:

Arjan DYRMISHI

Dizajni dhe faqosja:

Ergys TEMALI

© Qendra për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes (CSDG)

Tiranë, Qershor 2023



Ky është dokumenti i katërt i përgatitur nga Qendra për Studimin e Demokracisë edhe Qeverisjes në kuadër të projektit: “Përmirësimi i Debatit të Politikave dhe Llogaridhënies në Përbushjen e Grupit të Parë të Kapitujve Negociues (Cluster 1), përmes Krijimit të Platformës së Negociatave BE-Shqipëri për Cluster 1 (C1-EU-NPA)”, mbështetur nga Ambasada e Mbretërisë së Vendeve të Ulëta në Tiranë

Opinionet, gjetjet, përfundimet dhe rekomandimet e shprehura në këtë dokument janë të autorit/ve dhe nuk reflektojnë opinionet apo pikëpamjet e Ambasadës së Mbretërisë së Vendeve të Ulëta në Tiranë.



Kingdom of the Netherlands



Përmbajtja

Tabela & Grafikë	6
Lista e Shkurtimeve dhe Akronimeve	7
Parathënie	8
Konteksti i Studimit	9
Standardet Ndërkombëtare dhe Metodologjia	10
Vlerësime dhe Rekomandime	11
I. PAVARËSIA E SHËRBIMIT TË PROKURORISË DHE PROKURORËVE	11
II. MBIKËQYRJA DHE LLOGARIDHËNIA E SHËRBIMIT TË PROKURORISË DHE PROKURORËVE	12
III. CILËSIA DHE EFIÇENCA E SHËRBIMIT TË PROKURORISË DHE PROKURORËVE	13
IV. TRANSPARENCA, INTEGRITETI DHE ETIKA E SHËRBIMIT TË PROKURORISË DHE PROKURORËVE	14
V. EFIKASITETI DHE PERFORMANCA E SHËRBIMIT TË PROKURORISË DHE PROKURORËVE	15
Organizimi i Sistemit të Prokurorisë në Shqipëri	16
I. Pavarësia dhe Paanësia	18
Tabela I/A Standardet ndërkombëtare në lidhje me Pavarësinë dhe Paanësinë	19
1.1. Garantimi ligjor i pavarësisë së Shërbimit të Prokurorisë dhe prokurorëve	20
1.2. Karriera e prokurorëve	20
1.3. Buxheti i Shërbimit të Prokurorisë	20
1.4. Pavarësia gjatë procesit penal	20
1.5. Mbrojtja e prokurorëve	22
Tabela I: Vlerësimi i Indikatorëve që lidhen me PAVARËSINË dhe PAANËSINË	23
2. Mbikëqyrja dhe Llogaridhënia	26
Tabela II/A Standardet ndërkombëtare në lidhje me Mbikëqyrjen dhe Llogaridhënien	27
2.1. Kompetencat e institucioneve në raport me shërbimin e prokurorisë	28
2.2. Raportimi periodik mbi aktivitetin e përgjithshëm të Shërbimit të Prokurorisë	30
2.3. Funkcionet mbikëqyrëse ose verifikuese të strukturave të brendshme të shërbimit të prokurorisë	36
2.4. Llogaridhënia ndaj sistemit të brendshëm mbikëqyrës dhe monitorues në shërbimin e prokurorisë	37
2.5. Mbikëqyrja e veprimtarisë së policisë gjyqësore dhe raportimi	38
Tabela II: Vlerësimi i Indikatorëve që lidhen me MBIKËQYRJEN dhe LLOGARIDHËNIEN	40
3. Cilësia dhe Efiçenca	42
Tabela III/A Standardet ndërkombëtare në lidhje me Cilësinë dhe Efiçencën	43
3.1. Burimet Financiare	44
3.2. Burimet Njerëzore	44
3.3. Rekrutimi dhe Karriera e Prokurorëve	48
3.4. Formimi Profesional dhe Trajnimet	49
3.5. Kapacitetet Teknologjike	50
Tabela III: Vlerësimi i Indikatorëve që lidhen me CILËSINË dhe EFIÇENCËN	52
4. Transparenca, Integriteti dhe Etika	54
Tabela IV/A Standardet ndërkombëtare në lidhje me Transparencën/Integritetin/Etikën	55
4.1. Integriteti dhe Etika e Prokurorëve	55
4.2. Media dhe Publiku	56
4.3. Mekanizma të tjerë anti-korrupsion	57
Tabela IV: Vlerësimi i Indikatorëve që lidhen me TRANSPARENCËN, INTEGRITETIN dhe ETIKËN	60



5. Efikasiteti dhe Performanca	64
Tabela V/A Standardet ndërkombëtare në lidhje me Efikasitetin dhe Performancën	65
5.1. Planifikimi Strategjik	68
5.2. Roli i Prokurorëve në Procedimet Penale dhe bashkëpunimi me Policinë Gjyqësore	69
5.3. Statistikat dhe Menaxhimi i Çështjeve	70
5.4. Matja e Performancës të Shërbimit të Prokurorisë	71
5.5. Bashkëpunimi Ndërkombëtar	72
Tabela V: Vlerësimi i Indikatorëve që lidhen me EFIKASITETIN dhe PERFORMANCËN	74
Bibliografia	76
Standardet Ndërkombëtare	76
Legjislacioni Kombëtar	78
Strategji	87
Raporte & Publikime	87



Tabela & Grafikë

Tabela I/A: Standardet ndërkombëtare në lidhje me Pavarësinë dhe Paanësinë

Tabela I: Vlerësimi i Indikatorëve që lidhen me PAVARËSINË dhe PAANËSINË

Tabela II/A: Standardet ndërkombëtare në lidhje me Mbikëqyrjen dhe Llogaridhënien

Tabela II: Vlerësimi i Indikatorëve që lidhen me MBIKËQYRJEN dhe LLOGARIDHËNIEN

Tabela III/A: Standardet ndërkombëtare në lidhje me Cilësinë dhe Efiçencën

Tabela III: Vlerësimi i Indikatorëve që lidhen me CILËSINË dhe EFIÇENCËN

Tabela IV/A: Standardet ndërkombëtare në lidhje me Transparencën/Integritetin/Etikën

Tabela IV: Vlerësimi i Indikatorëve që lidhen me TRANSPARENCËN, INTEGRITETIN dhe ETIKËN

Tabela V/A: Standardet ndërkombëtare në lidhje me EFIKASITETIN dhe PERFORMANCËN

Tabela V: Vlerësimi i Indikatorëve që lidhen me EFIKASITETIN dhe PERFORMANCËN

Tabela A: Niveli i zbatimit të rezolutës së Kuvendit për Prokurorin e Përgjithshëm për vitin 2022

Tabela B: Niveli i zbatimit të rezolutës së Kuvendit për Këshillin e Lartë të Prokurorisë për vitin 2022

Tabela C: Niveli i zbatimit të rezolutës së Kuvendit për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për vitin 2022

Grafik 1: Buxheti i miratuar dhe rishikuar për Shërbimin e Prokurorisë në lek (2022-2020)

Grafik 2: Numri i prokurorëve, oficerëve të policisë gjyqësore dhe punonjësve të administratës në Prokurorinë e Përgjithshme (2022)

Grafik 3: Numri i prokurorëve në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm (2022)

Grafik 4: Numri i oficerëve të policisë gjyqësore në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm (2022)

Grafik 5: Numri i punonjësve të administratës në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm (2022)

Grafik 6: Numri i prokurorëve dhe punonjësve të administratës në prokuroritë pranë gjykatave të apelit me juridiksion të përgjithshëm (2022)

Grafik 7: Frekuentimi i aktiviteteve nga prokurorët gjatë 3 viteve të fundit akademike

Grafik 8: Ditët e trajnimit të ndjekura nga prokurorët gjatë 3 viteve të fundit akademike



Lista e Shkurtimeve dhe Akronimeve

BE	Bashkimi Evropian
BKH	Byroja Kombëtare e Hetimit
CAMS	Sistemi i Menaxhimit të Çështjeve të Shërbimit të Prokurorisë Shqiptare
EUROJUST	Agjencia e BE-së për Bashkëpunimin në fushën e Drejtësisë Penale
EUROPOL	Agjencia e BE-së për Bashkëpunimin e Agjencive Ligjzbatuese
GJEDNJ	Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut
GJK	Gjykata Kushtetuese
GJL	Gjykata e Lartë
GPH	Grupe të Përbashkëta Hetimore
PGJ	Policia Gjyqësore
QTI	Qendra e Teknologjisë së Informacionit për Sistemin e Drejtësisë
OPGJ	Oficer i Policisë Gjyqësore
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Europë
ILD	Inspektori i Lartë i Drejtësisë
TI	Teknologjia e informacionit
KE	Këshilli i Evropës
KEDNJ	Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut
KLGI	Këshilli i Lartë Gjyqësor
KLP	Këshilli i Lartë i Prokurorisë
KM	Këshilli i Ministrave
KPA	Kolegji i Posaçëm i Apelimit
KPGJ	Komisioni i Policisë Gjyqësore
KPK	Komisioni i Pavarur i Kualifikimit
KPP	Kodi i Procedurës Penale
MD	Ministria e Drejtësisë
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
OJQ	Organizata Jo-Qeveritare
PP	Prokuroria e Përgjithshme
SHM	Shkolla e Magjistraturës
SND	Strategjia Ndërsektoriale e Drejtësisë
SPAK	Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar
SVHOPGJP	Statistika e veprimeve hetimore të oficerëve të policisë gjyqësore të seksionit në prokurori
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
UNODC	Zyra e Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Drogën dhe Krimin



Parathënie

Sfidat në rritje dhe tendencat komplekse të kriminalitetit, veçanërisht ato që lidhen me krimet financiare dhe ekonomike, kanë sjellë që Shqipëria ashtu sikurse një sërë vendesh të tjera të konsiderojë nevojën për të forcuar dhe përmirësuar qasjen e saj në trajtimin e këtyre fenomeneve.

Krimi i organizuar dhe korrupsioni vazhdojnë të mbeten një nga kërcënimet kryesore për sigurinë dhe zhvillimin ekonomik të Shqipërisë, ndërkohë që një pjesë e konsiderueshme e grupeve të krimit të organizuar janë përfshirë në ekonominë e ligjshme të vendit, duke bërë që aktivitete si pastrimi i parave apo trafikimi i mallrave me akcizë të lartë dhe produkteve të falsifikuara të jenë mjaft prezente.¹

Shtrirja transnacionale e krimit të organizuar ka bërë gjithashtu që ndarja ndërmjet këtyre aktiviteteve të kryera nën juridiksionin shqiptar dhe atyre të kryera brenda juridiksionit të zonës së BE-së të bëhen gjithnjë e më pak të dallueshme. Zhvillimi, sofistikimi dhe trendet e krimit të organizuar kanë sjellë një shtim të vëllimit të veprimtarive kriminale, si edhe risi në strukturimin organizativ dhe modus operandi-n e këtyre grupeve.²

Pas fillimit të negociatave të anëtarësimit në korrik të vitit 2022, lufta kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar do të vazhdojë të mbetet një nga treguesit kryesorë për përparimin e Shqipërisë drejt BE-së. Pavarësisht përpjekjeve në këtë drejtim, vlerësimet që lidhen me rezultatet e Shqipërisë në luftën kundër krimit të organizuar mbeten ende të dobëta dhe në tërësi rezultojnë që lufta ndaj krimit të organizuar ka nevojë të forcohet më tej, ndërkohë që lufta kundër krimit kibernetik, trafikimit të qenieve njerëzore dhe pastrimit të parave mbeten fusha në të cilat nevojiten më shumë rezultate.³

Praktikat efektive të ndjekjes penale luajnë një rol kyç jo vetëm në adresimin dhe trajtimin efektiv të fenomeneve më lart, por edhe në formësimin e besueshmërisë së qytetarëve ndaj institucioneve të drejtësisë.

Në këtë kontekst, reforma në sistemin e drejtësisë pati si qëllim kryesor krijimin e një drejtësie penale më efektive, duke përmirësuar proceset që lidhen me

hetimin, ndjekjen penale dhe gjykimin. Prokuroria ishte një nga institucionet kryesore, e cila ju nënshtrua ndryshimeve të mëdha nga reforma. Decentralizimi dhe pavarësia e prokurorëve u vlerësuan si disa nga elementët më kryesorë në funksion të një shërbimi prokurorie efikase. Gjithashtu, një ndër shtyllat kryesore ishte krijimi i institucioneve të posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, Prokurorisë (SPAK) dhe Gjykatave të Posaçme, përfshirë Byronë Kombëtare të Hetimit (BKH).

Pavarësisht se reforma e drejtësisë ka hyrë tashmë në vitin e katërt të zbatimit, ende kapacitetet e institucioneve të hetimit dhe ndjekjes penale nuk janë formësuar plotësisht për t'ju përgjigjur të gjitha dinamikave prezente. Duke qenë se reforma solli ndryshime rrënjësore dhe gjithëpërfshirëse nga pikëpamja strukturore, ligjore por edhe kulturore, ende institucionet e reja të drejtësisë nuk janë ngritur plotësisht.

Një sfidë tjetër aktuale e prokurorive vazhdon të jetë mungesa e theksuar e burimeve njerëzore për shkak të largimeve të magjistratëve nga procesi i rivlerësimit kalimtar, ndërkohë që një pjesë e madhe e tyre janë ende në proces apo nuk e kanë nisur procesin e rivlerësimit. Për rrjedhojë, ngarkesa e punës në prokuroritë ka krijuar një situatë emergjence, pasi ende nuk ka një parashikim të qartë se kur sistemi do të funksionojë me kapacitete të plota. Zbatimi i hartës së re gjyqësore e cila solli riorganizimin e prokurorive pranë gjykatave të shkallës së parë dhe prokurorisë pranë gjykatës së apelit me juridiksion të përgjithshëm, përbën gjithashtu një tjetër sfidë për t'i siguruar qytetarëve një shërbim efektiv, pa kosto dhe në kohë.

Ky studim i përgatitur nga Qendra për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes ka si qëllim të identifikojë dhe kryejë një vlerësim të mekanizmave kryesorë të nevojshëm për funksionimin efikas të shërbimit të prokurorisë në Shqipëri, me qëllim ofrimin e rekomandimeve, të cilat mbështesin forcimin e sistemit të drejtësisë dhe politikave penale si një garanci për hetimin dhe trajtimin efikas të veprave penale.

¹ Qendra për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes (CSDG), Shkurt 2022, "Sfidat e Shqipërisë në adresimin efektiv të Krimit të Organizuar: Zhvillimi i një kuadri

strategjik efektiv dhe të përmirësuar në përputhje me qasjen e Bashkimit Evropian"

² Po aty

³ Komisioni Evropian, Raporti 2022 për Shqipërinë



Konteksti i Studimit

Përgjatë dy dekadave të fundit Shqipëria gjithnjë e më shumë është përballur me një sërë sfidash në rritje dhe komplekse që lidhen me korrupsionin, krimin e organizuar përfshirë atë ekonomik dhe financiar, kibernetik apo krime të tjera të lidhura me to. Nevoja për të ndërmarrë një reformë komplekse dhe gjithëpërfshirëse siç ishte ajo në sistemin e drejtësisë evidentoi edhe më shumë prezencën dhe përhapjen e këtyre fenomeneve në shoqëri, por edhe dështimin e institucioneve të drejtësisë për t'ju përgjigjur në mënyrë efektive këtyre sfidave.

Miratimi i reformës në sistemin e drejtësisë në korrik të vitit 2016, përfshiu ndër objektivat e saj kryesore dhe reformimin e drejtësisë penale, jo vetëm si një nga shtyllat kryesore të shtetit të së drejtës, por edhe si një nevojë për t'u përballuar me forma të reja të sofistikuar të kriminalitetit duke përmirësuar legjislacionin dhe rritur efektivitetin e veprimtarisë së agjencive të specializuara në luftën kundër kriminalitetit. Si një nga institucionet kryesore në parandalimin dhe luftimin e kriminalitetit në vend, organi i prokurorisë ishte një nga institucionet kryesore që ju nënshtrua një sërë ndryshimesh kushtetuese dhe ligjore.

Analiza e sistemit të drejtësisë vuri në dukje se rezultatet e punës së prokurorisë nuk i përgjigjeshin sa dhe si duhet sfidave të kriminalitetit dhe krimit të organizuar dhe korrupsionit në veçanti dhe kjo si pasojë e një sërë shkaqesh të lidhura me: i) modelin organizativ tërësisht të centralizuar dhe hierarkik të prokurorisë, duke u bërë shkas për ndikimin politik mbi sistemin si dhe për cënimin e pavarësisë së brendshme të prokurorëve; ii) rolin e kufizuar këshillimor të Këshillit të Prokurorisë në administrimin e çështjeve që lidhen me statusin e prokurorit; iii) mangësitë në rregullimin e statusit të prokurorit; iv) mungesën e mekanizmave të efektshëm për llogaridhënien dhe përgjegjshmërinë e prokurorëve; dhe v) mungesën e mekanizmave të efektshëm për vlerësimin e performancës së prokurorëve.

Në këtë kontekst, ndryshimet me karakter kushtetues dhe ligjor që u ndërmorrën synuan rritjen e efikasitetit dhe efektivitetit të drejtësisë penale nëpërmjet konsolidimit të misionit dhe funksioneve të prokurorisë, si dhe përmes riorganizimit të strukturave të saj dhe rishpërndarjes së përgjegjësisë mes tyre.

Ligji i ri për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë synoi të rregullonte garantimin e pavarësisë së brendshme dhe të jashtme të prokurorëve, rishikimin e kompetencave të hetimit dhe përfaqësimit të akuzës në gjykatë, duke nxitur kontrollin efektiv dhe balancimin e këtyre kompetencave nga strukturat përgjegjëse, sigurimin e pavarësisë së mjaftueshme të strukturave të veçanta të prokurorisë, vendosjen e rregullave të qarta për disiplinimin e autoritetit të prokurorëve më të lartë në raport me prokurorët e çështjes, në respekt të parimeve të ligshmërisë dhe pavarësisë së veprimtarisë së tyre.

Disa vite nga zbatimi i këtyre ndryshimeve dhe riorganizimi i thuajse të gjitha institucioneve të drejtësisë dhe krijimit të atyre të reja, korrupsioni në sistemin gjyqësor vazhdon të perceptohet se është i lartë. Shqipëria vazhdon të ketë njëfarë niveli përgatitjeje në luftën kundër korrupsionit, ndërkohë që korrupsioni mbetet një fushë serioze shqetësimi. Rritja e numrit të dënimeve përfundimtare të zyrtarëve të nivelit të lartë mbetet një prioritet i rëndësishëm. Edhe në luftën kundër krimit të organizuar Shqipëria ka njëfarë niveli përgatitjeje, ndërkohë që lufta kundër krimit kibernetik, trafikimit të qenieve njerëzore, abuzimit seksual të fëmijëve në internet dhe pastrimit të parave mbeten fusha problematike në të cilat nevojiten më shumë rezultate.

Progres Raporti i viti 2022 thekson gjithashtu se Shqipëria ka një sektor të madh informal dhe ekonomia e saj bazohet kryesisht në para "cash". Krimet që gjenerojnë shumën më të madhe parash përfshijnë trafikun e drogës, evazionin fiskal, kontrabandën dhe trafikimin e qenieve njerëzore, ndërkohë që në lidhje me pastrimin e parave, Shqipëria është në listën e Task-Forcës së Veprimit Financiar (FATF) të juridiksioneve nën monitorim të shtuar që nga shkurti i vitit 2020.

Evidentimi dhe prania e problematikave të lartëpërmendura si edhe mungesa e një vlerësimi gjithëpërfshirës mbi performancën e shërbimit të prokurorisë, ka nxjerrë në pah nevojën për përgatitjen e një studimi, i cili synon të shërbejë si një analizë cilësore e gjendjes aktuale të organit të prokurorisë. Nga analiza e kryer synohet të kuptohet se si po funksionon/performon organi i prokurorisë dhe çfarë nuk shkon apo pengon performimin e institucionit sipas pritshmërive.



Standardet Ndërkombëtare dhe Metodologjia

Një sërë institucionesh dhe organizatash ndërkombëtare kanë përgatitur instrumenta dhe raporte, të cilat fokusohen tek monitorimi dhe matja e aspekteve të ndryshme të performancës së segmenteve të ndryshme të sistemeve të drejtësisë në vende të ndryshme.

Ky studim ka përfshirë në metodologjinë dhe analizën e tij disa prej instrumentave kryesore që lidhen me adresimin e performancës në shërbimin e prokurorisë, kryesisht ato evropiane (të zhvilluara nga Këshilli i Evropës) dhe ndërkombëtare (të zhvilluara nga Kombet e Bashkuara dhe Shoqata Ndërkombëtare e Prokurorëve). Këto dy grupe instrumentesh janë përdorur si referencë për të ofruar një bazë kryesore në drejtim të vlerësimit të shërbimit të prokurorisë në Shqipëri nga një pikëpamje menaxheriale.

- Rekomandim (2000)¹⁹ “Mbi rolin e prokurorisë publike në sistemin e drejtësisë penale” u miratua nga Komiteti i Ministrave të Drejtësisë të Këshillit të Evropës më 6 tetor 2000, duke qenë dokumenti i parë në Evropë që synonte vendosjen e standardeve për shërbimet prokuroriale. Këshilli i Ministrave kishte si qëllim të përmirësonte cilësinë dhe efikasitetin e sistemeve gjyqësore evropiane dhe të forconte besimin e përdoruesve të gjykatave në sisteme të tilla. Komisioni Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë (CEPEJ) u krijua dhe filloi të ushtronte veprimtarinë e tij në fund të vitit 2002. Raportet e CEPEJ janë burime relevante që përfshijnë tregues të rëndësishëm krahasues për matjen e performancës së prokurorëve publikë në vendet evropiane.
- Udhëzimet e Kombeve të Bashkuara për Rolin e Prokurorëve, të miratuara nga Kongresi i 8-të i Kombeve të Bashkuara për Parandalimin e Krimit dhe Trajtimin e Autorëve të Veprimtarive të Kundëligjshme (1990), i plotësuar nga një udhërrëfyes përkatëse (Statusi dhe roli i prokurorëve: Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogën dhe Krimin dhe Udhëzuesi i Shoqatës Ndërkombëtare të Prokurorëve, 2014, "Udhëzuesi i UNODC/IAP"), gjithashtu ilustronë standardet ndërkombëtare. Standardet e përgjegjësisë profesionale dhe deklarata e detyrave dhe të drejtave themelore të prokurorëve, 23 prill 1999 nga Shoqata Ndërkombëtare e Prokurorëve ("Standardet IAP"), e cila ka të bëjë me sjelljen profesionale, pavarësinë, paanshmërinë, rolin në procedurën penale, bashkëpunimin dhe fuqizimin janë një burim i rëndësishëm i udhëzimeve të praktikave të mira ndërkombëtare.

Me qëllim identifikimin dhe reflektimin e praktikave të mira dhe evidentimin e sfidave në këtë fushë, metodologjia e hartuar nga grupi i punës për kryerjen e këtij vlerësimi mbështetet në mbledhjen dhe analizimin e të **dhënave parësore** (intervista kërkimore) dhe të **dhënave dytësore** (legjislacioni, raporte, publikime, etj) analizimi i të cilave është kryer në përputhje me pesë parametra kryesorë që lidhen me:

1. Pavarësinë/Paanësinë;
2. Mbikëqyrjen/Llogaridhënien;
3. Cilësinë/Efiçencën;
4. Transparencën/Integritetin/Etikën; dhe
5. Efikasitetin/Performancën,

Në tërësi, rezultatet e pritshme të hulumtimit dhe vlerësimit synojnë të kontribuojnë në:

- a) Analizimin e kuadrit ligjor për të identifikuar mangësi në legjislacion dhe për të gjeneruar rekomandime për përmirësim për secilin prej treguesve të metodologjisë;
- b) Vlerësimin e burimeve dhe kapaciteteve njerëzore, financiare dhe materiale, veçanërisht në trajtimin e krimeve financiare dhe ekonomike, mekanizmat e llogaridhënies, mjetet e menaxhimit strategjik, etj.;
- c) Hartimin e rekomandimeve për të përmirësuar menaxhimin e stafit duke përfshirë shqyrtimin e mundësive për trajnim dhe specializim;
- d) Analizimin dhe vlerësimin e praktikave profesionale që ndikojnë në performancën e sistemit të prokurorisë të tilla si vlerësimi i performancës, raportimi, marrëdhëniet me publikun dhe komunikimi strategjik, etj.



Vlerësime dhe Rekomandime

I. PAVARËSIA E SHËRBIMIT TË PROKURORISË DHE PROKURORËVE

Decentralizimi dhe pavarësia e prokurorëve ishte një nga qëllimet kryesore të ndryshimeve kushtetuese të reformës në sistemin e drejtësisë, ndaj dhe legjislacioni ka përfshirë një sërë dispozitash që theksojnë këtë element. Pavarësia e shërbimit të prokurorisë dhe prokurorëve garantohet në kushtetutë, ligje dhe një sërë udhëzimesh të përgjithshme. Legjislacioni parashikon gjithashtu pavarësinë e nevojshme të prokurorëve nga çdo formë ndikimi në marrjen e vendimeve.

Pavarësia e prokurorit përfshin autonominë e tij për marrjen e vendimeve në kryerjen e hetimeve, ndjekjen penale, përfaqësimin në gjyq të një çështje dhe/ose akuze penale dhe urdhërimin ose mbikëqyrjen e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore, pavarësisht ndikimit të paligjshëm të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të brendshëm apo të jashtëm nga çdo autoritet publik, privat apo palë në procesin penal.

Kodi i Procedurës Penale dhe ndryshimet që pasuan parashikojnë gjithashtu të drejtën e prokurorit për mosfillimin e procedimit penal, pushimin e akuzës apo çështjes, të drejtën për të hequr dorë si dhe të drejtën për të bërë ankim në gjykatën më të lartë. Prokurorët mund të bëjnë gjithashtu ankim ndaj udhëzimeve të përgjithshme dhe atyre jo të detyrueshme.

Pavarësia financiare e shërbimit të prokurorisë përbën gjithashtu një tjetër tregues kryesor për ushtrimin e kompetencave në mënyrë të pavarur dhe efektive. Prokuroria ka buxhet të pavarur, si pjesë e Buxhetit të Shtetit, i cili hartohet dhe administrohet nga Prokurori i Përgjithshëm dhe zbatohet në përputhje me legjislacionin përkatës të menaxhimit buxhetor dhe financiar.

Organi i qeverisjes së sistemit të prokurorisë siç është Këshilli i Lartë i Prokurorisë është ndërtuar si një organ kolegjal i përbërë nga njëmbëdhjetë anëtarë, të cilët shërbejnë në detyrë me kohë të plotë me qëllim për të garantuar pavarësinë, llogaridhënien, disiplinën, statusin dhe karrierën e prokurorëve. Gjashtë prej anëtarëve të Këshillit janë prokurorë nga të gjitha nivelet e prokurorisë, ndërkohë që pesë anëtarët e tjerë të Këshillit janë juristë joprokurorë, të përzgjedhur nga radhët e avokatëve, të pedagogëve të drejtësisë dhe të përfaqësuesve të

shoqërisë civile. Rregulla të detajuara parashikojnë përzgjedhjen e anëtarëve prokurorë dhe jo-prokurorë të KLP.

Si një mekanizëm që siguron mbrojtjen e pavarësisë së prokurorit është edhe Komisioni për Mbrojtjen e Prokurorëve pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë, i cili orientohet kryesisht në garantimin e mbrojtjes së veçantë të magjistratit prokuror me kërkesë të tij ose me marrjen dijeni për situata serioze që çenojnë jetën, shëndetin dhe pasurinë e magjistratit ose të familjarëve të tij.

Megjithëse organi i prokurorisë është përgjegjës për mbarëvajtjen e punës së Prokurorisë së Përgjithshme dhe të prokurorive pranë gjykatave të juridiksionit të përgjithshëm të apelit dhe shkallës së parë, evidentohet një rol i kufizuar i tij në disa aspekte që lidhen me stafin e institucionit, Sekretarin e Përgjithshëm, kancelarët dhe këshilltarin ligjor. Kjo pasi një sërë kompetencash si dhe miratimi i rregullave të hollësishme që lidhen me këto të fundit ushtrohen nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë.

Nga ana tjetër rezultoni që për të siguruar pavarësinë e plotë të prokurorëve nevojitet të plotësohet më tej kuadri ligjor dhe rregullator në lidhje me karrierën e prokurorëve. Raste që lidhen me emërimin apo transferimin e prokurorëve bazuar në lidhje politike, personale ose familjare përbëjnë ende një problematikë ekzistuese të adresuar shpesh nga organe të medias.

Pavarësisht, arritjeve që lidhen me decentralizimin e shërbimit të prokurorisë, rekomandohet se pavarësia procedurale nuk duhet të shmangë prokurorin nga detyrimi për të përmbushur funksionet dhe/ose përgjegjësitë kushtetuese dhe ligjore që lidhen me ushtrimin e ndjekjes penale apo zbatimin e udhëzimeve të përgjithshme, përfshirë ato që lidhen me zbatimin e rekomandimeve prioritare të Këshillit të Ministrave apo rezolutave të Kuvendit për luftën kundër kriminalitetit.

Nga ana tjetër ushtrimi në mënyrë të përgjegjshme i pavarësisë kërkon që prokurorët të jenë të përgatitur dhe të pajisur me një kulturë profesionale për të kryer një rol më aktiv, i cili do të përmirësonte në tërësi cilësinë e hetimit penal. Aspekte të tjera të punës të cilat lidhen me pavarësinë e ndjekjes penale duhet të konsolidohen dhe përmirësohen më tej.



II. MBIKËQYRJA DHE LLOGARIDHËNIA E SHËRBIMIT TË PROKURORISË DHE PROKURORËVE

Raportimi dhe llogaridhënia janë instrumente të rëndësishme në drejtim të transparencës së institucionit si edhe vlerësimit të performancës së shërbimit të prokurorisë. Prokurori i Përgjithshëm raporton në Kuvend për gjendjen e kriminalitetit në vend, të paktën një herë në vit. Raportimi përfshin të dhëna dhe shpjegime për numrin, llojet, shtrirjen territoriale, intensitetin dhe format e kriminalitetit në Republikën e Shqipërisë. Raportimi përfshin gjithashtu të dhëna të detajuara lidhur me efektivitetin e ndjekjes penale, cilësinë e përfaqësimit të akuzës në gjyq, zbatimin e rekomandimeve prioritare të Këshillit të Ministrave në luftën ndaj kriminalitetit, si edhe nxjerrjes së udhëzimeve të përgjithshme, zbatimit, ndikimit dhe monitorimit të tyre.

Pavarësisht se Prokurori i Përgjithshëm bashkëpunon me komisionet hetimore parlamentare, hetimi penal është i pavarur nga hetimet e komisioneve parlamentare dhe në rastet e raportimit në Kuvend nuk lejohet njoftimi për çështje konkrete, me përjashtim të çështjeve të dërguara me vendim të Kuvendit. Prokurori i Përgjithshëm raporton gjithashtu të paktën një herë në vit në edhe në Këshillin e Lartë të Prokurorisë lidhur me ecurinë e veprimtarisë së strukturave përkatëse.

Institucionet e tjera si Këshilli i Lartë i Prokurorisë dhe Inspektori i Lartë i Drejtësisë, të cilat luajnë një rol të rëndësishëm në aktivitetin e shërbimit të prokurorisë dhe prokurorëve raportojnë gjithashtu në mënyrë periodike tek Kuvendi i Shqipërisë dhe janë gjithashtu subjekt i Rezolutave që Kuvendi përgatit mbi vlerësimin e veprimtarisë së këtyre institucioneve. Respektivisht Këshilli i Lartë i Prokurorisë raporton para Kuvendit mbi gjendjen e sistemit gjatë vitit të mëparshëm kalendarik jo më pak se një herë në vit. Raporti i KLP i cili i përcillet Kuvendit jo më vonë se data 1 maj e çdo viti, përshkruan veprimtarinë e Këshillit dhe të komisioneve të tij, si dhe përmban rekomandimet për përmirësimet e nevojshme. Gjithashtu një pjesë e rëndësishme e raportit vjetor të këtyre institucioneve është edhe vlerësimi në lidhje me nivelin e zbatimit të rezolutave të Kuvendit. Mekanizmi i këtyre raportimeve është kryer në mënyrë sistematike nga të gjitha institucionet, ndërkohë që monitorimi i nivelit të përmbushjes së Rekomandimeve të Kuvendit pasqyrohet në çdo raport vjetor.

Nga analiza e kryer ka rezultuar se për monitorimin e jashtëm që kryhet mbi shërbimin e prokurorisë nuk ka një metodologji të plotë dhe mirëpërcaktuar për matjen e rezultateve. Kuvendi ka kompetenca të kufizuara sa i përket këtij monitorimi dhe pavarësisht përpjekjeve në këtë drejtim roli i tij ka qenë më shumë koordinues.

Mbikëqyrja dhe raportimi i brendshëm i shërbimit të prokurorisë janë gjithashtu elementë të rëndësishëm për mbarëvajtjen dhe ushtrimin e kompetencave ligjore dhe kushtetuese të prokurorisë, por pa cënuar pavarësinë e prokurorëve. Sektori i Monitorimit në Prokurorinë e Përgjithshme është struktura e autorizuar nga Prokurori i Përgjithshëm, ndërkohë që në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë dhe pranë gjykatave të apelit me juridiksion të përgjithshëm autoriteti monitorues/mbikëqyrës dhe verifikues është drejtuesi i prokurorisë ose zëvendësdrejtuesi i autorizuar prej tij.

Evidentohet se, pavarësisht se shërbimi i prokurorisë ka kompetenca që lidhen me organizimin dhe funksionimin e sistemit të prokurorisë, në raste të informacioneve mbi probleme tematike ose për shkelje individuale të evidentuara kryesisht ose nga veprimtaria funksionale e strukturave të Prokurorisë së Përgjithshme ose nga ankesa të dërguara nga persona fizikë apo juridikë në Prokurorinë e Përgjithshme apo prokurorive me juridiksion të përgjithshëm, kërkesat/ankesat i drejtohen Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ose Komisionit të Policisë Gjyqësore. Bazuar në raportet e Prokurorit të Përgjithshëm evidentohen një sërë problematikash në lidhje me mbarëvajtjen e aktivitetit të shërbimit të prokurorisë, specifikisht marrëdhëniet me drejtuesit e prokurorive lidhur me veprimtarinë organizative dhe administrative të tyre. Këto problematika përfshijnë raportimin/informimin e drejtuesve të prokurorive mbi gjendjen e kriminalitetit, dërgimin e raportit vjetor mbi ecurinë e punës në prokurorinë përkatëse, mangësitë në paraqitjen e të dhënave të sakta në raportin vjetor, informimin mbi problematika dhe/ose shkelje që përbëjnë shkak për fillimin e procedurës disiplinore ndaj oficerëve të policisë gjyqësore të seksionit në prokurorinë respektive, dërgimin e raportit të vlerësimit të oficerëve të Policisë Gjyqësore, si dhe nxjerrjen e udhëzimeve të përgjithshme për të garantuar dhe lehtësuar zbatimin e udhëzimeve të përgjithshme të Prokurorit të Përgjithshëm.



III. CILËSIA DHE EFIÇENCA E SHËRBIMIT TË PROKURORISË DHE PROKURORËVE

Funksionimi efikas i shërbimit të prokurorisë nuk do të ishte i mundur pa mbështetjen ndaj institucionit me burime të mjaftueshme financiare, njerëzore apo aspekte të tjera teknike dhe logjistike. Pavarësisht vështirësive që institucionet e reja patën në fillim të ri-organizimit apo krijimit të tyre, evidentohet një mbështetje e konsiderueshme buxhetore për të bërë të mundur funksionimin e tyre në mënyrë eficiente.

Pavarësisht kësaj, mungesa e prokurorëve dhe burimeve njerëzore të përshtatshme ndaj tyre, përbën një vështirësi tashmë serioze në mbarëvajtjen dhe menaxhimin e ngarkesës së prokurorive. Si pasojë e procesit të rivlerësimit kalimtar, edhe përgjatë vitit 2022 vijoi krijimi i vakancave të përkohshme dhe të përhershme, deri në 42% sa i përket shërbimit të prokurorisë.

Të dhënat për vitin 2022 tregojnë se numri i prokurorëve, oficerëve të policisë gjyqësore dhe punonjësve të administratës në Prokurorinë e Përgjithshme është më i ulët nga ai i parashikuar. Në të gjitha 22 prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm pati mungesa të numrit të prokurorëve aktualë krahasuar me numrin e parashikuar në organikën e institucionit.

Një situatë më e ndryshme paraqitet në lidhje me numrin e oficerëve të policisë gjyqësore në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm, ku në 16 prej tyre numri i oficerëve të policisë gjyqësore është i plotësuar sipas organikës së institucionit. Në lidhje me numrin e punonjësve të administratës së prokurorive pranë gjykatave të shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm, në 17 prej tyre ky numër është i plotësuar sipas organikës.

Sa i përket numrit të prokurorëve dhe punonjësve të administratës në prokuroritë pranë gjykatave të apelit me juridksion të përgjithshëm, evidentohen mungesa që lidhen vetëm me numrin e prokurorëve, ndërkohë që rezultojnë të plotësuara sipas organikës pozicionet administrative. Nuk ka një vlerësim të plotë në lidhje me ndikimin e këtyre mungesave në eficientë e punës së prokurorëve, veçanërisht në procesin e ndjekjes penale.

Shqetësues mbetet gjithashtu caktimi i përkohshëm i prokurorëve dhe mungesa e rregullores së vlerësimit për drejtuesit e prokurorive bazuar në indikatorë të performancës, konsideruar si një mangësi serioze jo

vetëm në transparencën dhe integritetin në emërime, por edhe në mbarëvajtjen e punës dhe bashkërendimin e veprimtarisë së prokurorive.

Megjithëse KLP ka miratuar një sërë rregulloresh të rëndësishme që lidhen me emërimin, transferimin, shkarkimin dhe shpërblimin e prokurorëve, ka ende akte nënligjore të cilat duhet të miratohen nga KLP-ja bazuar në kërkesat e Ligjit për Statusin dhe Ligjit për Qeverisjen. Mungesa e disa akteve të rëndësishme nënligjore është konsideruar se krijon rrezik për zbatimin e dispozitave ligjore bazuar në interpretime të ndryshme dhe për këtë arsye përpunimi dhe miratimi i të gjitha akteve nënligjore të parashikuara nga legjislacioni parësor duhet të jetë prioritet i KLP-së.

Programi i Formimit Vazhdues në Shkollën e Magjistraturës, por edhe trajnimet janë një element mjaft i rëndësishëm pasi synojnë t'i shërbejnë cilësisë së drejtësisë duke u bazuar në nevojat e sistemit për trajnim. Pavarësisht këtij qëllimi, evidentohet një ulje e numrit të prokurorëve të cilët kanë ndjekur trajnimet e organizuara nga Shkolla e Magjistraturës.

Përgjatë vitit 2022, 34% e prokurorëve nuk kanë marrë pjesë asnjë ditë në trajnimet e organizuara nga Shkolla e Magjistraturës, ndërkohë që asnjë prokuror nuk ka marrë pjesë në mbi 20 ditë në vit akademik në trajnimet e organizuara nga ky institucion. Gjithashtu konstatohet se ka një raport mjaft disproporcional ndërmjet numrit të prokurorëve të ftuar në trajnimet e zhvilluara nga Shkolla e Magjistraturës dhe atyre të cilët kanë marrë pjesë dhe janë çertifikuar në këto trajnime. Ky numër ka qenë më i ulëti përgjatë vitit akademik 2021-2022.

Nga analiza vërehet se aspektet teknologjike përbëjnë gjithashtu një nga vështirësitë për të gjitha institucionet e drejtësisë dhe ritmi i përmirësimit të këtij komponenti është më i ngadaltë krahasimisht me aspektet e tjera të punës. Siç evidentohet edhe në Strategjinë Ndërsektoriale të Drejtësisë 2021-2025 shumica e masave që lidhen me objektivin specifik 4.1 *“Zhvillimi i plotë i sistemit të integruar të drejtësisë elektronike (e-drejtësia) me identifikues të unifikuar, i sistemeve të menaxhimit të çështjeve të përditësuara, regjistrimit elektronik të bazuar në internet për të treja fushat (penale, administrative, civile) dhe lidhjeve me regjistrat dhe bazat e të dhënave përkatëse kombëtare”* janë zbatuar pjesërisht ose nuk janë zbatuar.



IV. TRANSPARENCA, INTEGRITETI DHE ETIKA E SHËRBIMIT TË PROKURORISË DHE PROKURORËVE

Transparenca është një aspekt tjetër i rëndësishëm i aktivitetit të shërbimit të prokurorisë dhe thuajse të gjitha institucionet e drejtësisë e kanë patur në fokus të punës së tyre.

Si organ përgjegjës për miratimin e standardeve të etikës së prokurorëve dhe të rregullave të sjelljes të prokurorëve, si dhe për mbikëqyrjen e respektimit të tyre, Këshilli i Lartë i Prokurorisë ka marrë një sërë masash në këtë drejtim.

Gjatë vitit 2022, KLP zgjodhi Këshilltarin për Etikën nëpërmjet procedurës së komandimit, ndërkohë që miratoi gjithashtu në shkurt të vitit 2022 “Standardet e etikës dhe rregullat e sjelljes së Prokurorit”, një rregullore e cila synon të vendosë, ruajë dhe forcojë integritetin profesional dhe personal të prokurorëve, si dhe të rrisë efektivitetin, paanshmërinë dhe përgjegjshmërinë gjatë dhe jashtë ushtrimit të funksioneve të tyre, në emër dhe në interes të shoqërisë si pjesë e sistemit të drejtësisë penale.

Megjithëse më shumë se 1 vit nga zgjedhja e Këshilltarit për Etikën, ende nuk është realizuar një raportim për të bërë të mundur të kuptohet se cilat janë problematikat e etikës në sistem, të vlerësohet sa njihet dhe si zbatohet rregullorja për etikën dhe eventualisht çfarë masash duhet të ndërmarrë KLP për të përmirësuar situatën.

Nga ana tjetër përveç raportimit të munguar mbi veprimtarinë e Këshilltarit për Etikën, evidentohet një mungesë e theksuar e trajnimeve që lidhen me etikën. Bazuar në kalendarin e trajnimeve të Shkollës së Magjistraturës gjatë 3 viteve të fundit këto trajnime kanë qenë thuajse inekzistente.

Në lidhje me marrëdhëniet e shërbimit të prokurorisë me median, udhëzimi i përgjithshëm për marrëdhëniet me publikun në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm ka qëllim të unifikojë veprimtarinë e prokurorive me juridiksion të përgjithshëm në marrëdhëniet me publikun dhe median për dhënien e informacionit në lidhje me hetimin dhe ndjekjen penale dhe për aktivitete të tjera të prokurorive në këtë fushë.

Pavarësisht se prokurori i marrëdhënieve me publikun luan një rol të rëndësishëm në lidhje me drejtimin dhe mbikëqyrjen e shërbimit të marrëdhënieve me publikun, nuk ka një informacion

të qartë të publikuar në lidhje me zgjedhjen e prokurorëve për marrëdhëniet me publikun si edhe raportimeve që ato parashikohet të kryejnë.

Gjithashtu nuk ka një informacion apo kontakte të publikuara në lidhje me koordinatorin për marrëdhëniet me publikun, i cili emërohet nga Drejtuesi i Prokurorisë. Në faqen e Prokurorisë së Përgjithshme si edhe në të gjitha faqet e prokurorive të rretheve përfshirë prokurorinë e Apelit të juridiksionit të përgjithshëm gjendet i publikuar kontakti i koordinatorit për të drejtën e informimit, ndërkohë që PP ofron një rubrikë të dedikuar për akreditimin e medias.

Programi i Transparencës është gjithashtu një instrument kryesor në rritjen e transparencës mbi veprimtarinë e shërbimit të prokurorisë. Është evidentuar se jo të gjitha rubrikat e këtij programi janë funksionale dhe të aksesueshme, ndërkohë që nevojitet të monitorohen kthimet e përgjigjeve për publikun/median dhe të vlerësohet eficaenca e tyre, nëse janë adresuar plotësisht ose jo kërkesat për informacion.

Si pjesë e bashkëpunimit me organizatat e shoqërisë civile sugjerohet gjithashtu që Prokuroria e Përgjithshme të zhvillojë aktivitete informuese në lidhje me veprimtarinë e saj, të dedikuara posaçërisht shoqërisë civile. Prokuroria duhet të afrohet me standartet ndërkombëtare të cilat e trajtojnë dhe konsiderojnë bashkëpunimin me shoqërinë civile si një instrument efikas në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar. Organizimi i tryezave të përbashkëta me qytetarët dhe shoqërinë civile me qëllim informimin rreth veprimtarisë së Prokurorisë së Përgjithshme, rrit transparencën dhe besueshmërinë e publikut ndaj institucionit.

Një nga instrumentet e miratuar në vitin 2016 në kuadër të raportimit të akteve korruptive ishte edhe Ligji për Sinjalizimin dhe Mbrojtjen e Sinjalizuesve. Aktualisht në faqen e Prokurorisë së Përgjithshme, por edhe prokurorive të rretheve nuk ka një informacion të publikuar në lidhje me miratimin e akteve respektive në zbatim të ligjit për sinjalizimin dhe mbrotjen e sinjalizuesve, të cilat përfshijnë miratimin e rregulloreve përkatëse si dhe formularët për rastet e sinjalizimit të brendshëm, të jashtëm dhe kërkesës për mbrojtje nga hakmarrja.



V. EFIKASITETI DHE PERFORMANCA E SHËRBIMIT TË PROKURORISË DHE PROKURORËVE

Krijimi i një mekanizmi i cili të bëjë të mundur monitorimin e realizimit të objektivave të institucionit të prokurorisë në tërësi dhe efektivitetin në arritjen e rezultateve konkrete përbën një aspekt kyç të matjes së performancës, ndërkohë që përdoret si një instrument në shumë prej vendeve në Evropë.

Aktualisht është evidentuar se kuadri ligjor në fuqi ka një boshllëk ligjor në drejtim të vlerësimit të performancës së prokurorive me juridiksion të përgjithshëm, e cila ndryshon nga vlerësimi individual i performancës së drejtuesve apo të vetë prokurorëve. Pavarësisht këtyre mangësive raporti vjetor i Prokurorit të Përgjithshëm pasqyron një vlerësim mbi efektivitetin e ndjekjes penale dhe një analizë të treguesve të kriminalitetit.

Evidentohet se numri i procedimeve penale të filluara kryesisht nga ana e prokurorisë vazhdon të mbetet i ulët duke patur parasysh numrin total të procedimeve penale të rregjistruara. Ky fakt thekson rëndësinë e rritjes së rolit proaktiv të prokurorit në hetimin paraprak, në funksion të shtimit të hetimeve të filluara kryesisht nga vetë organi i prokurorisë, që përbën edhe një nga rekomandimet kryesore të rezolutës së Kuvendit për Prokurorin e Përgjithshëm.

Për shkak të vakancave të krijuara si pasojë e procesit të rivlerësimit dhe për rrjedhojë rritjes së ngarkesës dhe volumit të punës së prokurorëve, evidentohet edhe një rritje e numrit të procedimeve penale të mbartura përgjatë 3 viteve të fundit. Pavarësisht se Raporti i Prokurorit të Përgjithshëm mbi Ngarkesën e Punës së Prokurorive pasqyron ngarkesën mesatare në hetim për çdo prokuror sipas prokurorive do të ishte e nevojshme që ky vlerësim të paraqitej edhe duke patur parasysh ngarkesën mesatare në hetim për çdo prokuror në total, në rang vendi.

Krahasimisht me vitet 2020 dhe 2021 numri i procedimeve penale në të cilat janë përdorur hetime proaktive dhe/ose me përdorim të mjeteve të posaçme të hetimit është ulur. Informacionit dhe të dhënave të pasqyruara në raportin vjetor të Prokurorit të Përgjithshëm i mungojnë të dhëna që lidhen me kohëzgjatjen e hetimeve paraprake si edhe numrin e çështjeve të ankimuar, nga prokurorët pranë gjykatave të apelit dhe pranë Gjykatës së Lartë.

Pavarësisht disa hapave pozitiv të ndërmarrë në drejtim të vlerësimit objektiv dhe rritjes së performancës dhe raportimit të oficerëve të policisë

gjyqësore, nevojitet forcimi i bashkëpunimit ndërmjet palëve dhe të kuptuarit qartë të roleve. Njëkohësisht nevojitet të përmirësohet cilësia e referimit të çështjeve si edhe komunikimi nëpërmjet krijimit të modeleve dhe protokolleve për komunikim por edhe vlerësimit të punës.

Megjithëse kuadri ligjor për menaxhimin e çështjeve në prokurori dhe mbajtjen e statistikave është i plotë, problemi qëndron tek vonesat në ngritjen dhe funksionimin e sistemit për menaxhimin e çështjeve që sjellë mbingarkesën të disa prokurorëve apo problematika lidhur me kohën në dispozicion të shqyrtimit të çështjes. Në këtë aspekt rekomandohet ngritja dhe funksionimi sa më parë i sistemit që do të rezultonte në dixhitalizim të plotë të proceseve të punës së prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm dhe për pasojë në rritjen e efijencës.

Gjithashtu, rekomandohet marrja e masave për problematikat e evidentuara lidhur me të dhënat statistikore. Rekomandohet unifikimi i të dhënave dhe mënyrës së raportimit të tyre nga të gjithë aktorët e sistemit të drejtësisë. Për më tepër rekomandohet trajnimi i vazhdueshëm i personave përgjegjës për plotësimin e statistikave. Të dhënat statistikore të besueshme do të përmirësonin jo vetëm efijencën e prokurorive por do të rrisnin edhe besimin e publikut në të.

Në lidhje me bashkëpunimin ndërkombëtar rekomandohet marrja e masave për të adresuar mbingarkesën e punës dhe për të rritur njohuritë profesionale të stafit që punojnë në departamente që merren me bashkëpunim gjyqësor ndërkombëtar. Në këtë kuadër rekomandohen trajnime për rritje të kapaciteteve teknike dhe analitike të stafit. Në kuadrin e procesit të anëtarësimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian, duhet të përshtatet legjislacionit procedural dhe veçanërisht ajo pjesë që rregullon bashkëpunimin gjyqësor dhe policor në fushën penale, me standardet e Bashkimit Evropian.

Një hap pozitiv në drejtim të bashkëpunimit ndërkombëtar ishte hapja e Zyrës së Prokurorit Ndërlidhës të Shqipërisë pranë selisë së Eurojust në vitin 2021. Evidentohet se ka patur një rritje të numrit të çështjeve të regjistruara në Zyrën Ndërlidhëse Shqiptare në EUROJUST si edhe ngritjes së Skuadrave të reja të Përbashkëta Hetimore.



Organizimi i Sistemit të Prokurorisë në Shqipëri

Ashtu sikurse u theksua edhe në hyrje të këtij studimi, prokuroria është organi që ka pësuar ndryshimet më drastike nga reforma në sistemin e drejtësisë. Ndryshimet kushtetuese të vitit 2016, ndryshuan sistemin e prokurorisë nga një sistem i centralizuar në një sistem që fokusohet në pavarësinë e brendshme të prokurorit.

Këshilli i Lartë i Prokurorisë nga një organ këshillimor, u krijua si një organ i pavarur kushtetues që garanton pavarësinë, llogaridhënien, disiplinën, statusin dhe karrierën e prokurorëve të Republikës së Shqipërisë.

Gjithashtu ndryshimet e reformës sollën edhe krijimin e institucionit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, i cili kryen verifikimin e ankesave, hetimin me nismë të shkeljeve dhe fillimin e procedimit disiplinor ndaj prokurorëve të të gjitha niveleve, anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe të Prokurorit të Përgjithshëm si dhe të inspektimit të zyrave të prokurorisë.

Prokuroria është organ kushtetues, organizimi dhe funksionimi i së cilës rregullohet me dispozitat e pjesës së dhjetë të Kushtetutës “Prokuroria”, ku janë parashikuar parimet dhe funksionet e saj si organi që ushtron ndjekjen penale si dhe përfaqëson akuzën në gjyq në emër të shtetit. Kushtetuta përcakton se prokuroria është organizuar dhe funksionon pranë sistemit gjyqësor.

Prokuroria është organ i pavarur që garanton mbarëvajtjen, kontrollin e veprimeve të saj dhe respekton pavarësinë e brendshme të prokurorëve për hetimin dhe ndjekjen penale, sipas ligjit. Prokuroria i ushtron funksionet në mënyrë të pavarur nëpërmjet prokurorëve. Misioni i prokurorisë është t’i shërbejë publikut duke proceduar veprat penale me përgjegjësi, në mënyrë të drejtë, të paanshme dhe objektive, të mbrojtë të drejtat e individit dhe të bashkëpunojë me të gjithë aktorët e sistemit të drejtësisë për të forcuar zbatimin e ligjit dhe shtetin e së drejtës.

Prokuroria organizohet dhe funksionon pranë sistemit gjyqësor dhe përbëhet nga:

- a) Prokuroria e Përgjithshme;
- b) Prokuroria e Posaçme, sipas ligjit të posaçëm;
- c) prokuroritë pranë gjykatave të apelit me juridiksion të përgjithshëm;
- d) prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm.

Drejtimi dhe përfaqësimi i prokurorisë, bëhet, respektivisht, nga:


- a) Prokurori i Përgjithshëm;
- b) Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme;
- c) drejtuesit e prokurorive pranë gjykatave të apelit me juridiksion të përgjithshëm;
- d) drejtuesit e prokurorive pranë gjykatave të shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm.

Prokurori i Përgjithshëm është drejtuesi i Prokurorisë së Përgjithshme dhe ka përgjegjësi për punën e Prokurorisë dhe të prokurorive pranë gjykatave të juridiksionit të përgjithshëm të shkallës së parë dhe apelit. Prokurori i Përgjithshëm zgjidhet me tre të pestat e anëtarëve të Kuvendit, mes tre kandidatëve të propozuar nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, për një mandat 7-vjeçar dhe pa të drejtë riemërimi. Prokurori i Përgjithshëm emërohet në përputhje me nenin 148/a të Kushtetutës. Prokurori i Përgjithshëm përfaqëson akuzën në Gjykatën e Lartë dhe çështjet në Gjykatën Kushtetuese, me përjashtim të rastit kur përfaqësimi bëhet nga Prokuroria e Posaçme. Prokurori i Përgjithshëm nxjerr udhëzime të përgjithshme për prokurorët e prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm dhe oficerët e Policisë Gjyqësore dhe mbikëqyr zbatimin e tyre, raporton në Kuvend për gjendjen e kriminalitetit në vend, i kërkon Inspektorit të Lartë të Drejtësisë të kryejë inspektime tematike ose hetime për shkeljet individuale, administron sistemin e përgjimeve dhe ushtron të tjera kompetenca sipas nenit 38 të Ligjit Nr. 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”.

Prokurorët në ushtrimin e detyrës u nënshtrohen Kushtetutës, marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë dhe ligjeve të tjera në fuqi. Prokurorët i ushtrajnë kompetencat e tyre duke respektuar parimet e procedimit të drejtë, të barabartë e të rregullt ligjor dhe mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe interesit publik.

Në kuadër të zbatimit të hartës së re gjyqësore, nga data 1 Shkurt 2023, 5 prokurori pranë gjykatave të apelit ndërprejnë veprimtarinë dhe pushuan së ekzistuari dhe nga data 1 Maj 2023, 9 prokurori pranë gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm ndërprejnë veprimtarinë dhe pushuan së ekzistuari.

Struktura Organizative e Institutcionit të Prokurorit të Përgjithshëm në Shqipëri



Burimi:

(Prokuroria e Përgjithshme, 2020) Link: <https://www.pp.gov.al/Organizimi/Struktura/>



1. Pavarësia dhe Paanësia




Tabela I/A Standardet ndërkombëtare në lidhje me Pavarësinë dhe Paanësinë

<p>Statusi dhe roli i prokurorëve, Guida e Zyrës së Kombeve të Bashkuara për Drogën dhe Krimin dhe Shoqatës Ndërkombëtare të Prokurorëve (2014)</p>	<p>Neni 20: Standardet ndërkombëtare theksojnë pavarësinë e prokurorisë nga njëra anë dhe domosdoshmërinë e bashkëpunimit me pushtetin ekzekutiv dhe legjislativ nga ana tjetër. Kështu Udhëzuesi i Komeve të Bashkuara rekomandon: “Për të siguruar drejtësinë dhe efektshmërinë e ndjekjes penale, prokurorët duhet të përpiqen të bashkëpunojnë me policinë, gjykatat, profesionistët ligjorë, mbrojtësit publikë dhe agjencitë ose institucionet e tjera qeveritare”. Standardet ndërkombëtare theksojnë se për të siguruar drejtësinë dhe efektshmërinë e ndjekjes penale, prokurorët duhet të përpiqen të bashkëpunojnë me policinë, gjykatat, mbrojtësit publikë dhe agjencitë ose institucionet tjera të qeverisë.</p> <p>2.2. Gjithashtu, prokurorët duhet të jenë objektivë dhe të drejtë gjatë proceseve gjyqësore. Në veçanti, ata duhet të sigurojnë që gjykatës t’i paraqiten të gjitha faktet dhe argumentet ligjore të nevojshme për vendosjen e drejtësisë.</p> <p>Standardet nënvizojnë se prokurorët japin “llogari” ndaj gjykatave në masën që veprimet e tyre gjithmonë janë nën hetimin e gjykatave dhe në disa raste mund të rishikohen nga gjykatat. Shembuj të “llogaridhënies” përfshijnë rishikimin e vendimit të prokurorit për të mos ndjekur penalisht një person të caktuar.</p>
<p>Raportit “Mbi standardet evropiane lidhur me pavarësinë e sistemit gjyqësor: Pjesa e II – Shërbimi i Prokurorisë”, adoptuara në datë 17-18 Dhjetor 2010, nga Komisioni i Venecias”</p>	
<p>Rekomandim (2000) 19, “Mbi rolin e prokurorisë publike në sistemin e drejtësisë penale”</p>	<p>Neni 11: Këshilli i Europës (KE) thekson se “Shtetet duhet të marrin masa të përshtatshme për të siguruar që prokurorët publikë të jenë në gjendje të kryejnë detyrat pa ndërhyrje të pajustificuara civile apo penale”. Megjithatë, nga ana tjetër, prokuroria duhet të japi llogari periodikisht dhe publikisht për aktivitetet e saj në tërësi dhe, në veçanti për mënyrën se si u zbatuan prioritetet e saj.</p> <p>Neni 12: Gjithashtu, KE thekson se prokurorët publikë nuk duhet të ndërhyjnë në kompetencat e pushtetit ekzekutiv dhe legjislativ</p> <p>Neni 14: Qeveria duhet të marrë masa, shteti duhet të marrë masa efektive për të garantuar që pavarësia e prokurorisë të jetë e përcaktuar me ligj.</p> <p>Neni 15: Për më tepër, për të promovuar efektshmërinë e masave kundër krimit, prokurorët publikë duhet të bashkëpunojnë me agjenci dhe institucione qeveritare në masën e lejuar nga ligji.</p> <p>Neni 16: Prokurorët duhet, në çdo rast, të jenë në gjendje të ndjekin pa pengesa zyrtarë publikë për veprat penale të kryera nga ata, veçanërisht korrupsioni, përdorimi i paligjshëm të burimeve.</p> <p>Neni 17: Shtetet duhet të marrin masa të përshtatshme për të garantuar se statusi ligjor, kompetencat dhe roli procedural i prokurorëve janë të vendosur në mënyrë të tillë që të mos ketë dyshim legjitim në lidhje me pavarësinë dhe pavarësinë e gjykatësve. Në veçanti, shtetet duhet të garantojnë që një person nuk mund të kryejë detyra si prokuror publik dhe gjykatës në të njëjtën kohë.</p> <p>Neni 19: Për më tepër, prokurorët duhet të respektojnë qartësisht pavarësinë dhe paanshmërinë e gjykatësve; në veçanti, ata nuk duhet të hedhin dyshime mbi vendimet gjyqësore ose të pengojnë zbatimin e tyre.</p>



1.1. Garantimi ligjor i pavarësisë së shërbimit të prokurorisë dhe prokurorëve

Garantimi ligjor i pavarësisë së shërbimit të prokurorisë dhe prokurorëve përbën një element të rëndësishëm për të siguruar ushtrimin e kompetencave ligjore.

Një nga ndryshimet thelbësore që synoi të sillte reforma në sistemin e drejtësisë ishte siguri dhe garantimi i pavarësisë së prokurorëve dhe vetë sistemit të prokurorisë nga ndikimet e jashtme, por dhe ato brenda vetë institucionit.

Garantimi i pavarësisë së institucionit të prokurorisë dhe pavarësisë së brendshme të prokurorëve parashikohet në kushtetutë,⁴ ligje⁵ si edhe një sërë udhëzimesh të përgjithshme.

Kodi i Procedurës Penale përcakton gjithashtu në nenin 25, pika 2 pavarësinë e prokurorit në ushtrimin e kompetencave të tij.

1.2. Buxheti i Shërbimit të Prokurorisë

Pavarësia financiare e shërbimit të prokurorisë përbën gjithashtu një tjetër tregues kryesor për ushtrimin e kompetencave në mënyrë të pavarur dhe efektive.

Kushtetuta sanksionon se Prokurori i Përgjithshëm propozon dhe administron buxhetin e prokurorisë, me përjashtim të buxhetit të Prokurorisë së Posaçme.⁶

Legjislacioni sanksionon që prokuroria ka buxhet të pavarur, si pjesë e Buxhetit të Shtetit dhe parashikohet në një zë të veçantë të tij.⁷ Buxheti hartohet nga Prokurori i Përgjithshëm dhe zbatohet në përputhje me legjislacionin përkatës të menaxhimit buxhetor dhe financiar.⁸

Theksohet se në rastin kur propozimi i buxhetit të prokurorisë nga Këshilli i Ministrave është i ndryshëm nga ai i propozuar nga Prokurori i Përgjithshëm, ky i fundit ka të drejtë të marrë pjesë në procedurat parlamentare për të mbrojtur projektbuxhetin e

⁴ Neni 148 dhe 149

⁵ Ligj 97/2016, Neni 3, 6, 45; Ligj 96/2016, Neni 3

⁶ Neni 148/b, pika "ç"

⁷ Ligj Nr. 97/2016, Neni 40, pika 1

⁸ Po aty, pika 2

⁹ Po aty, pika 3

propozuar.⁹ Buxhet të pavarur ka edhe Prokuroria e Posaçme e cila rregullohet me ligj të veçantë.¹⁰

1.3. Karriera e prokurorëve

Menaxhimi dhe administrimi i proceseve që lidhen me karrierën e prokurorëve është konsideruar një nga pjesët më thelbësore për funksionimin eficient të të gjithë shërbimit të prokurorisë.

Këshilli i Lartë i Prokurorisë ka kompetenca thelbësore në drejtim të karrierës së prokurorëve ku përfshihen emërimi, vlerësimi, ngritja në detyrë, transferimi i prokurorëve të të gjitha niveleve¹¹ dhe shkarkimi nga detyra në përputhje me shkelle të caktuara.¹²

Në zbatim të ligjit "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" Këshilli i Lartë i Prokurorisë është përgjegjës për çështje të rëndësishme që lidhen me karrierën e prokurorëve ku përfshihen: a) emërimi; b) caktimi në pozicion; c) transferimi; ç) ngritja në detyrë; d) komandimi dhe riemërimi; dh) vlerësimi i veprimtarisë etike dhe profesionale; e) vendosja e masave disiplinore dhe pezullimi; ë) çdo detyrë tjetër të caktuar me ligj.¹³

Këshilli i Lartë i Prokurorisë bashkëpunon me Shkollën e Magjistraturës për rekrutimin e kandidatëve për prokurorë, në pajtim me ligjin "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" dhe emëron prokurorët pas diplomimit në Shkollën e Magjistraturës.¹⁴

Këshilli i propozon gjithashtu Kuvendit kandidatët për Prokuror të Përgjithshëm, në përputhje me Kushtetutën dhe ligjin "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë". Kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve për Prokuror të Përgjithshëm përcaktohen në ligjin "Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë".¹⁵

1.4. Pavarësia gjatë procesit penal

Pavarësia e prokurorit konsiderohet pavarësia dhe autonomia e prokurorit për marrjen e vendimeve në kryerjen e hetimeve, ndjekjen penale, përfaqësimin në gjyq të një çështje dhe/ose akuze penale dhe

¹⁰ Ligj Nr. 95/2016, Neni 56

¹¹ Kushtetuta, Neni 149/a, pika 1, gërma "a"

¹² Kushtetuta, 148/d

¹³ Ligj 115/2016, Neni 184

¹⁴ Ligj 115/2016, Neni 183, pika 1

¹⁵ Ligj 115/2016, Neni 183, pika 2,3



urdhërimin ose mbikëqyrjen e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore, pavarësisht ndikimit të paligjshëm të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të brendshëm apo të jashtëm nga çdo autoritet publik a privat apo palë në procesin penal.¹⁶

- **Vendimi për mosfillimin e procedimit**

Kodi Procedurës Penale parashikon rastet për mosfillimin e procedimit kur ekzistojnë rrethanat që nuk lejojnë fillimin e tij. Prokurori jep vendim të arsyetuar për mosfillimin e procedimit brenda 15 ditëve nga regjistrimi i kallëzimit. Ndërkohë vendimi u njoftohet menjëherë atyre që kanë bërë kallëzim ose ankim, viktimës ose trashëgimtarëve të saj, të cilët kanë të drejtën e ankimit në gjykatë brenda 10 ditëve nga njoftimi i vendimit.

Ankimi shqyrtohet nga gjyqtari që gjykon kërkesat e palëve gjatë hetimeve paraprake në dhomë këshillimi brenda 30 ditëve nga depozitimi në sekretarinë e gjykatës të kopjes së akteve që përmban fashikulli i vendimit të mosfillimit të procedimit. Prokurori, jo më vonë se 15 ditë nga paraqitja e ankimit, i dërgon gjykatës një kopje të akteve që përmban fashikulli i vendimit të mosfillimit, si dhe ka të drejtë të paraqesë parashtrime me shkrim lidhur me bazueshmërinë e ankimit.

Kur e gjen të bazuar ankimin, gjykata urdhëron prokurorin të regjistrojë procedimin dhe të kryejë hetimet e nevojshme, duke përcaktuar edhe drejtimin e tyre. Kundër vendimit palët mund të bëjnë ankim në gjykatën e apelit brenda 10 ditëve nga dita e nesërme e njoftimit të vendimit. Gjykata e apelit shqyrton ankimin në dhomë këshillimi brenda 30 ditëve nga data e marrjes së akteve.¹⁷

- **Heqja dorë e prokurorit**

Prokurori ka për detyrë të heqë dorë kur ekzistojnë arsye njëanësie për rastet e parashikuara nga neni 17.¹⁸ Mbi deklarinë e heqjes dorë vendosin, sipas detyrave përkatëse, drejtuesi i prokurorisë pranë gjykatës së shkallës së parë, i prokurorisë pranë gjykatës së apelit dhe Prokurori i Përgjithshëm dhe Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme. Për drejtuesit e prokurorive vendosin titullarët e prokurorive të një shkalle më lart. Me vendimin që pranon deklarinë e

heqjes dorë, prokurori që ka hequr dorë zëvendësohet me një prokuror tjetër.¹⁹

- **Rastet e zëvendësimit të prokurorit**

Ligji procedural penal parashikon rastet e zëvendësimit të prokurorit (Neni 16, 17, 27), i cili ndodh edhe për shkak të mungesës ose paaftësisë së tij të përkohshme fizike për punë, kur nuk është në gjendje të ushtrojë funksionet apo të respektojë afatet ligjore.

Drejtuesi i prokurorisë merr vendim me shkrim lidhur me zëvendësimin e prokurorit. Prokurori ka të drejtën të paraqesë ankim me shkrim në Këshillin e Lartë të Prokurorisë kundër vendimit të zëvendësimit, brenda 5 ditëve nga marrja njoftim.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë kryen rregullisht, të paktën çdo vit, një inspektim tematik mbi praktikën dhe shkaqet e zëvendësimit të prokurorëve.²⁰

- **Shpërndarja e çështjeve**

Shpërndarja e çështjeve rregullohet pjesërisht nga ligji 97/2016 dhe pjesërisht nga Udhëzimi i Prokurorit të Përgjithshëm nr. 3/2016, datë 29.12.2016 "Për shpërndarjen e çështjeve në prokurori".

Sipas ligjit Prokurori i Përgjithshëm përcakton rregulla të detajuara për procedurat e shpërndarjes së çështjeve, të cilat sigurojnë transparencë dhe mundësi të mjaftueshme verifikimi; kriteret për shpërndarjen e çështjeve, bazuar në ngarkesën e çështjeve dhe specializimin e prokurorëve; rastet dhe kriteret për rishpërndarjen e çështjeve si edhe mënyrën e monitorimit dhe dokumentimit të tyre.

Drejtuesi i prokurorisë siguron paanshmërinë, pavarësinë dhe efikasitetin e punës së prokurorisë, duke marrë parasysh nevojën për shpërndarjen e drejtë të ngarkesës mes prokurorëve.

- **Marrëdhëniet me gjyqtarët**

Kushtetuta sanksionon pavarësinë e Prokurorisë²¹ dhe sanksionon që prokuroria është e organizuar dhe funksionon pranë sistemit gjyqësor.²²

Gjithashtu, legjislacioni sanksionon që në marrëdhënie me gjyqtarët prokurorët duhet të

¹⁶ Udhëzim Nr. 12 datë 20.07.2020 "Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes prokurorëve dhe drejtuesve të prokurorisë, informimin, transparencën dhe garantimin e pavarësisë në Prokuroritë me Juridiksion të Përgjithshëm", Neni 3, pika 9

¹⁷ Kodi Procedurës Penale, Neni 291

¹⁸ Kodi Procedurës Penale, Neni 17 – "Heqja dorë"

¹⁹ Kodi Procedurës Penale, Neni 26

²⁰ Ligj 97/2016, Neni 49

²¹ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Neni 148, pika 2

²² Po aty, Neni 148, pika 3



respektojnë pavarësinë dhe paanshmërinë e gjyqtarëve, pavarësisht bindjes së tyre, duke mos vënë në dyshim vendimet e tyre dhe duke urdhëruar ekzekutimin e vendimeve gjyqësore me përjashtim të rasteve kur ushtrojnë të drejtën e ankimit. Për më tepër kërkohet që prokurorët të jenë objektiv gjatë procedurës gjyqësore dhe të ndihmojnë në mirëadministrimin e drejtësisë nga gjykata.

Në marrëdhëniet e Prokurorit të Përgjithshëm dhe Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme me Këshillin e Ministrave ndalohen rekomandimet për të proceduar ose jo për çështje konkrete.²³ Prokurori i Përgjithshëm ashtu sikurse edhe Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme bashkëpunojnë me komisionet hetimore parlamentare, sipas dispozitave ligjore në fuqi. Në çdo rast, hetimi penal është i pavarur nga hetimet e komisioneve parlamentare.²⁴

1.5. Mbrojtja e prokurorëve

Referuar nenit 20 të Ligjit për Statusin dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 564, datë 31.07.2019 “Për kriteret dhe procedurat për mbrojtjen e veçantë të magjistratit gjatë ushtrimit të funksionit ose për shkak të tij”, magjistratit prokuror i sigurohet mbrojtje e veçantë personale, e familjes dhe e pasurisë, kur gjatë ushtrimit të funksionit ose për shkak të tij, i rrezikohet jeta, shëndeti i tij ose i familjes, si dhe pasuria.

Mbrojtje e veçantë i sigurohet edhe magjistratit që nuk e ushtron funksionin ose që ka dalë në pension, me kërkesë të tij, në rast se cënimi lidhet me ushtrimin të mëparshëm të funksionit.

Komisioni për Mbrojtjen e Prokurorëve pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë orientohet kryesisht në garantimin e mbrojtjes së veçantë të magjistratit prokuror me kërkesë të tij ose me marrjen dijeni për situata serioze që cenojnë jetën, shëndetin dhe pasurinë e magjistratit ose të familjarëve të tij.

Kërkesa për mbrojtje të veçantë i paraqitet Komisionit për Mbrojtjen e Prokurorëve me shkrim nga magjistrati, Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, Ministri i Drejtësisë, kryetari i gjykatës ose drejtuesi i prokurorisë, ku magjistrati ushtron funksionin, si dhe çdo organ tjetër publik që, për shkak të funksionit, merr dijeni për praninë e

rrethanave serioze që rrezikojnë jetën, familjen ose pasurinë e magjistratit.

Gjatë vitit 2022 Komisioni për Mbrojtjen e Prokurorëve ka administruar 8 kërkesa për mbrojtje nga magjistratë, prokuror të cilët kanë konstatuar se për shkak të ushtrimit të funksionit të prokurorit gjendeshin në rrethana serioze që rrezikonin jetën e tyre dhe të familjes së tyre.²⁵

Vendimet e Komisionit për Mbrojtjen e Prokurorëve për dhënien e mbrojtjes së veçantë fizike të prokurorëve ose zgjatjen e dhënies së mbrojtjes së veçantë janë vlerësuar me afat kohor:²⁶

- Për 4 kërkesa është vendosur afati 3 mujour për mbrojtje fizike;
- Për 2 kërkesa është vendosur afati 6 mujour për mbrojtje fizike;
- Për 2 kërkesa është vendosur afati 1 vjeçar për mbrojtje fizike;

Raporti vjetor i Këshillit të Lartë të Prokurorisë thekson se duke patur në konsideratë shtrirjen gjeografike të kërkesave për mbrojtje të veçantë përgjatë vitit 2022, konstatohet që këto kërkesa janë paraqitur kryesisht nga magjistratë prokuror që ushtrojnë funksionet, kryesisht, në prokuroritë më të mëdha të vendit. Kjo shtrirje gjeografike e kërkesave për mbrojtje vazhdon të qëndrojë në zonat ku ka aktivitet të shtuar dhe të rëndë kriminal.

²³ Ligj 97/2016, Neni 103

²⁴ Ligj 97/2016 Neni 104

²⁵ Këshilli i Lartë i Prokurorisë, Raporti Vjetor 2022

²⁶ Po aty

Tabela I: Vlerësimi i Indikatorëve që lidhen me PAVARËSINË dhe PAANËSINË

Dimensioni	Nën-Dimensionet	Kategoritë	Indikatorët	Vlerësim negativ	Vlerësim i pjesshëm	Vlerësim pozitiv	Vlerësim i munguar
Pavarësia/ Paanësia	Pavarësia institucionale: Struktura dhe Organizimi	Kudri ligjor i cili garanton pavarësinë e shërbimit të prokurorisë dhe prokurorëve	Garantimi formal ligjor i pavarësisë së prokurorisë dhe prokurorëve				
			Garantimi i pavarësisë dhe autonomisë së prokurorit në marrjen e vendimeve në kryerjen e hetimeve				
			Garantimi i pavarësisë dhe autonomisë së prokurorit në ndjekjen penale				
			Garantimi i pavarësisë dhe autonomisë së prokurorit në përfaqësimin e akuzës dhe/ose çështjes në gjyq				
			Garantimi i pavarësisë dhe autonomisë së prokurorit në urdhërimin ose mbikëqyrjen e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore				
			Refuzimi i ndërhyrjeve dhe ushtrimit të ndikimit të paligjshëm				
		Buxheti i shërbimit të prokurorisë	Miratimi i buxhetit për shërbimin e prokurorisë bazohet në kriteret të qarta që lidhen me pavarësinë e institucionit				
			Shërbimi i prokurorisë përfshihet në fazat e hartimit, propozimit, miratimit, administrimit dhe vlerësimit/auditimit të buxhetit				
			Sistemi i financimit të shërbimit të prokurorisë është transparent dhe bazuar në kriteret objektive duke marrë në konsideratë nevojat me qëllim arritjen e objektivave të caktuara				
			Buxheti i shërbimit të prokurorisë përfshin të ardhura nga donacione dhe çdo të ardhur tjetër të ligjshme				
		Administrimi dhe Organizimi i Shërbimit të Prokurorisë	PP është përgjegjëse për mbarvajtjen e punës së Prokurorisë së Përgjithshme dhe të prokurorëve pranë gjykatave të juridiksionit të përgjithshëm të apelit dhe shkallës së parë				
			PP përcakton rregulla të detajuara lidhur me procesin e emërimit të Sekretarit të Përgjithshëm				
			PP përcakton rregullat dhe procedurat për përzgjedhjen dhe rregullimin e marrëdhënieve të punës së ekspertëve në Sektorët e Ekspertizës në PP				
			Këshilltarët ligjorë jomagjistratë në Njësinë e Shërbimit Ligjor emërohen nga PP				
			PP miraton rregulla të detajuara për numrin e këshilltarëve ligjorë dhe funksionimin e Njesisë së Shërbimit Ligjor pranë Prokurorisë së Përgjithshme				

		PP ka kompetenca të plota në rastin e vlerësimit kualifikues, lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë, emërimit, transferimit, pezullimit, caktimit të masave disiplinore, ndërprerjes së marrëdhënies në shërbimin civil të kancelarëve dhe këshilltarit ligjor					
		PP miraton rregulla më të hollësishme për procedurën e emërimit, pezullimit, ndërprerjen e marrëdhënies në shërbimin civil të prokurorisë					
		PP miraton rregulla të hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit, si dhe mënyrën e mbajtjes, të hedhjes, të përditësimit dhe përdorimit të të dhënave					
		PP miraton rregulla të mëtejshme për treguesit e kriterëve që lidhen me kriteret e vlerësimit, burimet dhe procedurën e vlerësimit për nëpunësit civilë					
		PP kryen formimin profesional fillestar dhe vazhdues të nëpunësve të tjerë civilë në prokurori, përgatit kurrikulën dhe miraton rregulla më të detajuara për formimin fillestar dhe atë vazhdues për gjithë nëpunësit e tjerë civilë të prokurorisë					
	Pavarësia Individuale: Statusi dhe Funksionimi i prokurorëve	Qëndrueshmëria e prokurorëve (Rekrutimi/Përzgjedhja/E mërimi Profesional)	Zgjedhja e PP kryhet në përputhje me një proces transparent, i cili bazohet në rregulla të qarta dhe kritere profesionale				
			Politikat dhe procedurat për përzgjedhjen prokurorëve janë të përcaktuara qartë dhe kandidatët i nënshtrohen kontrolleve specifike				
			Prokurorët kanë të drejtën e ankimit ndaj vendimeve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë që lidhen me karrierën e tyre				
			Kuadri ligjor dhe rregullator në lidhje me karrierën e prokurorëve gjendet i publikuar dhe përditësohet në mënyrë sistematike				
			Kuadri ligjor dhe rregullator në lidhje me karrierën e prokurorëve është i plotësuar				
Artikuj në shtyp përgjatë tre vitet e fundit kanë evidentuar raste që lidhen me karrierën e prokurorëve për shkak të lidhjeve politike, personale ose familjare							
Procedurat në rast të cënimit të pavarësisë së prokurorëve/Mbrojtja e prokurorëve		Ekzistenca e një mekanizmi/instrumenti për mbrojtjen e prokurorëve dhe familjarëve të tyre në rast të kërcënimeve					
	Ekzistenca e protokolleve dhe masave të cilat udhëzojnë në mënyrë të qartë trajtimin efikas të kërkesave për mbrojtje						
	Përdorimi në mënyrë efektive i protokolleve dhe masave në rrethana/situata kur prokurorët dhe/ose familjarët e tyre janë kërcënuar apo dëmtuar për shkak të rolit të prokurorit në një çështje të caktuar						

Pavarësia e brendshme		Statistika sistematike dhe gjithëpërfshirëse në lidhje me rastet e kërcënimeve apo dëmtimeve ndaj prokurorëve dhe familjes së tyre për shkak të ushtrimit të veprimtarisë si edhe format/mjetet e mbrojtjes të përdorura						
		Procedurat që ndiqen për ofrimin e mbrojtjes së veçantë, janë të shpejta dhe efikase në raport të drejtë me nevojën emergjente për t'u mbrojtur nga kërcënimi						
		Organet respektive disponojnë kapacitetet e nevojshme përballë evoluimit teknologjik të mënyrave dhe mjeteve për kërcënimin e jetës, shëndetit, familjes apo pronës së prokurorit						
	Të drejtat e prokurorit që lidhen me procedimin penal	E drejta e prokurorit për të mos filluar procedimin penal						
		E drejta e prokurorit për të pushuar akuzën apo çështjen						
		E drejta e prokurorit për ti kërkuar gjykatës pushimin e akuzës apo çështjen						
		E drejta e prokurorit për të hequr dorë						
		E drejta e prokurorit për të bërë ankim në gjykatën më të lartë						
	Udhëzimet e përgjithshme dhe jo të detyrueshme	Prokurori, në rastet kur vlerëson se udhëzimi i përgjithshëm është i pabazuar në ligj, apo është haptazi në kundërshtim me ligjin, mund të bëjë ankim tek një organ më i lartë						
		Kur prokurori nuk është dakord ose ka paqartësi lidhur me udhëzimet jo të detyrueshme për çështje konkrete, ka të drejtë të kërkojë me shkrim shpjegime të mëtejshme lidhur me to						
		Në rastet kur prokurori ka kërkuar shpjegime për udhëzimin jo të detyrueshëm, drejtuesi i prokurorisë ose drejtuesi i seksionit përkatës jep shpjegime mbi udhëzimet						
		Udhëzimet e përgjithshme të Prokurorit të Përgjithshëm dhe të drejtuesve të prokurorive publikohen në faqen e internetit të prokurorisë						
	Shpërndarja e çështjeve	Ekzistenca e një mekanizmi transparent për shpërndarjen e çështjeve						
		Përcaktimi i procedurave dhe rregullave të qarta në lidhje me shpërndarjen e çështjeve						
		Funksionimi i plotë dhe efikas i rregullave që lidhen me shpërndarjen e çështjeve në shërbimin e prokurorisë						
		Udhëzimet apo manualët respektive që lidhen me shpërndarjen e çështjeve në shërbimin e prokurorisë janë publikuar në faqen zyrtare të institucionit						



2.

Mbikëqyrja dhe Llogaridhënia



Tabela II/A Standardet ndërkombëtare në lidhje me Mbikëqyrjen dhe Llogaridhënien

<p>Statusi dhe roli i prokurorëve, Guida e Zyrës së Kombeve të Bashkuara për Drogën dhe Krimin dhe Shoqatës Ndërkombëtare të Prokurorëve</p>	<p>2.1 Lidhur me llogaridhënien para pushtetit ekzekutiv dhe legjislativ standardet theksojnë se:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Prokuroria mund të kërkohet të raportojë për aktivitetet e saj ose për çështje specifike tek pushteti ekzekutiv dhe legjislativ (Parlamenti). • Ministria e Drejtësisë, legjislativi si dhe institucionet financiare dhe audituese të qeverisë mund të mbahen të informuara për aktivitetet dhe shpenzimet prokurorisë, ku një nga mënyrat e raportimi është përgatitja dhe dorëzimi i raporteve vjetore. Raportimi i përfaqësuesve të prokurorisë ligjvënësve është një mënyrë tjetër. <p>Standardet theksojnë se gjatë llogaridhënies para Parlamentit, të mos lejohet që legjislativi të japë udhëzime për një prokuror për raste individuale ose të detyrojë zbulimin e informacionit që është konfidencial.</p> <p>Neni 20: Standardet ndërkombëtare theksojnë se për të siguruar drejtësinë dhe efektshmërinë e ndjekjes penale, prokurorët duhet të përpiqen të bashkëpunojnë me policinë, gjykatat, mbrojtësit publikë dhe agjencitë ose institucionet tjera të qeverisë.</p>
<p>Rekomandim (2000) 19, “Mbi rolin e prokurorisë publike në sistemin e drejtësisë penale”</p>	<p>Neni 21: Për më tepër, theksohet se prokurorët duhet të kontrollojnë ligjshmërinë e hetimit policor, në momentin kur vendosin nëse një ndjekje penale duhet të fillohet ose jo. Në këtë aspekt, prokurorët duhet të monitorojnë respektimin e të drejtave të njeriut nga policia.</p> <p>Neni 22: Në vendet ku hetimet policore kryhen ose mbikëqyrën nga prokurori, shteti duhet të marrë masa efektive për të garantuar që prokurori të mund të:</p> <ol style="list-style-type: none"> a. japë udhëzime, sipas rastit, policisë me qëllim zbatimin efektiv të politikave kundër krimit, veçanërisht në lidhje me vendimmarrjen se cilat kategori rastesh duhet të trajtohen me prioritet, mjetet e përdorura për të kërkuar prova, stafi i përdorur, koha e hetimit, informacioni që i duhet dhënë prokurorit publik, etj.; b. nëse ka disa agjenci policore në dispozicion, t'i drejtojë rastet individuale tek agjencia që e konsideron më të përshtatshme për t'u marrë me to; c. kryejë vlerësime dhe kontrole në masën e nevojshme për të monitoruar zbatimin e udhëzimeve dhe ligjit; d. të ndëshkojë ose të kërkojë ndëshkimin, nëse është e nevojshme, për shkeljet të mundshme të ligjit.
<p>Raportit “Mbi standardet evropiane lidhur me pavarësinë e sistemit gjyqësor: Pjesa e II – Shërbimi i Prokurorisë”, adoptuara në datë 17-18 Dhjetor 2010, nga Komisioni i Venecias”</p>	



2.1. Kompetencat e institucioneve në raport me shërbimin e prokurorisë

- **Këshilli i Lartë i Prokurorisë**

Megjithë rëndësinë që ka garantimi i pavarësisë së prokurorëve dhe shërbimit të prokurorisë në ushtrimin e kompetencave të tyre, raportimi dhe llogaridhënia janë instrumente të rëndësishme në drejtim të transparencës së institucionit dhe vlerësimit të performancës.

Këshilli i Lartë i Prokurorisë është organi kryesor përgjegjës për menaxhimin e sistemit të prokurorisë, i cili garanton pavarësinë, llogaridhënien, disiplinën, statusin dhe karrierën e prokurorëve të Republikës së Shqipërisë.²⁷ Këshilli i Lartë i Prokurorisë, në bashkëpunim me Ministrin e Drejtësisë, harton, miraton dhe zbaton një plan strategjik për sistemin e prokurorisë në koordinim me strategjinë e sektorit të drejtësisë dhe sipas kritereve të përcaktuara.²⁸

KLP-ja ushtron kompetenca kryesore që lidhen me: propozimin Kuvendit të kandidatëve për Prokuror të Përgjithshëm,²⁹ emërimin e prokurorëve në Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, emërimin, ngritjen në detyrë dhe vlerësimin e prokurorëve të të gjitha niveleve, vendosjen për masat disiplinore ndaj prokurorëve, bashkëpunimin me Shkollën e Magjistraturës në lidhje me trajnimin vazhdues të prokurorëve³⁰ etj.

Përveç kompetencave më lart, Këshilli i Lartë i Prokurorisë ka gjithashtu disa kompetenca të rëndësishme që lidhen me organizimin e brendshëm të shërbimit të prokurorisë. KLP i jep mendim Prokurorit të Përgjithshëm në propozimin e numrit të prokurorëve, të cilët në bashkëpunim me njëri-tjetrin vlerësojnë së paku çdo pesë vjet, numrin e prokurorëve për çdo prokurori.³¹

Këshilli i Lartë i Prokurorisë përcakton gjithashtu rregulla të detajuara lidhur me procesin e emërimit të Sekretarit të Përgjithshëm të Prokurorisë së

Përgjithshme, i cili zgjidhet përmes një procedure të hapur dhe transparente.³²

Këshilli i Lartë i Prokurorisë përcakton rregullat dhe procedurat për përzgjedhjen dhe rregullimin e marrëdhënieve të punës së ekspertëve (Sektorët e Ekspertizës në Prokurori),³³ megjithëse këto të fundit veprojnë nën drejtimin dhe mbikëqyrjen e drejtuesit të prokurorisë ku ushtrojnë funksionet e tyre.³⁴

KLP është organi kompetent për emërimin,³⁵ transferimin,³⁶ pezullimin,³⁷ formimin profesional,³⁸ caktimin e masave disiplinore,³⁹ ndërprerjen e marrëdhënies në shërbimin civil⁴⁰ për kancelarin dhe këshilltarin ligjor. Numri i vendeve të lira për këshilltarët ligjorë për vitin e ardhshëm dhe për kancelarët për tre vitet vijuese përcaktohet nga Prokurori i Përgjithshëm, pasi merr mendimin e drejtuesve të prokurorive.⁴¹

KLP ka gjithashtu kompetenca që lidhen me lëvizjen paralele dhe ngritjen në detyrë të nëpunësve civile në prokurori. Sekretari i Përgjithshëm i Prokurorisë së Përgjithshme ose kancelari i prokurorisë njofton menjëherë dhe pa vonesë Këshillin e Lartë të Prokurorisë ose drejtuesin e prokurorisë përkatëse, sipas rastit, për vendin e lirë të krijuar në prokurori ose që mund të krijohet në të ardhmen, në çdo rast, jo më vonë se dy javë pas marrjes së informacionit.⁴² Këshilli i Lartë i Prokurorisë, në rastin e kancelarëve, ose drejtuesi i prokurorisë, në rastin e nëpunësve të tjerë, i ofron vendin kandidatit të regjistruar në listën përkatëse të nëpunësve civilë të prokurorisë.⁴³

Në rastin e lëvizjeve paralele apo ngritjes në detyrë për pozicionin e kancelarit, shqyrtimi i kërkesave dhe përzgjedhja kryhet nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, ndërkohë që KLP dhe Prokurori i Përgjithshëm, sipas rastit, miratojnë me vendim rregulla më të detajuara për procedurat për lëvizje paralele dhe ngritje në detyrë të kancelarëve dhe nëpunësve civilë të tjerë në prokurori.⁴⁴

Këshilli i Lartë i Prokurorisë miraton me vendim rregulla të hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit, të dhënat

²⁷ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Neni 149

²⁸ Ligj 115/2016, Neni 180

²⁹ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Neni 148/a dhe Ligj 97/2016, Nenet 22-37

³⁰ Ligj 115/2016, Neni 186

³¹ Ligj 97/2016, Neni 18, pika 3/Neni 19, pika 2

³² Ligj 97/2016, Neni 66, pika 4

³³ Ligj 97/2016, Neni 67, pika 3

³⁴ Ligj 97/2016, Neni 67, pika 4

³⁵ Ligj 97/2016, Neni 79

³⁶ Ligj 97/2016, Neni 86, pika 3

³⁷ Ligj 97/2016, Neni 87, pika 2

³⁸ Ligj 97/2016, Neni 72

³⁹ Ligj 97/2016, Neni 97, pika 2, gërma "a"

⁴⁰ Ligj 97/2016, Neni 100, pika 3

⁴¹ Ligj 97/2016, Neni 73, pika 2

⁴² Ligj 97/2016, Neni 77, pika 4

⁴³ Ligj 97/2016, Neni 77, pika 5

⁴⁴ Ligj 97/2016, Neni 77, pika 13,14



që mbahen në to, si dhe mënyrën e mbajtjes, të hedhjes, të përditësimit dhe përdorimit të të dhënave.⁴⁵

Këshilli i Lartë i Prokurorisë miraton me vendim rregulla të mëtejshme për treguesit e kritereve që lidhen me kriteret e vlerësimit, burimet dhe procedurën e vlerësimit për nëpunësit civilë të prokurorisë.⁴⁶

- **Inspektori i Lartë i Drejtësisë**

Inspektori i Lartë i Drejtësisë është përgjegjës për verifikimin e ankesave, hetimin me nismë të shkeljeve dhe fillimin e procedimit disiplinor ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve të të gjitha niveleve, anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe të Prokurorit të Përgjithshëm, sipas procedurës së përcaktuar me ligj.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë është përgjegjës edhe për inspektimin institucional të gjykatave dhe të zyrave të prokurorisë.⁴⁷ Inspektori vihet në lëvizje bazuar në: a) ankimin me shkrim çdo të personi fizik, juridik ose organi publik të interesuar; b) ankimin me shkrim të Ministrit të Drejtësisë; c) ankimin me shkrim të Prokurorit të Përgjithshëm; ç) ankimin me shkrim të secilit anëtar të Këshillit të Lartë Gjyqësor ose të Këshillit të Lartë të Prokurorisë; d) ankimin me shkrim nga kryetari i gjykatës ku punon gjyqtari që dyshohet se ka kryer shkelje disiplinore; dh) ankimin me shkrim nga drejtuesi i zyrës së prokurorisë ku punon prokurori që dyshohet se ka kryer shkelje disiplinore.⁴⁸

Inspektori i Lartë i heton shkeljet e dyshuara edhe kryesisht, bazuar në të dhëna publike ose të siguruara në kuadrin e inspektimeve institucionale e tematike, sipas kushteve dhe procedurave të parashikuara në ligjin “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Inspektori i Lartë i Drejtësisë kryen inspektime institucionale e tematike mbi çdo aspekt të punës së gjykatave, administratës gjyqësore, zyrave të prokurorive dhe administratës së prokurorisë, bazuar në kërkesën e motivuar me shkrim të Këshillit të Lartë Gjyqësor, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, të Ministrit të Drejtësisë, të Prokurorit të Përgjithshëm dhe në planin vjetor të inspektimeve.⁴⁹

- **Këshilli i Ministrave**

Këshilli i Ministrave, jo më vonë se data 31 mars e çdo viti, miraton dhe i përcjell Prokurorit të Përgjithshëm rekomandimet prioritare që duhen ndjekur për vitin në vazhdim në luftën kundër kriminalitetit. Rekomandimet miratohen në mbledhjen e Këshillit të Ministrave dhe përmbajnë edhe informacion mbi ndryshimet e buxhetit që janë të nevojshme për realizimin e tyre.

Ministri i Drejtësisë ua bën të njohura rekomandimet e Këshillit të Ministrave drejtuesve të prokurorive të të gjitha shkallëve në një mbledhje të përbashkët, jo më vonë se një muaj nga data e miratimit të tyre nga Këshilli i Ministrave.

Këshilli i Ministrave, nëpërmjet Ministrit të Drejtësisë, ndjek në vazhdimësi mënyrën e zbatimit të rekomandimeve të dhëna prej tij.⁵⁰ Ministri i Drejtësisë bashkëpunon me Prokurorin e Përgjithshëm, Drejtuesin e Prokurorisë së Posaçme dhe Kryetarin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë në shqyrtimin paraprak të nevojave të buxhetit të tyre dhe i paraqet dhe i mbron ato në mbledhjen e Këshillit të Ministrave. Ministri i Drejtësisë ka detyrimin të depozitohet pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ankesat që paraqiten kundër prokurorëve.⁵¹

- **Kuvendi**

Bazuar në sa më lart si edhe në mekanizmin e përbashkët për monitorimin sistematik të ndjekjes dhe zbatimit të rekomandimeve të institucioneve të pavarura kushtetuese dhe atyre të krijuara me ligj,⁵² Kuvendi miraton nëpërmjet rezolutës rekomandimet vjetore për institucionin e Prokurorisë së Përgjithshme.

- **Policia Gjyqësore**

Policia gjyqësore është organizuar dhe funksionon në përputhje me dispozitat e Ligjit nr.25/2019, ndërsa veprimtaria e oficerëve të Policisë Gjyqësore mbështetet dhe kryhet sipas parashikimeve të Kodit të Procedurës Penale. Ligji 25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore” ka sjellë gjithashtu ndryshime të rëndësishme organizative për përmirësimin e rolit hetues të oficerëve të

⁴⁵ Ligj 97/2016, Neni 83, pika 4

⁴⁶ Ligj 97/2016, Neni 85, pika 11

⁴⁷ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Neni 147/d

⁴⁸ Ligj 115/2016, Neni 194, pika 2

⁴⁹ Ligj 115/2016, Neni 194, pika 3,4

⁵⁰ Ligj 97/2016, Neni 103

⁵¹ Ligj 97/2016, Neni 107

⁵² Kuvendi i Shqipërisë, Vendim 49/2017 “Për krijimin e mekanizmit të përbashkët për monitorimin sistematik të ndjekjes dhe zbatimit të rekomandimeve të institucioneve të pavarura kushtetuese dhe atyre të krijuara me ligj”



policisë gjyqësore duke theksuar rolin drejtues të prokurorëve në hetim.

Ligji parashikon vijueshmërinë e hetimit dhe ndjekjes penale nëpërmjet përcaktimit të rregullave dhe procedurave të qarta që kanë të bëjnë me transferimin e oficerëve të policisë gjyqësore të seksionit dhe shërbimeve të policisë gjyqësore duke i dhënë rol thelbësorë prokurorit të çështjes në drejtimin e hetimit.⁵³

Ligji adreson çështje të karrierës për shërbimet e policisë gjyqësore dhe oficerin e policisë gjyqësore, kjo përmes ngritjes së Komisionit të Policisë Gjyqësore me pesë anëtarë, i cili kryesohet nga një prokuror i përcaktuar nga prokurori përgjithshëm me kohë të plotë dhe ka në përbërje dhe katër oficerë që vijnë 1 nga seksioni i policisë gjyqësore, 2 anëtarë nga shërbimet e policisë gjyqësore në Policinë e Shtetit dhe 1 nga doganat dhe tatimet me rotacion.

Funksionet e Policisë Gjyqësore ushtrohen nga: a) oficerët e Policisë Gjyqësore në seksionet pranë prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm; b) punonjësit e Policisë së Shtetit, të cilët janë pjesë e strukturës hetimore; c) punonjësit e Byrosë Kombëtare të Hetimit, të cilët kanë statusin e oficerëve të Policisë Gjyqësore sipas legjislacionit në fuqi për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar, ç) punonjësit e shërbimeve të tjera policore dhe të institucioneve shtetërore të cilëve me ligj unjihen funksionet e Policisë Gjyqësore.⁵⁴

Këto funksione përfshijnë: a) marrjen e dëgjimit për veprat penale, me iniciativën e vet ose mbi kallëzim apo ankim; b) parandalimin ose pengimin e pasojave të mëtejshme që rrjedhin nga vepra penale; c) kërkimin e autorëve të veprave penale; ç) kryerjen e veprimeve të nevojshme për të siguruar burimet e provës dhe për të grumbulluar gjithçka që i shërben zbatimit të ligjit penal; d) kryerjen e çdo hetimi dhe veprimi të urdhëruar ose të deleguar nga organi procedues; dh) kryerjen e veprimeve procedurale për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore penale; e) kryerjen e veprimeve në kuadër të marrëdhënieve juridiksionale penale me autoritetet e huaja; ë) kryerjen e veprimeve në zbatim të legjislacionit për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë.⁵⁵ Organizimi i policisë gjyqësore kryhet nga shërbimet e policisë gjyqësore dhe seksionet e policisë

II. Mbikëqyrja dhe Llogaridhënia

gjyqësore në prokuroritë pranë gjykatës së shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm dhe në Prokurorinë e Përgjithshme.

2.2. Raportimi periodik mbi aktivitetin e përgjithshëm të Shërbimit të Prokurorisë

Neni 38 dhe 104 i Ligjit 97/2016 parashikon raportimin në Kuvend të Prokurorit të Përgjithshëm për gjendjen e kriminalitetit në vend, të paktën një herë në vit. Raportimi përfshin të dhëna dhe shpjegime për numrin, llojet, shtrirjen territoriale, intensitetin dhe format e kriminalitetit në Republikën e Shqipërisë.

Prokurori i Përgjithshëm informon gjithashtu mbi zbatimin e rekomandimeve prioritare të Këshillit të Ministrave në luftën ndaj kriminalitetit, si edhe nxjerrjes së udhëzimeve të përgjithshme, zbatimit, ndikimit dhe monitorimit të tyre. Prokurori i Përgjithshëm parashtron gjithashtu përpara Kuvendit të dhëna të detajuara lidhur me efektivitetin e ndjekjes penale, cilësinë e përfaqësimit të akuzës në gjyq, si dhe me elemente të tjera thelbësore në veprimtarinë e institucioneve përkatëse si edhe bashkëpunon me komisionet hetimore parlamentare.

Pavarësisht dispozitave të parashikuara për raportim, hetimi penal është i pavarur nga hetimet e komisioneve parlamentare dhe në rastet e raportimit në Kuvend nuk lejohet njoftimi për çështje konkrete, me përjashtim të çështjeve të dërguara me vendim të Kuvendit.⁵⁶ Prokurori i Përgjithshëm raporton gjithashtu të paktën një herë në vit në Këshillin e Lartë të Prokurorisë lidhur me ecurinë e veprimtarisë së strukturave përkatëse.⁵⁷

Institucionet e tjera si Këshilli i Lartë i Prokurorisë dhe Inspektori i Lartë i Drejtësisë, të cilat luajnë një rol të rëndësishëm në aktivitetin e shërbimit të prokurorisë dhe prokurorëve raportojnë në mënyrë periodike tek Kuvendi i Shqipërisë dhe janë gjithashtu subjekt i Rezolutave që Kuvendi përgatit mbi vlerësimin e veprimtarisë së këtyre institucioneve.

Respektivisht Këshilli i Lartë i Prokurorisë raporton para Kuvendit mbi gjendjen e sistemit gjatë vitit të mëparshëm kalendarik jo më pak se një herë në vit. Raporti i KLP i cili i përcillet Kuvendit jo më vonë se

⁵³ Ligj 25/2019, Neni 22

⁵⁴ Po aty, Neni 4

⁵⁵ Po aty, Neni 5

⁵⁶ Ligj 97/2016, Neni 104, pika 3,4

⁵⁷ Ligj 97/2016, Neni 105



data 1 maj e çdo viti,⁵⁸ përshkruan veprimtarinë e Këshillit dhe të komisioneve të tij, si dhe përmban rekomandimet për përmirësimet e nevojshme.

Këshilli i përgjigjet kërkesës së Kuvendit për të paraqitur raportin dhe për t'iu përgjigjur pyetjeve në lidhje me të. Rekomandimet e përcjella në rezolutën e miratuar nga Kuvendi për raportin vjetor të Këshillit të Lartë të Prokurorisë janë të detyrueshme për t'u marrë parasysh nga Këshilli, për aq sa nuk çenojnë pavarësinë e këtij institucioni. Këshilli raporton në çdo rast tjetër që e vlerëson të nevojshme ose me kërkesë të Kuvendit.⁵⁹

ILD jo më pak se një herë në vit raporton gjithashtu në Kuvend për punën e Zyrës së Inspektorit në vitin pararendës.⁶⁰

Gjithashtu një pjesë e rëndësishme e raportit vjetor të këtyre institucioneve është edhe vlerësimi në lidhje me nivelin e zbatimit të rezolutave të Kuvendit. Tabelat më poshtë japin një paraqitje të përmbledhur të nivelit të përmbushjes së rekomandimeve të Rezolutës së Kuvendit për Prokurorin e Përgjithshëm, Këshillin e Lartë të Prokurorisë dhe Inspektorin e Lartë të Drejtësisë.

⁵⁸ Këshilli i Lartë i Prokurorisë, Raporte: <https://klp.al/raportime/>

⁵⁹ Ligj 115/2016, Neni 181

⁶⁰ Ligj 115/2016, Neni 204, pika 1, gërma “d”



Niveli i zbatimit të rezolutës së Kuvendit për Prokurorin e Përgjithshëm për vitin 2022 ⁶¹		Përbushur plotësisht	Përbushur pjesërisht
1.	Të vijojë rritja e rolit proaktiv të prokurorit në hetimin paraprak, në funksion të shtimit të hetimeve të filluara kryesisht nga vetë organi i prokurorisë, duke zbatuar standardet më të mira në drejtim të garantimit të të drejtave të njeriut në procedimet penale, të drejtat për proces të rregullt, të parimit të barazisë së shtetasve përpara ligjit dhe parimit të proporcionalitetit, parimit të ligjshmërisë, objektivitetit dhe paanshmërisë	√	
2.	Të nxisë prokurorët dhe oficerët e Policisë Gjyqësore për të pasur më shumë fokus, përgjegjshmëri, hetime kryesisht dhe proaktive për veprat penale në fushën e korrupsionit, referuar kompetencës lëndore të prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm, përfshirë përdorimin me efikasitet të teknikave proaktive të hetimit, për aq sa është e mundur duke vlerësuar me prioritet efektivitetin e strukturave të ngritura për parandalimin dhe goditjen e veprave penale në fushën e pastrimit të parave, të lidhura me to.	√	
3.	Të vijojë punën për konsolidimin e pavarësisë institucionale dhe funksionale të institucionit të prokurorisë dhe veçanërisht pavarësinë e prokurorëve në procesin e hetimit dhe vendimmarrjes në çështjet përkatëse duke konsideruar tejet të rëndësishme gjithashtu përgjegjshmërinë dhe llogaridhënien e tyre në funksion të rezultateve më të mira në luftën kundër krimit.	√	
4.	Të punojë për forcimin e mekanizmave për rritjen e përgjegjshmërisë dhe llogaridhënies së brendshme të oficerëve të Policisë Gjyqësore, për eficientë dhe efikasitetin e punës, pa cenuar procesin e rregullt ligjor gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre, si dhe të vijojë nxitja e prokurorëve që të ushtrojnë kontroll efektiv në punën e oficerëve të Policisë Gjyqësore, si dhe të evidentohen rastet që duhen proceduar në rrugë disiplinore.	√	
5.	Të merren masa për rritjen e cilësisë së hetimeve për veprat penale të dhunës në familje dhe veprave penale ndaj të miturve, si dhe të vijojë mbikëqyrja e zbatimit të udhëzimeve me karakter të përgjithshëm në këtë drejtim, përfshirë edhe aspekte të krijimit të statistikave të reja dhe raportimit periodik të të dhënave të sakta statistikore.	√	
6.	Të merren masa efektive për mbrojtjen e viktimave të veprave penale të dhunës në familje dhe veprave penale ndaj të miturve dhe të rritet bashkëpunimi me institucionet shtetërore që ngarkohen me përgjegjësi në këtë drejtim sipas legjislacionit në fuqi.	√	
7.	Të merren masa efektive për mbrojtjen e viktimave të veprave penale të dhunës në familje dhe veprave penale ndaj të miturve dhe të rritet bashkëpunimi me institucionet shtetërore që ngarkohen me përgjegjësi në këtë drejtim sipas legjislacionit në fuqi.	√	
8.	Të konsolidohet metodologjia dhe transparenca në hedhjen e shortit elektronik për ndarjen e çështjeve, si dhe të vijojë puna e nisur për zhvillimin dhe përfundimin e sistemit elektronik PRESTO për administrimin elektronik të regjistrave proceduralë dhe përfitimin e statistikave në kohë reale me të dhëna gjithëpërfshirëse	√	
9.	Të vijohet me përmirësimin më tej të eficientë së bashkëpunimit dhe koordinimit ndërinstucional me institucionet dhe agjencitë ligjzbatuese palë në marrëveshje dy ose shumëpalëshe, si dhe në marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet gjyqësore të huaja nëpërmjet Zyrës së Prokurorit ndërlidhës të Shqipërisë në Eurojust, veçanërisht për rritjen e numrit të skuadrave të përbashkëta hetimore dhe goditjen e veprimtarisë kriminale brenda dhe jashtë vendit.	√	
10.	Të vijojë fuqizimi i bashkëpunimit me Inspektorin e Lartë të Drejtësisë në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit të lidhur ndërmjet tyre "Për kryerjen e inspektiveve institucionale e tematike dhe për shkelje individuale të magjistratëve prokurorë në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm" dhe të vijohet roli proaktiv i Prokurorit të Përgjithshëm në bashkëpunimin me Këshillin e Lartë të Prokurorisë për të adresuar problematikat e moszbatimeve të udhëzimeve me karakter të përgjithshëm nga drejtues të prokurorive.	√	
11.	Të vijojë fuqizimi i bashkëpunimit me agjencitë ligjzbatuese rajonale dhe ndërkombëtare në funksion të efektivitetit të hetimeve për veprat penale që lidhen sidomos me trafikimin e narkotikëve, pastrimit të parave, financimin e terrorizmit, trafikimin e qenieve njerëzore, krimeve mjedisore.	√	

⁶¹ Kuvendi i Shqipërisë, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, dt.06.06.2023(Vazhdim): https://fb.watch/l6z1GK_KfZ/



12.	Të vijojë puna e nisur për forcimin e kapaciteteve profesionale në luftën kundër korrupsionit, pastrimit të parave dhe veprave penale në fushën e zgjedhjeve të lira, fushën e narkotikëve, veçanërisht sa i përket prodhimit dhe shitjes së lëndëve narkotike, si dhe hetimin e veprave penale që lidhen me zhvillimin e paligjshëm të lojërave të fatit, nëpërmjet organizimit dhe zhvillimit të aktiviteteve të përbashkëta trajnuese me institucione/agjenci ligjzbatuese, në bashkëpunim edhe me misionet e projektet ndërkombëtare që asistojnë sistemin e prokurorisë.	√	
13.	Të vijojë puna e nisur për përditësimin e manualit për pastrimin e parave dhe rikuperimin e aseteve në kuadrin e projektit FIIAPP.	√	
14.	Të angazhohet në procesin e zbatimit të hartës së re gjyqësore, duke synuar garantimin e të drejtave dhe lirive themelore të individit, me theks të veçantë tek e drejta e aksesit në drejtësi.	√	
15.	Së bashku me strukturat përgjegjëse shtetërore, organizatat e shoqërisë civile dhe asistencën e nevojshme ndërkombëtare të kontribuojë në krijimin e një qasje të integruar të politikës penale në luftën kundër kriminalitetit si një nevojë tashmë imediate e shoqërisë sonë, me fokus parandalimin e kriminalitetit tek të miturit dhe të rinjtë.	√	
16.	Të vijojë përpjekjet për përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga procesi i integritetit me Bashkimin Evropian referuar rekomandimeve të lëna në progresraportin e datës 19.10.2021.	√	

Tabela A: Niveli i zbatimit të rezolutës së Kuvendit për Prokurorin e Përgjithshëm për vitin 2022



Niveli i zbatimit të rezolutës së Kuvendit për Këshillin e Lartë të Prokurorisë për vitin 2022 ⁶²		Përbushur plotësisht	Përbushur pjesërisht
1.	Të bashkëpunojë me Prokurorin e Përgjithshëm me qëllim ndjekjen e zbatimit të udhëzimeve me karakter të përgjithshëm nga prokurorët e të gjitha niveleve dhe të angazhohet për rezultate konkrete në këtë drejtim.		
2.	Të vijojë procedurat për përzgjedhjen e prokurorëve të tjerë të Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar për të bërë të mundur sa më shpejt plotësimin e vendeve të lira në këtë institucion në zbatim të vendimit të Kuvendit nr. 6, datë 28.1.2021		
3.	Të përmbyllë në një kohë sa më të shkurtër hartimin dhe miratimin e akteve nënligjore sipas përcaktimeve në ligjet e reformës së drejtësisë, si dhe hartimin, miratimin dhe zbatimin e rregullave më të detajuara për formimin fillestar dhe atë vazhdues për nëpunësit e tjerë civilë të prokurorisë		
4.	Të përgatisë dhe të miratojë programin e përvitshëm për vlerësimin e veprimtarisë etike dhe profesionale të prokurorëve dhe fillimin e procesit të vlerësimit menjëherë. Këshilli të paraqesë një raport të detajuar për zbatimin e këtij rekomandimi brenda muajit shtator 2022		
5.	Me qëllim përbushjen e detyrimeve të nenit 170, të ligjit Nr.115/2016 të organizohen takime të përbashkëta mbi baza periodike me Këshillin e Lartë Gjyqësor duke vendosur theksin në unifikimin e interpretimit dhe zbatimit të ligjeve dhe forcimin e bashkëpunimit institucional		
6.	Në bashkëpunim me Këshillin e Lartë Gjyqësor, të miratohen rregullat e përbashkëta për bashkimin e procedimeve në rastin kur një gjyqtar dhe një prokuror janë përfshirë në të njëjtën shkellje		
7.	Në përbushje të detyrimeve ligjore dhe specifikimeve të nenit 185 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të mbajë dhe të artikulojë publikisht qëndrimet përkatëse për të garantuar pacenueshmërinë dhe mosndikueshmërinë në ushtrimin e funksioneve ligjore të prokurorëve		
8.	Të forcohet bashkëpunimi institucional me Inspektorin e Lartë të Drejtësisë dhe Shkollën e Magjistraturës në kuadër të mirëfunksionimit të sistemit të prokurorisë dhe kapërcimit të sfidave që krijohen nga vendet e lira në sistem		
9.	Të intensifikojë bashkëveprimin me Inspektorin e Lartë të Drejtësisë, me qëllim trajtimin në afate të arsyeshme të procedimeve disiplinore për prokurorët, duke pasur prioritet subjektet në proces rivlerësimi		
10.	Të ndjekë dhe të konsiderojë me përparësi angazhimet, detyrimet ligjore dhe funksionale që burojnë nga procesi i zbatimit të hartës gjyqësore		
11.	Me qëllim rritjen e mëtejshëm të transparencës së Këshillit, të publikohen në kohë vendimet dhe procesverbalet e mbledhjeve plenare dhe Komisioneve të Përhershme sipas përcaktimeve të neneve 167 dhe 168 të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, si dhe të përpunohet informacioni ndaj publikut në mënyrë sa më të unifikuar dhe të kuptueshme në faqen zyrtare të institucionit		
12.	Të plotësojë pa vonesa rekomandimet për Këshillin në progres raportin e Bashkimit Evropian të vitit 2021, si dhe detyrimet e tjera që rrjedhin nga procesi i integritetit me Bashkimin Evropian të Shqipërisë		
13.	Të vijojë dhënien e opinioneve dhe vlerësimeve për përmirësimet ligjore në përputhje me përcaktimet e nenit 187 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”		

Tabela B: Niveli i zbatimit të rezolutës së Kuvendit për Këshillin e Lartë të Prokurorisë për vitin 2022

⁶² Kuvendi i Shqipërisë, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, dt. 07.06.2023: <https://fb.watch/I6UxuOTHTL/>



Niveli i zbatimit të rezolutës së Kuvendit për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për vitin 2022 ⁶³		Përbushur plotësisht	Përbushur pjesërisht
1.	Hartimin e dispozitave të hollësishme për administrimin e sistemit të menaxhimit të çështjeve për procedurën hetimore, si dhe bërjen publik të informacionit të pjeshëm sipas përcaktimit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në përputhje dhe në zbatim të nenit 137 të ligjit nr. 9612016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.	√	
2.	Vijimin me ritme të shpejta të punës për hartimin e rregullores për trajtimin e ankesave dhe hartimin e një metodologjie të përgjithshme inspektimi.	√	
3.	Vijimin me ritme të shpejta të punës për përfundimin e procedurave të rekrutimit të inspektorëve pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.	√	
4.	Nxitjen e bashkëpunimit me Këshillin e Lartë Gjyqësor, Këshillin e Lartë të Prokurorisë, Ministrinë e Drejtësisë, Prokurorin e Përgjithshëm ose institucione të tjera për paraqitjen e kërkesave të motivuara nga ana e tyre për realizimin e inspektimeve tematike apo institucionale nga ana e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.	√	
5.	Hartimin dhe miratimin e planit vjetor të inspektimeve institucionale dhe tematike, si dhe bërjen publik të tij në faqen zyrtare të institucionit.	√	
6.	Vijimin me ritme të shpejta të trajtimit të ankesave të dorëzuara nga organet kompetente gjatë periudhës kalimtare, si dhe trajtimin me përparësi të ankesave, të cilat për shkak të parashikimeve të nenit 117 të ligjit nr. 9672016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” mund të parashkruhen, duke shmangur kështu arkivimin e tyre pa bërë të mundur verifikimin dhe hetimin nga institucioni.		
7.	Ndjekjen me prioritet të ankesave ndaj magjistratëve në proces vetingu në funksion të përgjegjshmërisë dhe llogaridhënies së tyre.	√	
8.	Trajtimin me prioritet të të gjitha rasteve të konfliktit të interesit që mund të ndeshen gjatë aktivitetit të organeve të qeverisjes së sistemit të drejtësisë.		
9.	Rishikimin e objektivave të punës dhe hartimin e një plani të ri strategjik, të shtrirë në kohë dhe sipas një metodologjie të bashkërenduar për të shërbyer si një bazë për planifikim të përgjithshëm dhe për menaxhimin e performancës.	√	
10.	Angazhimin në kryerjen e kontrollit të brendshëm në mënyrë periodike, kryesisht në llogaridhënien e inspektorëve.	√	
11.	Vijimin dhe rritjen e transparencës ndaj publikut nëpërmjet përdorimit të kanaleve të ndryshme të komunikimit publik.	√	

Tabela C: Niveli i zbatimit të rezolutës së Kuvendit për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për vitin 2022

⁶³ Inspektori i Lartë i Drejtësisë, Raportimi i punës së ILD-së për vitin 2022: <https://www.youtube.com/watch?v=RBb9SRXyp1U>



2.3. Funkcionet mbikëqyrëse ose verifikuese të strukturave të brendshme të shërbimit të shërbimit të prokurorisë

Mbikëqyrja dhe raportimi i brendshëm i shërbimit të prokurorisë janë gjithashtu elementë të rëndësishëm për mbarëvajtjen dhe ushtrimin e kompetencave ligjore dhe kushtetuese të prokurorisë, por pa cënuar pavarësinë e prokurorëve.⁶⁴

Sektori i Monitorimit në Prokurorinë e Përgjithshme është struktura e autorizuar nga Prokurori i Përgjithshëm, ndërkohë që në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë dhe pranë gjykatave të apelit me juridiksion të përgjithshëm autoriteti monitorues/mbikëqyrës dhe verifikues është drejtuesi i prokurorisë ose zëvendësdrejtuesi i autorizuar prej tij.⁶⁵

Funksionet mbikëqyrëse dhe verifikuese të kryera nga strukturat në Prokurorinë e Përgjithshme lidhur me veprimtarinë e prokurorive me juridiksion të përgjithshëm, seksioneve të policisë gjyqësore pranë tyre dhe shërbimeve të policisë gjyqësore sipas ligjit, grupohen në këto drejtime⁶⁶

- a. Ushtrimi i kompetencave kushtetuese dhe ligjore në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm dhe në seksionet e policisë gjyqësore pranë tyre sipas ligjit;
- b. Zbatimi i kuadrit ligjor të sistemit të drejtësisë penale nga prokurorët e prokurorive të apeleve dhe prokurorive pranë gjykatave të shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm, oficerët e policisë gjyqësore pranë tyre, dhe jo vetëm, në kryerjen e hetimeve, ushtrimin e ndjekjes penale, ngritjen/përfaqësimin e akuzës në gjyq, ekzekutimin e vendimeve penale dhe mbikëqyrjen e zbatimit tyre, trajtimin e të paraburgosurve, dënuarve ose viktimave në procesin penal, evidentuar në përfaqësimin e çështjeve në Gjykatë të Lartë ose Gjykatën Kushtetuese;
- c. Zbatimi i urdhrave dhe udhëzimeve të përgjithshme' të Prokurorit të Përgjithshëm nga ana e drejtuesve, prokurorëve, oficerëve të policisë gjyqësore dhe punonjësve

⁶⁴ Prokuroria e Përgjithshme, Udhëzim i Përgjithshëm nr 10/2021 i përditësuar "Për ushtrimin e funksionit të monitorimit në sistemin e prokurorisë dhe bashkëpunimin me institucionet kushtetuese dhe ligjore", Neni 3, pika 1, gërma "b"

II. Mbikëqyrja dhe Llogaridhënia

administrativë, sipas disponimeve të veçanta të parashikuara në aktin normativ konkret, si dhe rezolutave të Kuvendit të Shqipërisë dhe rekomandimeve prioritare të Këshillit të Ministrave, dhe jo vetëm;

- d. Përmbajtja dhe saktësia e të dhënave të raportit vjetor mbi ecurinë e punës në prokurorinë përkatëse përgjatë vitit paraardhës sipas ligjit;
- e. Veprimtaria organizative dhe funksionale e Policisë Gjyqësore të Seksioneve pranë prokurorive dhe veprimtaria funksionale e shërbimeve të policisë gjyqësore në strukturat përkatëse, si dhe bashkërendimi e koordinimi i punës tyre me prokuroritë pranë të cilave ushtrojnë funksionet e tyre.

Strukturat në Prokurorinë e Përgjithshme, me fokus objektin e veprimtarisë së tyre, realizojnë mbikëqyrje dhe/ose verifikime nëpërmjet kërkimit dhe administrimit në mënyrë periodike, dhe jo vetëm, të të dhënave ose informacioneve nga drejtuesit e prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm lidhur me.⁶⁷

- ecurinë e veprimtarisë procedurale penale dhe administrative të prokurorisë që drejtojnë;
- gjendjen e treguesve të kriminalitetit, të dhëna dhe shpjegime për numrin, llojet, shtrirjen territoriale, intensitetin dhe format e kriminalitetit në rrethin gjyqësor të prokurorisë që drejton;
- ecurinë e zbatimit të udhëzimeve të përgjithshme, nëse janë nxjerrë udhëzime të përgjithshme për të lehtësuar zbatimin e tyre ose udhëzime jo të detyrueshme për çështje konkrete në zbatim të udhëzimeve/rekomandimeve përkatëse, përfshirë dhe si kanë ndikuar ato mbi gjendjen e kriminalitetit dhe në fushat e rekomanduara;
- ecurinë e zbatimit të rezolutave të Kuvendit të Shqipërisë dhe rekomandimeve prioritare të Këshillit të Ministrave, sipas ligjit;
- ecurinë e zbatimit të memorandumeve/marrëveshjeve të bashkëpunimit ndërinstitucional.

⁶⁵ Po aty, Neni 4

⁶⁶ Po aty

⁶⁷ Po aty, Neni 6, pika 3



Strukturat në Prokurorinë e Përgjithshme, pas analizës dhe vlerësimit të të dhënave të marra, sipas objektit të veprimtarisë, përgatisin informacion përmbledhës për Prokurorin e Përgjithshëm për gjetjet nga monitorimet dhe propozojnë zgjidhje afatshkurtëra dhe/ose afatgjata, në nivel politikash, ndryshime/shtesa në akte normative, nevojë për ngritje profesionale, inspektime tematike ose hetime për shkelje individuale të rastit.

Funksionet mbikëqyrëse apo verifikuese të Drejtuesit të prokurorisë në kompetencë dhe përgjegjësinë e tij, sipas ligjit grupohen në këto drejtime:

- a. Mbarëvajtja e punës dhe marrja e masave dhe veprimeve për të siguruar efikasitetin dhe ligjshmërinë e veprimtarisë së prokurorisë;
- b. Disiplina në punë e prokurorëve sipas ligjit;
- c. Garantimi i zbatimit korrekt të udhëzimeve të Prokurorit të Përgjithshëm sipas ligji, nxjerrja e udhëzimeve të përgjithshme për çështje të organizimit dhe funksionimit të prokurorisë që drejton, si dhe për lehtësimin e zbatimit të udhëzimeve të përgjithshme të Prokurorit të Përgjithshëm;
- d. Respektimi i etikës së prokurorit, planifikimi i punës së tyre dhe përmbushja e angazhimeve ligjore për vlerësimin profesional të prokurorëve dhe/ose oficerëve të Policisë Gjyqësore;
- e. Veprimtaria e Policisë Gjyqësore në juridiksionin e tij.

Drejtuesi i prokurorisë, realizon mbikëqyrjen periodike të veprimtarisë procedurale penale, sipas fazave të procedimit penal, dhe sipas prioriteteve të udhëzuara/rekomanduara, nëpërmjet ushtrimit të kompetencave.⁶⁸

- jep urdhra të detyrueshëm për policinë gjyqësore dhe mbikëqyr zbatimin e tyre lidhur me ushtrimin e funksioneve sipas ligjit si dhe monitoron efikasitetin dhe efektivitetin e veprimtarisë së tyre për rritjen e përgjegjshmërisë e llogaridhënies së brendshme;
- kërkon informacion për ecurinë e procedimeve dhe verifikon ecurinë dhe/ose përfundimin e çështjes, sipas ligjit;
- nxjerr udhëzime me shkrim jo të detyrueshme sipas ligjit kur e vlerëson të nevojshme;

II. Mbikëqyrja dhe Llogaridhënia

- merr vendim me shkrim për zëvendësimin e prokurorit ose oficerin e policisë gjyqësore për rastet e parashikuara në ligj.

Drejtuesi i prokurorisë realizon mbikëqyrjen periodike të veprimtarisë së prokurorisë, edhe nëpërmjet analizës së treguesve të gjendjes së kriminalitetit, mbarëvajtjes së punës, efikasitetit dhe efektivitetit në ushtrimin e ndjekjen penale sipas prioriteteve të udhëzuara rekomanduara, si dhe vlerësimit të performancës së prokurorisë që drejton, dhe sipas ligjit.⁶⁹

- informon çdo tre muaj Prokurorin e Përgjithshëm mbi gjendjen e kriminalitetit në rrethin gjyqësor të prokurorisë që drejton;
- raportin vjetor mbi ecurinë e punës në prokurorinë përkatëse ia dërgon Prokurorit të Përgjithshëm brenda muajit shkurt të çdo viti;
- është përgjegjës për mbarëvajtjen e punës dhe marrjen e masave dhe veprimeve për të siguruar efikasitetin dhe ligjshmërinë e veprimtarisë së prokurorisë që drejton;
- është përgjegjës për drejtimin, mbarëvajtjen e punës dhe marrjen e masave për bashkërendimin, koordinimin dhe mbikëqyrjen e veprimtarisë së policisë gjyqësore nën juridiksionin e tij, për të siguruar efikasitetin dhe ligjshmërinë e kësaj veprimtarie në prokurorinë që drejton;
- informon brenda 15 ditësh sektorin e monitorimit në Prokurorinë e Përgjithshme në rastet kur evidenton problematika dhe/ose shkelje që përbëjnë shkak për fillimin e procedurës disiplinore ndaj oficerëve të policisë gjyqësore të seksionit në prokurorinë që drejton, bazuar në analiza dhe vlerësime të treguesve të volumit të punës së kryer prej tyre sipas të dhënave statistikore të sistemit elektronik SVHOPGJP;
- raportin e vlerësimit të oficerëve të Policisë Gjyqësore ia dërgon Komisionit të Policisë Gjyqësore dhe Prokurorit të Përgjithshëm.

2.4. Llogaridhënia ndaj sistemit të brendshëm mbikëqyrës dhe monitorues në shërbimin e prokurorisë

Pavarësisht se shërbimi i prokurorisë ka kompetenca që lidhen me organizmin dhe funksionimin e sistemit

⁶⁸ Po aty, Neni 6, pika 1

⁶⁹ Po aty, Neni 6, pika 2



të prokurorisë, në raste të informacioneve mbi probleme tematike ose për shkelje individuale të evidentuara kryesisht ose nga veprimtaria funksionale e strukturave të Prokurorisë së Përgjithshme ose nga ankesa të dërguara nga persona fizik apo juridik në Prokurorinë e Përgjithshme apo prokurorive me juridiksion të përgjithshëm, kërkesat/ankesat i drejtohen Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ose Komisionit të Policisë Gjqësore.⁷⁰

Prokurori i Përgjithshëm, depoziton kërkesë pranë ILD-së për inspektime tematike ose hetimin për shkelje individuale, në rastet kur ka të dhëna të besueshme se është kryer shkelje disiplinore, e konstatuar nëpërmjet:

- a) mbikëqyrjes/monitorimit të zbatimit të udhëzimeve të përgjithshme;
- b) informacioneve periodike mbi ushtrimin e kompetencave kushtetuese dhe ligjore të prokurorisë;
- c) kryerjes së analizave e raporteve lidhur me ecurinë e veprimtarisë së prokurorive me juridiksion të përgjithshëm;
- d) informacione nga institucione e burime të tjera.⁷¹

Kërkesës, sipas rastit i bashkëlidhet dokumentacioni i nevojshëm lidhur me faktet, indiciet dhe provat që kanë shërbyer për të besuar se është kryer një shkelje disiplinore. Prokurori i Përgjithshëm, kërkon kryerjen e inspektimeve institucionale e tematike në një apo disa prokurori nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, duke parashtruar në kërkesë nevojën e inspektimit, problematikat e konstatuara dhe sugjeruar objektin e inspektimit, sipas rastit.⁷²

Bazuar në Raportin e Prokurorit të Përgjithshëm mbi gjendjen e kriminalitetit në Shqipëri për vitin 2022, evidentohen një sërë problematikash në lidhje me mbarëvajtjen e aktivitetit të shërbimit të prokurorisë, specifikisht marrëdhëniet me drejtuesit e prokurorive lidhur me veprimtarinë organizative dhe administrative të tyre.⁷³

Këto mangësi kanë konstatuar kryesisht në cilësinë e informimit të raporteve, të dhënat statistikore, kërkesat për informacion, raportimet periodike tre

II. Mbikëqyrja dhe Llogaridhënia

mujore, etj; si edhe mospërbushje të kërkesave për raportim dhe informim.⁷⁴

Raporti thekson se nga informacionet e përcjella nga drejtuesit e prokurorive me juridiksion të përgjithshëm përgjatë vitit 2022 lidhur me masat e marra për zbatimin e udhëzimeve të përgjithshme dhe akteve të tjera nënligjore të Prokurorit të Përgjithshëm rezultojnë se:

- i. Në një masë të konsiderueshme drejtuesit e prokurorive rezultojnë se nuk luajnë një rol dinamik dhe aktiv në ushtrimin e detyrave të tyre në këtë aspekt;
- ii. Vazhdon të mbetet problem dhënia e udhëzimeve jo të detyrueshme për çështje konkrete edhe jashtë kuadrit të planeve të veprimit, pasi vetëm në një numër të vogël të prokurorive rezultojnë që drejtuesit të nxjerrin udhëzime të kësaj natyre;
- iii. Konstatohet se në përgjithësi raportet vjetore të punës së paraqitura si në vitin 2021 ashtu edhe në vitin 2022 kanë nevojë për t'u përmirësuar në mënyrë që t'i shërbejnë analizës së gjëndjes së kriminalitetit dhe evidentimit e zgjidhjes së problemeve organizative dhe funksionale të prokurorisë.

Në vitin 2022 Prokuroria e Përgjithshme ka kërkuar hetimin disiplinor për 3 magjistratë, prej të cilëve 1 prokuror dhe 2 gjyqtarë.⁷⁵

2.5. Mbikëqyrja e veprimtarisë së policisë gjyqësore dhe raportimi

Policia Gjqësore i ushtron funksionet e saj për hetimin e çështjes konkrete, nën varësinë e prokurorit dhe drejtohet e kontrollohet prej tij.⁷⁶

Mbikëqyrja e veprimtarisë së oficerëve të policisë gjyqësore, realizohet ndëpërmjet marrjes së informacionit nga drejtuesit e prokurorisë për veprimtarinë e oficerit dhe etikën, si dhe mbikëqyrjes tematike, për grupvepra ose seksione pranë prokurorive, të cilat nga raportet dhe analizat e kryera, rezultojnë problematike në drejtim të

⁷⁰ Po aty, Neni 5

⁷¹ Po aty, Neni 9

⁷² Po aty, Neni 9, pika 3,4

⁷³ Prokuroria e Përgjithshme, Raport i Prokurorit të Përgjithshëm mbi gjendjen e kriminalitetit në Shqipëri për

vitin 2022, "Aktet normative të nxjerra nga Prokurori i Përgjithshëm dhe mbikëqyrja e zbatimit të tyre".

⁷⁴ Po aty

⁷⁵ Prezantimi i Prokurorit të Përgjithshëm të raportit vjetor për vitin 2022 para Këshillit të Lartë të Prokurorisë, fq. 26

⁷⁶ Ligj 25/2019, Neni 7, pika 1



efiçencës në kryerjen e hetimeve penale dhe/ose respektimin e kërkesave ligjore procedurale penale.⁷⁷

Vijimi i nxitjes së prokurorëve që të ushtrojnë kontroll efektiv në punën e oficerëve të Policisë Gjyqësore, si dhe evidentimin e rasteve që duhen proceduar në rrugë disiplinore për shkak të zvarritjeve dhe mungesës së dilijencës në përmbushjen e detyrave që u ngarkon ligji, ka qenë një nga rekomandimet kryesore për vitin 2022 për institucionin e Prokurorit të Përgjithshëm.⁷⁸

Në këtë aspekt raporti thekson se Prokuroria e Përgjithshme ka konsideruar ushtrimin e kontrollit efektiv në veprimtarinë e oficerëve të policisë gjyqësore në seksione nga struktura e monitorimit në Prokurorinë e Përgjithshme, si për evidentimin e veprimeve në shkelje të ligjit, ashtu dhe për të iniciuar fillimin e hetimeve për shkelje disiplinore ndaj oficerëve të policisë gjyqësore të seksioneve në prokurori dhe të shërbimeve në strukturat përkatëse të Policisë së Shtetit apo shërbimeve policore të agjencive të tjera ligjzbatuese me atributet e policisë gjyqësore.

Për shkelje disiplinore të oficerëve të policisë gjyqësore në kuadrin e bashkërendimit institucional me Komisionin e Policisë Gjyqësore, sipas ligjit i janë drejtuar Komisionit:

- I. Prokurori i Përgjithshëm, bazuar në shkeljet ligjore të evidentuara në një aktkontrolli të seksionit të policisë gjyqësore pranë një prokurorie të rrethit gjyqësor, ka kërkuar fillimi i hetimeve për shkelje disiplinore për 8 oficerë të policisë gjyqësore;
- II. Drejtuesit e prokurorive pranë gjykatave të shkallës së parë kanë kërkuar fillimin e hetimeve për shkelje disiplinore për 3 oficerë të policisë gjyqësore;
- III. Prokurorët në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë kanë kërkuar fillimin e hetimeve për shkelje disiplinore për 8 oficerë të policisë gjyqësore.

Në kuadrin e bashkëpunimit ndërinstitutional, referuar në informacionin e Komisionit të Policisë Gjyqësore, përgjatë vitit 2022 ky Komision në zbatim të kompetencave sipas ligjit për përgjegjësinë disiplinore të oficerëve të policisë gjyqësore, bazuar në propozimet e dërguara nga prokurorët e çështjeve, drejtuesit e prokurorive dhe Prokurori i

Përgjithshëm, ka urdhëruar dhe zhvilluar procedimin disiplinor për 19 oficerë të policisë gjyqësore, nga të cilët 9 persona janë oficerë të policisë gjyqësore të shërbimeve në Policinë e Shtetit dhe 10 persona janë oficerë të policisë gjyqësore të seksioneve të prokurorive pranë gjykatave të shkallës së parë.

Në përfundim të procedimit disiplinor, Komisioni ka vendosur, për 13 oficerë të policisë gjyqësore ka dhënë masa disiplinore në raport me shkeljet e kryera, konkretisht:

- vërejtje me shkrim në 8 raste;
- zbritje në detyrë në 3 raste;
- pezullim nga detyra për 2 raste;
- për 4 oficerë të policisë gjyqësore të shërbimeve është pushuar procedimi disiplinorë për arsye se nuk janë provuar shkeljet disiplinore të pretenduara.
- Ndërsa, 1 procedim disiplinor është mbartur për t'u shqyrtuar në vitin 2023.⁷⁹

⁷⁷ Prokuroria e Përgjithshme, Udhëzim i Përgjithshëm nr 10/2021 i përditësuar "Për ushtrimin e funksionit të monitorimit në sistemin e prokurorisë dhe bashkëpunimin me institucionet kushtetuese dhe ligjore", Neni 8, pika 1

⁷⁸ Prokuroria e Përgjithshme, Raport i Prokurorit të Përgjithshëm mbi gjendjen e kriminalitetit në Shqipëri për vitin 2022, pika 1.4

⁷⁹ Po aty

Tabela II: Vlerësimi i Indikatorëve që lidhen me MBIKËQYRJEN dhe LLOGARIDHËNIEN

Dimensioni	Nën-Dimensionet	Kategoritë	Indikatorët	Vlerësim negativ	Vlerësim i pjesshëm	Vlerësim pozitiv	Vlerësim i munguar
Mbikqyrja/ Llogaridhënia	Mbikqyrja e jashtme	Strukturat/Institucionet Mbikqyrëse/Monitorues e/Kontrolluese	Përdorimi i një metodologjie me indikatorë të mirëpërcaktuar në lidhje me monitorimin e shërbimit të prokurorisë				
			Ekzistenca e një sistemi/mekanizmi/instrumenti, i cili vlerëson në mënyrë të rregullt performancën e shërbimit të prokurorisë bazuar në një sërë indikatorësh të mirëpërcaktuar				
	Mbikqyrja dhe Llogaridhënia e Shërbimit të Prokurorisë	Raportimi periodik mbi veprimtarinë e Shërbimit të Prokurorisë	Shërbimi i prokurorisë raporton në mënyrë periodike mbi aktivitetin dhe gjendjen e kriminalitetit në vend				
			Prezantimi përfshin të dhëna që lidhen me llojet, shtrirjen territoriale, intensitetin dhe format e kriminalitetit				
			Shërbimi i prokurorisë raporton në mënyrë periodike mbi zbatimin e udhëzimeve të përgjithshme				
			Shërbimi i prokurorisë raporton në mënyrë periodike mbi ecurinë e zbatimit të rezolutave të Kuvendit të Shqipërisë dhe rekomandimeve prioritare të Këshillit të Ministrave				
			Shërbimi i prokurorisë raporton në mënyrë periodike mbi ecurinë e zbatimit të memorandumeve/marrëveshjeve të bashkëpunimit ndërinstytucional				
	Mbikqyrja dhe Llogaridhënia e Drejtuesit të Prokurorisë	Raportimi mbi veprimtarinë procedurale penale, gjendjen e kriminalitetit, mbarëvajtjen e punës, eficientësinë dhe efektivitetin në ushtrimin e ndjekjen penale	Drejtuesit e prokurorisë informojnë çdo tre muaj Prokurorin e Përgjithshëm mbi gjendjen e kriminalitetit				
			Drejtuesit e prokurorisë i dërgojnë Prokurorit të Përgjithshëm raportin vjetor mbi ecurinë e punës në prokurorinë përkatëse brenda muajit shkurt të çdo viti				
			Drejtuesit e prokurorisë paraqesin të dhëna të sakta në raportin vjetor				
			Drejtuesit e prokurorisë informojnë brenda 15 ditësh sektorin e monitorimit në Prokurorinë e Përgjithshme në rastet kur evidenton problematika dhe/ose shkelje që përbëjnë shkak për fillimin e procedurës disiplinore ndaj oficerëve të policisë gjyqësore të seksionit në prokurorinë që drejton, bazuar në analiza dhe vlerësime të treguesve të volumit të				



3. Cilësia dhe Efiçenca



Tabela III/A Standardet ndërkombëtare në lidhje me Cilësinë dhe Efiçencën


<p>Statusi dhe roli i prokurorëve, Guida e Zyrës së Kombeve të Bashkuara për Drogën dhe Krimin dhe Shoqatës Ndërkombëtare të Prokurorëve (2014)</p>	<p>Për më tepër theksohet se prokurorisë i duhen alokuar burime të përshtatshme në mënyrë që të përmbushi misionin e saj dhe të veprojë në mënyrë efektive.</p> <p>Neni 1: Standardet ndërkombëtare theksojnë se personat të cilët zgjidhen si prokurorë duhet të jenë individë me integritet dhe aftësi, si dhe me trajnimet dhe kualifikime të përshtatshme.</p> <p>Neni 2: Prokurorët të kenë arsimim dhe trajnim të përshtatshëm dhe të jenë të ndërgjegjshëm për parimet dhe etikën, mbrojtjen kushtetutës dhe ligjeve të të drejtave të të dyshuarit dhe të viktimës, si dhe për të drejtat dhe lirinë themelore të njohura nga ligji kombëtar dhe ndërkombëtar.</p> <p>Neni 6,7,8: Gjithashtu, theksohet se prokurorëve duhet t’u sigurohen kushtet e arsyeshme të shërbimit, përfshirë shpërblimin e përshtatshëm si dhe të përcaktohet me ligj mosha e daljes në pension. Theksohet se promovimi i prokurorëve duhet të bazohet në faktorë objektivë si kualifikimet profesionale, aftësitë, integritetin dhe përvojën. Njihet e drejta e prokurorëve për të marrë pjesë në shoqata profesionale ose organizata të tjera për të përfaqësuar interesat e tyre.</p>
<p>Raportit “Mbi standardet evropiane lidhur me pavarësinë e sistemit gjyqësor: Pjesa e II – Shërbimi i Prokurorisë”, adoptuara në datë 17-18 Dhjetor 2010, nga Komisioni i Venecias”</p>	<p>Neni 4: Standardet e Këshillit të Europës sanksionojnë se shtetet duhet të marrin masa efektive për të garantuar që prokurorët të jenë në gjendje të kryejnë detyrat dhe përgjegjësitë e tyre profesionale nën kushte ligjore dhe organizative të mjaftueshme, si dhe me burime të mjaftueshme, në veçanti burimet buxhetore, në dispozicionin e tyre.</p>
<p>Rekomandim (2000) 19, “Mbi rolin e prokurorisë publike në sistemin e drejtësisë penale”</p>	<p>Për më tepër nënvizohet se shtetet duhet të sigurojnë që:</p> <ul style="list-style-type: none"> • kriteret e përzgjedhjes, promovimit dhe transferimit të prokurorë të bazohen në procedura të paanshme dhe të përfshijnë masat kundër paragjyqimeve dhe diskriminimit në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, besimit, opinionit politik, origjinës kombëtare, sociale ose etnike, pasurisë, lindjes, statusit ekonomik. <p>Neni 7,8,35: Për më tepër, theksohet se trajnimi është e drejtë dhe detyrim i prokurorëve dhe se shtetet duhet ta shkohin trajnimin si prioritet dhe duhet të marrin masat e nevojshme për trajnimin e prokurorëve për çështje specifike si psh kriminaliteti apo bashkëpunimi ndërkombëtar.</p>



3.1. Burimet Financiare

Në faqen online të Prokurorisë së Përgjithshme nën rubrikën “Programi i Transparencës për Prokurorinë”⁸⁰ paraqitet buxheti, plani i shpenzimeve për vitin financiar në vijim dhe vitet e kaluara si dhe raportet vjetore për zbatimin e buxhetit dhe anekset (sipas viteve).⁸¹

Grafik 1: Buxheti i miratuar dhe rishikuar për Shërbimin e Prokurorisë në lek (2022-2020)



Burimi i të dhënave: Prokuroria e Përgjithshme, Raport i Prokurorit të Përgjithshëm mbi gjendjen e kriminalitetit në Shqipëri 2022, 2021, 2020

Në tërësi institucioneve të drejtësisë dhe nevojave që ato kanë adresuar i është kushtuar një vëmendje e veçantë edhe sa i përket mbështetjes financiare me qëllim realizimin sa më efikas të kompetencave të tyre.

Një nga problematikat shqetësuese për shërbimin e prokurorisë mbeten detyrimet e prapambetura për prokurorët në lidhje me gjyqin që ato kanë fituar në Gjykatën e Lartë sa i takon shtesave në pagë, shifër e cila shkon deri në 17.6 milionë euro.⁸²

⁸⁰ Prokuroria e Përgjithshme, Programi i Transparencës për Prokurorinë:

https://www.pp.gov.al/Programi_i_Transparences_per_Prokurorine/Informacion_mbi_buxhetin_dhe_te_dhenat_financiare_te_PP.html Aksesuar: 02.06.2023

⁸¹

https://www.pp.gov.al/Dokumente/Raporte_per_Monitorimin_e_Performances/ Aksesuar: 02.06.2023

⁸² Kuvendi i Shqipërisë, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, dt.06.06.2023 (Vazhdim): https://fb.watch/l6Z1GK_KfZ/

3.2. Burimet Njerëzore

Si pasojë e procesit të rivlerësimit kalimtar, edhe përgjatë vitit 2022 ka vijuar krijimi i vakancave të përkohshme dhe të përhershme, deri në 42% sa i përket shërbimit të prokurorisë.⁸³ Në vitin 2022, numri i përgjithshëm i i prokurorëve i miratuar është 321 prokurorë në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm.⁸⁴

Shpërndarja e tyre në prokuroritë sipas niveleve ka qenë specifiku 278 prokurorë në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë, 26 prokurorë në prokuroritë pranë gjykatave të apelit dhe 17 prokurorë në Prokurorinë e Përgjithshme.⁸⁵

Ndërkohë, për shkak të vakancave numri faktik i prokurorëve ka qenë 174 në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë, 16 prokurorë në prokuroritë pranë gjykatave të apelit dhe 12 prokurorë në Prokurorinë e Përgjithshme, që krahasuar me vitin 2021⁸⁶ përbëjnë ulje përkatësisht prej 1,46 % të numrit faktik total të prokurorëve.

Raport i Prokurorit të Përgjithshëm mbi gjendjen e kriminalitetit në Shqipëri për vitin 2022 thekson se pavarësisht mungesave njerëzore në sistem, gjatë vitit 2022, në organin e prokurorisë janë trajtuar 61,045 materiale kallëzuese që përbën një rritje prej 0,11% në krahasim me vitin 2021. Ndërkohë që janë mbartur, 21,865 procedime penale me një rritje prej 20,19 % krahasuar me procedimet e mbartura në vitin 2021.

Sipas raporteve respektive të institucionit të Prokurorisë së Përgjithshme, në vitin 2022 numri i prokurorëve, oficerëve të policisë gjyqësore dhe administratës për secilin nivel prokurorie është reflektuar në grafikun nr. 2 më poshtë.


⁸³ Prokuroria e Përgjithshme, Raport i Prokurorit të Përgjithshëm mbi gjendjen e kriminalitetit në Shqipëri për vitin 2022

⁸⁴ Prokuroria e Përgjithshme, Raporti vjetor mbi ngarkesën e punës së prokurorive 2022

⁸⁵ Po aty

⁸⁶ Numri faktik i prokurorëve në vitin 2021 ka qenë 205, përkatësisht 177 në prokuroritë e shkallës parë, 16 në prokuroritë e apeleve dhe 12 në Prokurorinë e Përgjithshme
Prokuroria e Përgjithshme, Raporti vjetor mbi ngarkesën e punës së prokurorive 2021


Grafik 2: Numri i prokurorëve, oficerëve të policisë gjyqësore dhe punonjësve të administratës në Prokurorinë e Përgjithshme (2022)



Burimi i të dhënave: Prokuroria e Përgjithshme, Raporti vjetor mbi ngarkesën e punës së prokurorive 2022

Siç evidentohet nga grafiku më poshtë, në të gjitha 22 prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm ka mungesa të numrit të prokurorëve aktualë krahasur me numrin e parashikuar në organikën e institucionit.


Grafik 3: Numri i prokurorëve në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm (2022)



Burimi i të dhënave: Prokuroria e Përgjithshme, Raporti vjetor mbi ngarkesën e punës së prokurorive 2022

Një situatë më e ndryshme paraqitet në lidhje me numrin e oficerëve të policisë gjyqësore në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm, ku në 16 prej tyre numri i oficerëve të policisë gjyqësore është i plotësuar sipas organikës së institucionit.


Grafik 4: Numri i oficerëve të policisë gjyësore në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm (2022)



Burimi i të dhënave: Prokuroria e Përgjithshme, Raporti vjetor mbi ngarkesën e punës së prokurorive 2022

Në lidhje me numrin e punonjësve të administratës së prokurorive pranë gjykatave të shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm, në 17 prej tyre ky numër është i plotësuar sipas organikës.


Grafik 5: Numri i punonjësve të administratës në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm (2022)



Burimi i të dhënave: Prokuroria e Përgjithshme, Raporti vjetor mbi ngarkesën e punës së prokurorive 2022

Sa i përket numrit të prokurorëve dhe punonjësve të administratës në prokuroritë pranë gjykatave të apelit me juridksion të përgjithshëm, evidentohen mungesa që lidhen vetëm me numrin e prokurorëve, ndërkohë që rezultojnë të plotësuara sipas organikës pozicionet administrative.

Grafik 6: Numri i prokurorëve dhe punonjësve të administratës në prokuroritë pranë gjykatave të apelit me juridiksion të përgjithshëm (2022)



Burimi i të dhënave: Prokuroria e Përgjithshme, Raporti vjetor mbi ngarkesën e punës së prokurorive 2022



3.3. Rekrutimi dhe Karriera e Prokurorëve

Ligji për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë⁸⁷ dhe ligji për statusin e gjyqëtarëve dhe prokurorëve⁸⁸ përcaktojnë se emërimi⁸⁹ dhe caktimi në detyrë⁹⁰ i prokurorëve bëhet nga KLP në bashkëpunim me Shkollën e Magjistraturës. Caktimi në detyrë dhe emërimi i magjistratëve të rinj, profili prokuror, që kanë përfunduar Programin e Formimit Fillestar në Shkollën e Magjistraturës është një detyrë që ligji ia ka ngarkuar KLP-së.⁹¹ Ndërkohë Komisioni i Zhvillimit të Karrierës në KLP ka si objekt të veprimtarisë një sërë çështjesh të rëndësishme që lidhen me karrierën e prokurorëve.⁹² KLP ka miratura një sërë rregulloresh për sistemin e vlerësimit të punës dhe aftësive profesionale dhe morale të prokurorëve, mbi kriteret dhe procedurën për ngritjen në detyrë, transferimin etj.⁹³

Legjislacioni është plotësuar edhe me parimet e transferimit⁹⁴, përfshirë transferimin pa pëlqim⁹⁵ dhe atë të përkohshëm.⁹⁶ Kriteret janë vendosur edhe për ngritjen në detyrë⁹⁷ dhe vlerësimin e prokurorit⁹⁸ përfshirë aftësitë profesionale,⁹⁹ organizative,¹⁰⁰ etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale¹⁰¹ dhe aftësitë personale dhe angazhimi profesional.¹⁰² Gjithashtu, janë përcaktuar burimet¹⁰³ dhe nivelet e vlerësimit¹⁰⁴. Ligji përcakton edhe rastet e shkarkimit të magjistratit.¹⁰⁵

Nga ana tjetër mungesa e vlerësimit për drejtuesit e prokurorive është konsideruar një mangësi serioze jo vetëm në transparencën dhe integritetin në emërimet, por edhe në mbarëvajtjen e punës dhe bashkërendimin e veprimtarisë së prokurorive.¹⁰⁶ Në prezantimin e raportit vjetor para KLP-së, Prokurori i Përgjithshëm evidenton si problematik procesin e promovimit/caktimit, vlerësimit të veprimtarisë, pezullimit apo shkarkimit të drejtuesve të

prokurorisë. Referuar Prokurorit të Përgjithshëm, kuadri ligjor nuk është i qartë dhe nuk parashikon vlerësimin e indikatorëve ligjorë matës të performancës së drejtuesve në veprimtarinë organizative dhe/ose administrative, dhe të marrëdhënieve të drejtuesit të prokurorisë me Prokurorin e Përgjithshëm në këtë fushë, elemente këto shumë të rëndësishëm në mbarëvajtjen e punës dhe në ushtrimin e kompetencave kushtetuese e ligjore në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm.¹⁰⁷

Caktimi i përkohshëm i prokurorëve vazhdon të mbetet një problem shqetësues, pavarësisht se KLP ka treguar një kujdes të shtuar në lidhje me këto caktime duke e zbatuar këtë dispozitë vetëm në ato raste kur caktimi i përkohshëm i një prokurori në cilësinë e Drejtuesit, apo të prokurorit të juridiksionit të përgjithshëm apo në nivel apeli, ka qenë domosdoshmëri.¹⁰⁸

Bazuar në të dhënat e raportit vjetor të KLP për vitin 2022, 13 prokurorë janë të caktuar përkohësisht si drejtues, 5 prokurorë janë caktuar përkohësisht nga Shkalla e Parë në Apel, kurse një prej tyre është caktuar nga një Prokurori pranë Gjykatës së Shkallës së Parë në një tjetër Prokurori pranë Gjykatës së Shkallës së Parë dhe 2 prokurorë rezultojnë të caktuar përkohësisht nga Prokuroria e Përgjithshme në një prokurori të shkallës së parë. Një nga masat e propozuara nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë me qëllim normalizimin dhe balancimin e efekteve të procesit të rivlerësimit kalimtar të prokurorëve janë propozimet ligjore, të cilat sugjerojnë përfshirjen në sistem të studentëve pas përfundimit të vitit të dytë akademik në Shkollën e Magjistraturës, për një periudhë kalimtare. Aktualisht ky propozim i KLP nuk është materializuar ende.

Bazuar në raportin e monitorimit për vitin 2022 të SND (2021-2025) ka ende akte nënligjore të cilat

⁸⁷ Ligj Nr. 115/2016

⁸⁸ Ligj Nr. 96/2016

⁸⁹ Ligj Nr. 96/2016, Nenet 35 - 38

⁹⁰ Ligj Nr. 96/2016, Nenet 39 - 40

⁹¹ Këshilli i Lartë i Prokurorisë, Raporti Vjetor 2021. Fq. 38

⁹² Këshilli i Lartë i Prokurorisë, Rregullore "Për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të Këshillit të Lartë të Prokurorisë", Neni 41

⁹³ Shiko, Bibliografia, Këshilli i Lartë i Prokurorisë/Vendime

⁹⁴ Ligj 96/2016, Neni 42

⁹⁵ Po aty, Neni 44

⁹⁶ Po aty, Neni 46

⁹⁷ Po aty, Neni 47, Neni 48.

⁹⁸ Po aty, Neni 69

⁹⁹ Po aty, Neni 73

¹⁰⁰ Po aty, Neni 74

¹⁰¹ Po aty, Neni 75

¹⁰² Po aty, Neni 76

¹⁰³ Po aty, Neni 77

¹⁰⁴ Po aty, Neni 78

¹⁰⁵ Po aty, Neni 111

¹⁰⁶ Reporter.al "Mungesa e vlerësimit për drejtuesit dhe promovimet pa garë shkaktojnë debat në KLP", Prill 2023: <https://www.reporter.al/2023/04/24/mungesa-e-vleresimit-per-drejtuesit-dhe-promovimet-pa-gare-shkaktojne-debat-ne-klp/>

¹⁰⁷ Prezantimi i Prokurorit të Përgjithshëm të raportit vjetor për vitin 2022 para Këshillit të Lartë të Prokurorisë, fq. 24

¹⁰⁸ Këshilli i Lartë i Prokurorisë, Raport Vjetor 2022



duhet të miratohen nga KLP-ja bazuar në kërkesat e Ligjit për Statusin dhe Ligjit për Qeverisjen. Mungesa e disa akteve të rëndësishme nënligjore krijon rrezik për zbatimin e dispozitave ligjore bazuar në interpretime të ndryshme. Përpunimi dhe miratimi i të gjitha akteve nënligjore të parashikuara nga legjislacioni parësor do të jetë prioritet i KLP-së.

3.4. Formimi Profesional dhe Trajnimet

Ligji për statusin e prokurorit njehtë drejtat dhe detyrimet për formimin vazhdues (trajnimin) të prokurorëve, duke përcaktuar edhe periudhën e formimit vazhdues.¹⁰⁹ Ndër të tjera dosja personale e magjistratëve përmban edhe pjesëmarrjen në kurset e trajnimit që magjistrati ka zhvilluar.¹¹⁰

Rritja e kapaciteteve profesionale të prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore ka qenë një nga rekomandimet e Rezolutës së Kuvendit si edhe rekomandimeve prioritare të Këshillit të Ministrave për institucionin e prokurorisë për vitin 2022.


Në këtë kontekst, drejtuesit e prokurorive u udhëzuan të koordinojnë dhe organizojnë trajnime të përbashkëta me agjencitë e zbatimit të ligjit të përfshira në luftën kundër veprave penale prioritare të rekomanduara, si dhe të lehtësojnë pjesëmarrjen e prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore në një ose më shumë trajnime të përbashkëta me agjencitë e tjera të zbatimit të ligjit në fushat e rekomanduara.¹¹¹

Gjithashtu, prokurorëve ju është kërkuar të synojnë rritjen dhe zhvillimin e kapaciteteve dhe aftësive profesionale të tyre, nëpërmjet pjesëmarrjes në trajnime apo në tryeza diskutimesh, veçanërisht për zbatimin e dispozitave të reja të Kodit Penal, si dhe trajnime të përbashkëta me oficerët e policisë gjyqësore të seksioneve dhe të strukturave hetimore në shërbimet policore, me fokus në fushat dhe drejtimet prioritare të rekomanduara.¹¹²

Pavarësisht këtij prioriteti të vendosur dhe masave të ndërmarra, konstatohet se ka një raport mjaft

disproporcional ndërmjet numri të prokurorëve të ftuar në trajnimet e zhvilluara nga Shkolla e Magjistraturës dhe atyre të cilët kanë marrë pjesë dhe janë certifikuar në këto trajnime. Për më tepër ky numër ka shënuar numrin më të ulët përgjatë vitit akademik 2021-2022.

Grafik 7: Frekuentimi i aktiviteteve nga prokurorët gjatë 3 viteve të fundit akademike



Burimi i të dhënave: Shkolla e Magjistraturës, Raportet Akademike 2021-2022; 2020-2021; 2019-2020

Prokuroria e Përgjithshme, si në aktet nënligjore të nxjerra nga Prokurori i Përgjithshëm, ashtu dhe në bashkëpunim me Shkollën e Magjistraturës, misionet/projektet ndërkombëtare¹¹³ që asistojnë sistemin e drejtësisë penale, ku përfshihet prokuroria, e konsideron prioritet rritjen profesionale të prokurorëve, me synim rritjen e efiçencës dhe efektivitetit në luftën kundër kriminalitetit, si dhe marrjen e masave për rritjen e kapaciteteve profesionale nëpërmjet organizimit të trajnimeve të prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore.

Bazuar në të dhënat e raportit të Prokurorit të Përgjithshëm mbi gjendjen e kriminalitetit në Shqipëri për vitin 2022, në kuadrin e trajnimit vazhdues dhe në zbatim të ligjit, në Shkollën e Magjistraturës janë organizuar dhe zhvilluar 61 tema në fusha të ndryshme të sistemit të drejtësisë penale, tema të përzgjedhura sipas ligjit nga 704 prokurorë dhe 83 oficerë të policisë gjyqësore pjesëmarrës.¹¹⁴

¹⁰⁹ Ligj Nr. 96/2016, Neni 5

¹¹⁰ Ligj Nr. 96/2016, Neni 38

¹¹¹ Udhëzimi i përgjithshëm nr. 02, datë 29.7.2022 "Për rekomandimet prioritare të Këshillit të Ministrave në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2022 në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm", Neni 6, pika "e"

¹¹² Po aty, Neni 7, pika "gj"

¹¹³ Memorandum Mirëkuptimi (nr. 627, datë 13.04.2021) mes Prokurorisë së Përgjithshme dhe OSBE "Për

bashkëpunimin dhe bashkërendimin në zbatimin e projekteve dhe veprimtarive në mbështetje të efiçencës së sistemit të prokurorisë shqiptare"


Shiko edhe Raportin e Prokurorit të Përgjithshëm mbi gjendjen e kriminalitetit në Shqipëri për vitin 2022, pika 1.13.6

¹¹⁴ Prokuroria e Përgjithshme, Raport i Prokurorit të Përgjithshëm mbi gjendjen e kriminalitetit në Shqipëri për vitin 2022, Aneksi 3



Megjithatë ka një rritje të theksuar të numri të prokurorëve të cilët nuk kanë marrë pjesë asnjë ditë në trajnimet e zhvilluara nga SHM dhe asnjë prokuror rezulton që nuk ka kryer në mbi 20 ditë trajnime.

Grafik 8: Ditët e trajnimit të ndjekura nga prokurorët gjatë 3 viteve të fundit akademike



Burimi i të dhënave: Shkolla e Magjistraturës, Raportet Akademike 2021-2002; 2020-2021; 2019-2020

Raporti i Komisionit Evropian për Shqipërinë për vitin 2022 thekson se cilësia e trajnimit fillestar dhe të vazhdueshëm ka nevojë të përmirësohet. Shkolla e Magjistraturës duhet të intensivikojë përpjekjet për të forcuar stafin akademik dhe për të siguruar procedura konkurruese dhe transparente rekrutimi.

Metodologjia e trajnimit të vazhduar duhet të përmirësohet duke u fokusuar më tepër në nevojat e përditshme si dhe raste studimore për gjyqtarët dhe prokurorët.

Nga ana tjetër raporti thekson se trajnimi fillestar kërkon një rishikim thelbësor, në përputhje me objektivin e trajnimit të specializuar të gjyqtarëve në fusha të ndryshme të së drejtës, duke rritur fokusin e saj praktik, veçanërisht me kurset me aspekt ligjor për çështje që lidhen me shkrimin dhe arsyetimin e vendimeve gjyqësore dhe akteve të tjera procedurale, përfshirë edhe vendimin e mosfillimit të çështjes penale. Shkolla e Magjistraturës duhet të ketë një rol proaktiv në organizimin e trajnimeve sipas nevojave të institucioneve të drejtësië 'tailored made' brenda programit të formimit vazhduar; gjithashtu SHM duhet të bashkëpunojë dhe koordinojë edhe asistencën nga donatorët dhe organizatat e shoqërisë civile në mënyrë më aktive.

3.5. Kapacitetet Teknologjike

Përmirësimi i plotë i kapaciteteve teknologjike përbën një sfidë për të gjithë institucionet e drejtësisë, ndërkohë që Rezoluta e Kuvendit parashikon si rekomandim të rëndësishëm për institucionin e Prokurorit të Përgjithshëm: vlerësimin e kapaciteteve profesionale, teknologjike dhe marrja e masave të tjera për ngritjen sa më parë të sistemit të menaxhimit të çështjeve në bashkëpunim me Qendrën e Teknologjisë së Informacionit për Sistemin e Drejtësisë pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.¹¹⁵

Pavarësisht bashkëpunimit të institucionit të Prokurorisë së Përgjithshme me Qendrën e Teknologjisë së Informacionit për Sistemin e Drejtësisë pranë Këshillit të Lartë Gjyqësorë për vlerësimin e kapaciteteve humane, teknologjike dhe marrjen e masave të tjera për ngritjen sa më parë të sistemit të menaxhimit të çështjeve në prokurori me standardet aktuale, sistemi CAMS për shkak të gjendjes së përgjithshme teknike jashtë funksionimit nuk mundëson asnjë veprimtari tjetër të teknologjisë së informacionit në administrimin e çështjeve apo të dhënave statistikore në prokurori.¹¹⁶

Ndërkohë, Kuvendi i Shqipërisë miratoi dhe akordoi me Ligji nr. 85/2022 "Për buxhetin për vitin 2023", 50 milion lekë, ose 408,163 Euro për Prokurorinë e Përgjithshme, si fazë e parë për investimin/ngritjen e sistemit të menaxhimit të çështjeve (CAMS), në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm.

Drejtorja e Teknologjisë së Informacionit në Prokurorinë e Përgjithshme është angazhuar në mbledhjen e të dhënave për sistemin e ri CAMS, draftimin e tyre për standardizimin final të termave të referencës për këtë sistem dhe integrimin e sistemit IMPRO në Prokurorinë e Përgjithshme me sistemin M-File të Ministrisë së Drejtësisë, si dhe ndërlidhjen me bazat e të dhënave shtetërorë, sistemin e Policisë së Shtetit, sistemin e Gjykatave, etj, ndërlidhje të cilat do të mundësojë dixhitalizim të plotë të proceseve të punës së prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm.¹¹⁷

Aspektet teknologjike rezultojnë të kenë ndikuar edhe veprimtarinë e Këshillit të Lartë të Prokurorisë në përmbushje të kompetencave të këtij organi. Në raportin vjetor për vitin 2022, Këshilli i Latë i Prokurorisë thekson se një nga vështirësitë e hasura

¹¹⁵ Prokuroria e Përgjithshme, Raport i Prokurorit të Përgjithshëm mbi gjendjen e kriminalitetit në Shqipëri për vitin 2022, pika 1.7

¹¹⁶ Po aty

¹¹⁷ Po aty



në zbatimin e rregullores për Vlerësimin Etik dhe Profesional të Prokurorëve ka qenë gjenerimi i të dhënave të sakta statistikore, të cilat aktualisht në zyrat e prokurorive hidhen manualisht.

Për këtë arsye, digjitalizimi e arkivave të sistemit të KLP dhe të sistemit të prokurorisë në tërësi me qëllim rritjen e kapaciteteve përpunuese dhe përdorimit të teknologjisë në tërësi, për të rritur produktivitetin, sigurinë, besueshmërinë dhe efikasitetin e punës është përcaktuar si një nga synimet dhe prioritetet kryesore për vitin 2023.¹¹⁸

Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë konsideron gjithashtu në raportin vjetor për vitin 2022 se aspektet që lidhen me zhvillimin e infrastrukturës dhe teknologjisë së informacionit kanë qenë një sfidë e cila nuk ka arritur të shënojë rezultatet e synuara.

Raporti thekson se përgjatë vitit 2022, nuk ka patur zhvillime domethënëse, kjo për shkak të projektit të rikonstruksionit dhe kohës së zgjatur për të siguruar dokumentacionin e nevojshëm tekniko- ligjor, për të modernizuar mjedisin e punës, ku padyshim janë marrë masa për të siguruar infrastrukturën e nevojshme të teknologjisë.¹¹⁹ Në këtë aspekt edhe për institucionin e ILD zhvillimi i sistemit të teknologjisë së informacionit dhe strategjisë së menaxhimit të rasteve si edhe përmirësimi i infrastrukturës së nevojshme të teknologjisë së informacionit, në veçanti për verifikimin e ankesave dhe inspektimeve, konsiderohen ndër prioritetet më të rëndësishme për vitin 2023.¹²⁰

¹¹⁸ Këshilli i Lartë i Prokurorisë, Raporti Vjetor 2022

¹¹⁹ Raporti Vjetor për punën e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për vitin 2022

¹²⁰ Po aty

Tabela III: Vlerësimi i Indikatorëve që lidhen me CILËSINË dhe EFIÇENCËN

Dimensioni	Nën-Dimensionet	Kategoritë	Indikatorët	Vlerësim negativ	Vlerësim i pjesshëm	Vlerësim pozitiv	Vlerësim i munguar	
Cilësia/Efiçenca	Kapacitetet dhe Burimet	Financiare	Shërbimi i prokurorisë ka burime të mjaftueshme financiare për të zbatuar në mënyrë efektive kompetencat e parashikuara					
			Shërbimi i prokurorisë ka burime të mjaftueshme financiare në lidhje me plotësimin e nevojave që lidhen me shpenzimet e personelit					
			Shërbimi i prokurorisë ka burime të mjaftueshme financiare në lidhje me plotësimin e nevojave që lidhen me shpenzimet operative					
			Shërbimi i prokurorisë ka burime të mjaftueshme financiare në lidhje me plotësimin e nevojave që lidhen me investimet					
			Buxheti i shërbimit të prokurorisë është rritur përgjatë 3 viteve të fundit					
		Njerëzore	Numri i prokurorëve në Prokurorinë e Përgjithshme është në përputhje me organikën e parashikuar					
			Numri i oficerëve të policisë gjyqësore në Prokurorinë e Përgjithshme është në përputhje me organikën e parashikuar					
			Numri i punonjësve të administratës në Prokurorinë e Përgjithshme është në përputhje me organikën e parashikuar					
			Numri i prokurorëve në të gjitha prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm është në përputhje me organikën e parashikuar					
			Numri i oficerëve të policisë gjyqësore në të gjitha prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm është në përputhje me organikën e parashikuar					
			Numri i punonjësve të administratës në të gjitha prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm është në përputhje me organikën e parashikuar					
			Numri i prokurorëve në të gjitha prokuroritë pranë gjykatave të apelit me juridiksion të përgjithshëm është në përputhje me organikën e parashikuar					
			Numri i oficerëve të policisë gjyqësore në të gjitha prokuroritë pranë gjykatave të apelit me juridiksion të përgjithshëm është në përputhje me organikën e parashikuar					
			Numri i punonjësve të administratës në të gjitha prokuroritë pranë gjykatave të apelit me juridiksion të përgjithshëm është në përputhje me organikën e parashikuar					
Plotësimi i vakancave me prokurorë në Prokurorinë e Përgjithshme								



4.

Transparenca, Integriteti dhe Etika




Tabela IV/A Standardet ndërkombëtare në lidhje me Transparencën/Integritetin/Etikën

<p>Statusi dhe roli i prokurorëve, Guida e Zyrës së Kombeve të Bashkuara për Drogën dhe Krimin dhe Shoqatës Ndërkombëtare të Prokurorëve (2014)</p>	<p>Seksioni 11. Prokuroria duhet të jetë në gjendje të përmbushë të drejtën e publikut për t'u informuar për aspekte të një procedimi penal, duke mos rrezikuar në të njëjtën kohë vetë procedimin nëpërmjet shpërndarjes së informacionit ose me komente që mund të konsiderohen nxitëse ose dëmtuese për një të akuzuar që është nën gjykim, ose për vetë procesin e gjyqimit.</p> <p>Faqja 32. Prokuroria duhet t'u përgjigjet pyetjeve të këtij lloji në mënyrë transparente dhe të mbrojtur, duke përforcuar kështu besimin e publikut në administrimin e drejtësisë.</p> <p>Faqja 43, pika 6/a. Prokurorët duhet të kenë të drejtë të kryejnë funksionet e tyre profesionale pa pa pengesë, ngacmim, ndërhyrje të papërshtatshme ose ekspozim të pajustificuar ndaj përgjegjësive civile e penale.</p> <p>6/i. Prokurorët duhet të kenë të drejtë për t'u çliruar nga respektimi i një urdhri të paligjshëm ose një urdhër që është në kundërshtim me standardet ose etikën profesionale.</p> <p>Faqja 47. Mekanizmat e mbikëqyrjes mund të jenë një komponent i dobishëm, pasi ato lejojnë një qasje proaktive për identifikimin e praktikave dhe procedurave potencialisht të pasigurta ligjërisht ose operacionalisht dhe zgjidhjen e tyre përpara se të kthehen në problematike.</p> <p>Faqja 72. Prokurorët duhet të jenë të kujdesshëm në lidhje me pjesëmarrjen e tyre në mediat sociale.</p> <p>Faqja 73. Prokuroria duhet gjithashtu të ketë udhëzues për krijimin e pozicionit të zëdhënësve, kontaktet me median dhe një plan komunikimi për rastet kryesore, veçanërisht ato me interes kombëtar dhe ku përfshihen çështje madhore ligjore.</p>
<p>Raportit “Mbi standardet evropiane lidhur me pavarësinë e sistemit gjyqësor: Pjesa e II – Shërbimi i Prokurorisë”, adoptuara në datë 17-18 Dhjetor 2010, nga Komisioni i Venecias”</p>	<p>Pika 57. Të gjithë prokurorët gëzojnë të drejtën të kërkojnë që udhëzimet që i drejtohen atij/asaj të jepen me shkrim. Kur ai ose ajo beson se një udhëzim është ose i paligjshëm ose bie ndesh me ndërgjegjen e tij ose të saj, duhet të disponohet një procedurë e brendshme e përshtatshme e cila mund të çojë në zëvendësimin e tij ose të saj eventual.</p> <p>Pika 58. Prokurori gjithashtu ka të drejtë të fillojë një procedurë për të lejuar zëvendësimin e tij/saj nga një prokuror tjetër kur një udhëzim besohet se është i paligjshëm ose në kundërshtim me ndërgjegjen e tij/saj.</p> <p>Pika 70. Trajnimi i duhur duhet të ofrohet për prokurorët gjatë gjithë karrierës së tyre. Rëndësia e trajnimit për prokurorët është sigurisht e të njëjtit nivel me atë të gjyqtarëve. Një trajnim i tillë duhet të përfshijë trajnime ligjore, duke përfshirë të drejtat e njeriut, si dhe trajnime menaxheriale, veçanërisht për prokurorët e lartë.</p> <p>Kreu XIII. Konkluzione</p> <p>12. Prokurorë të ndryshëm nga Prokurori i Përgjithshëm duhet të emërohen deri në pension.</p> <p>13. Në rastet disiplinore, prokurori në fjalë duhet të ketë të drejtën e dëgjimit.</p> <p>22. Një organ i veçantë si Këshilli Prokurorisë mund të luajë një rol të rëndësishëm në përcaktimin e programeve të trajnimit.</p>
<p>Rekomandim (2000) 19, “Mbi rolin e prokurorisë publike në sistemin e drejtësisë penale”</p>	<p>Pika 5/g. Shtetet duhet të marrin masa për të siguruar që prokurorët së bashku me familjet e tyre të mbrohen fizikisht nga autoritetet kur rrezikohet siguria e tyre personale si rezultat i kryerjes së funksioneve të tyre.</p> <p>Pika 7. Trajnimi për ruajtjen e etikës dhe integritetit është detyrë dhe e drejtë e të gjithë prokurorëve, para emërimit të tyre si dhe gjatë ushtrimit të detyrës. Kështu, shtetet duhet të marrin masa efektive për të siguruar që prokurorët të kenë arsimin dhe trajnimin e duhur, si para dhe pas emërimit të tyre.</p> <p>Pika 7/b. Prokurorët duhet të jenë të vetëdijshëm për mbrojtjen kushtetuese dhe ligjore të të dyshuarve, viktimave dhe dëshmitarëve.</p> <p>Pika 11. Prokuroria duhet të japë llogari periodikisht dhe publikisht për aktivitetet e saj në tërësi dhe, në veçanti, për mënyrën se si janë realizuar prioritetet e saj.</p>



4.1. Integriteti dhe Etika e Prokurorëve

Legjislacioni ngarkon Këshillin e Lartë të Prokurorisë si organ përgjegjës për miratimin e standardeve të etikës së prokurorëve dhe të rregullave të sjelljes të prokurorëve, si dhe për mbikëqyrjen e respektimit të tyre.

KLP bën publike standardet e etikës dhe rregullat e sjelljes së prokurorëve, rishikon herë pas here rregullat dhe kur është e nevojshme i ndryshon ato si dhe analizon shkallën e zbatimit dhe respektimit të rregullave të etikës dhe raporton publikisht për gjetjet.¹²¹

Gjatë vitit 2022 KLP zgjodhi Këshilltarin për Etikën nëpërmjet procedurës së komandimit,¹²² i cili shërben për një periudhë 5-vjeçare, me të drejtë rizgjedhjeje vetëm një herë. Ndër funksionet dhe detyrat kryesore që kryen Këshilltari për Etikën përfshihen:

- a) dhënia e këshillave, me kërkesë të çdo prokurori, për sjelljen më të përshtatshme, brenda dhe jashtë prokurorisë ose gjykatës, për çështje të diskutueshme të etikës;
- b) kërkimi i mendimit të Këshillit për çështje të caktuara që kanë të bëjnë me sjelljen e prokurorëve në mënyrë të përgjithshme, por jo lidhur me persona të caktuar;
- c) hartimi, publikimi dhe përditësimi vazhdimisht i një manuali informues, i cili përmban pyetje dhe përgjigje mbi dilemat etike, bazuar në standardet dhe praktikat më të mira ndërkombëtare dhe vendimet relevante të Këshillit;
- d) kujdesja në bashkëpunim me Shkollën e Magjistraturës, për trajnimin fillestar dhe të vazhdueshëm mbi çështje të etikës;
- e) raportimi me shkrim, jo më pak se një herë në vit, përpara Këshillit lidhur me veprimtarinë e tij.¹²³

Megjithëse më shumë se 1 vit nga zgjedhja e Këshilltarit për Etikën, ende nuk është realizuar një raportim për të bërë të mundur të kuptohet se cilat janë problematikat e etikës në sistem, të vlerësohet sa njihet dhe si zbatohet rregullorja për etikën dhe

eventualisht çfarë masash duhet të ndërmarrë KLP për të përmirësuar situatën.

Këshilli i Lartë i Prokurorisë miratoi gjithashtu në shkurt të vitit 2022 nëpërmjet Vendimit Nr.32, datë 24.02.2022 *“Standardet e etikës dhe rregullat e sjelljes së Prokurorit”*, një rregullore e cila synon të vendosë, ruajë dhe forcojë integritetin profesional dhe personal të prokurorëve, si dhe të rrisë efektivitetin, paanshmërinë dhe përgjegjshmërinë gjatë dhe jashtë ushtrimit të funksioneve të tyre, në emër dhe në interes të shoqërisë si pjesë e sistemit të drejtësisë penale.¹²⁴

Rregullorja përcakton një sërë parimesh mbi të cilat mbështeten standardet e etikës dhe rregullat e sjelljes së prokurorit dhe të cilat përfshijnë: pavarësinë; paanshmërinë; pastërtinë e figurës; sjelljen e hijshme dhe me vetëpërmbytje; kujdesin e duhur dhe profesionalizimin; respektin dhe aftësinë për të dëgjuar; trajtimin e brabartë dhe transparencën. Rregullorja trajton gjithashtu edhe disa aktivitete jashtë prokurorisë.¹²⁵

Drejtuesi i zyrës së prokurorisë mbikëqyr respektimin e rregullave të sjelljes dhe etikën e prokurorit dhe raporton çdo problematikë në Këshillin e Lartë të Prokurorisë, në kuadër të informacionit periodik që i kërkohet. Shkelja e Standardeve të Etikës dhe Rregullave të Sjelljes së Prokurorit kur nuk përbën shkak për përgjegjësi disiplinore merret në konsideratë në kuadër të vlerësimit etik dhe profesional të prokurorit.¹²⁶

Sipas rregullores shkelja e Standardeve të Etikës dhe Rregullave të Sjelljes së Prokurorit kur nuk përbën shkak për përgjegjësi disiplinore merret në konsideratë në kuadër të vlerësimit etik dhe profesional të prokurorit.¹²⁷

Nga ana tjetër përveç raportimit të munguar mbi veprimtarinë e Këshilltarit për Etikën, evidentohet një mungesë e theksuar e trajnimeve që lidhen me etikën. Bazuar në kalendarin e trajnimeve të Shkollës së Magjistraturës gjatë 3 viteve të fundit këto trajnime kanë qenë thuajse inekzistente.¹²⁸

¹²¹ Ligj 115/2016, Neni 182, pika 1

¹²² Këshilli i Lartë i Prokurorisë, Këshilltar Etike: <https://klp.al/keshilltar-etike/>

¹²³ Ligj 115/2016, Neni 182, pika 4

¹²⁴ Këshilli i Lartë i Prokurorisë, Rregullore “Standardet e etikës dhe rregullat e sjelljes së Prokurorit”, Nenet 3-11

¹²⁵ Po aty, Nenet 12-18

¹²⁶ Po aty, Neni 19, pika 2

¹²⁷ Po aty, Neni 19, pika 3

¹²⁸ Shkolla e Magjistraturës, Kalendarin e Trajnimeve Raport i Prokurorit të Përgjithshëm mbi gjendjen e kriminalitetit në Shqipëri për vitin 2022, Aneks 3



4.2. Media dhe Publiku

Në funksion të rritjes së transparencës të shërbimit të prokurorisë, marrëdhëniet dhe komunikimi me publikun janë konsideruar një element mjaft i rëndësishëm. Nisur nga rregullat diskrete të aplikueshme gjatë procedimit penal rregullimi i mënyrës së ndërveprimit ndërmjet medias dhe shërbimit të prokurorisë bëhet edhe më i nevojshëm.

Udhëzimi i përgjithshëm për marrëdhëniet me publikun në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm ka qëllim të unifikojë veprimtarinë e prokurorive me juridiksion të përgjithshëm në marrëdhëniet me publikun dhe median për dhënie e informacionit në lidhje me hetimin e ndjekjen penale dhe për aktivitete të tjera të prokurorive në këtë fushë.¹²⁹

Ky udhëzim njëson dhe përcakton nga kush, kur dhe në çfarë mënyre mund të jepen të dhënat për hetimin dhe ndjekjen penale të veprave penale si dhe aktivitete të tjera të prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm të cilat do t'i shpërndahen publikut. Udhëzimi parashikon gjithashtu kufizimet në dhënie e informacionit, detyrimin për të mbrojtur sekretet hetimore si edhe rastet e ndalimit të publikimit të akteve.¹³⁰

Prokurori i marrëdhënieve me publikun, i caktuar për këtë qëllim nga drejtuesi i prokurorisë, udhëheq dhe mbikëqyr shërbimin e marrëdhënieve me publikun”, ndërkohë që ky i fundit emëron një nëpunës civil si koordinator për marrëdhëniet me publikun.¹³¹ Nuk ka një informacion të qartë të publikuar në lidhje me zgjedhjen e prokurorëve për marrëdhëniet me publikun si edhe raportimeve që ato parashikohet të kryejnë.

Këshilltari për median në Prokurorinë e Përgjithshme kryen një sërë funksionesh të përcaktuara në nenin 10 pika 3 të Rregullores së Organizimit dhe Funksionimit të Prokurorisë së Përgjithshme.

Në përputhje me parashikimet ligjore¹³² Prokuroria e Përgjithshme ka publikuar Programin e Transparencës.¹³³ Aty janë të specifikuara kategoritë e informacionit të detyrueshëm për t'u bërë publik, mënyra e publikimit, si dhe parashikimet ligjore prej

të cilave lind detyrimi për publikim. Çdo prokurori e juridiksionit të përgjithshëm vendos në zbatim programin institucional të transparencës, ku përcaktohen kategoritë e informacionit që bëhet publik pa kërkesë dhe mënyra e bërjes publike të këtij informacioni.

Në faqen zyrtare të Prokurorisë së Përgjithshme, në nënseksionin “Njoftime për shtyp” e seksionit “Media”, krahas njoftimeve për procedime penale, Prokuroria e Përgjithshme publikon dhe njoftime të dedikuara posaçërisht për median.

Sipas Regjistrimit të kërkesave dhe përgjigjeve për vitin 2022 rezulton se Prokuroria e Përgjithshme i ka procesuar të gjitha kërkesat për informacion brenda afateve të parashikuara ligjore. Nga paraqitja e të dhënave tabelore, mbetet i paqartë lloji i përgjigjes nga PP, si përshembull nëse kërkesat kanë marrë përgjigje të shtjelluar, përgjigjet kanë adresuar plotësisht apo pjesërisht kërkesën, kanë kthim përgjigje për refuzim të dhënies së informacionit, kthim përgjigje për delegim apo orientimin e kërkesave për informacion.

Specialisti i marrëdhënieve me publikun në Prokurorinë e Përgjithshme:

- a) trajton ankesat dhe kërkesat që janë në kompetencë për zgjidhje të Prokurorisë së Përgjithshme;
- b) për ankesat dhe kërkesat që nuk janë në kompetencë për zgjidhje të Prokurorisë së Përgjithshme, sipas rastit i kthen përgjigje zyrtare të interesuarit ose ia përcjell institucionit kompetent;
- c) kujdeset për informimin e publikut në lidhje me veprimtarinë e prokurorisë, nëpërmjet strukturës përkatëse, si dhe për çështje të veçanta, duke zbatuar kërkesat ligjore për garantimin e sekretit dhe mbarëvajtjes së hetimit dhe në zbatim të udhëzimit të përgjithshëm nr.5/2019;
- d) ushtron detyrat e koordinatorit për të drejtën e informimit në përputhje me ligjin nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, nën kujdesin dhe mbikëqyrjen e Kabinetit.¹³⁴

¹²⁹ Prokuroria e Përgjithshme, Udhëzim i Përgjithshëm Nr. 5 datë 30.07.2019 “Për marrëdhëniet me publikun në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm”

¹³⁰ Po aty, Nenet 8, 9, 10

¹³¹ Po aty, Neni 11, pika 2,3

¹³² Ligj nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, Neni 7

¹³³ Prokuroria e Përgjithshme, Programi i Transparencës për Prokurorinë:

https://www.pp.gov.al/Programi_i_Transparencës_per_Prokurorinë/

¹³⁴ Urdhër Nr. 136, date 28.10.2020 “Për miratimin e Rregullores së Organizimit dhe Funksionimit të Prokurorisë së Përgjithshme”, Neni 15, pika 4.1.4



KLP ka miratuar gjithashtu gjatë vitit 2022 rregulloren “Për komunikimin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë me Median”, me qëllim garantimin e pasqyrit të qëndrimit institucional të Këshillit, në funksion të transparencës në komunikimin me median dhe publikun. Kjo rregullore përcakton parime, rregulla dhe procedura të veçanta, pjesë e rregullave për marrëdhëniet me publikun, komunikimin e ligjshëm, transparent, të përgjegjshëm dhe profesional të Këshillit me median e shkruar dhe elektronike, si dhe me çdo përfaqësues të saj. Sipas kësaj rregullore në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë të Prokurorisë caktohet një rubrikë e veçantë me emërtimin “Kontakti me Median”. Konkretisht kjo rubrikë mungon.

Në kuadër të transparencës institucionale, janë pasqyruar të gjitha mbledhjet plenare, seancat dëgjimore dhe aktiviteti i përditshëm i KLP-së. Vlen të theksohet se jo vetëm mbledhjet, por të gjitha aktet dhe dokumentet e rëndësishme që prodhohen nga ky institucion, gjenden të pasqyruara për publikun e gjerë në faqen zyrtare të këtij institucioni.

KLP-ja ka mundësuar edhe hartimin e një Model Kërkesë për Informim, për të gjitha ato media që bëhen pjesë e aktiviteteve dhe agjendës mediatike të Këshillit.¹³⁵

Po ashtu, nën kryesimin e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale po punohet për formatin e ri të “Regjistrin elektronik të kërkesave dhe përgjigjeve për të drejtën e informimit” (REKPD), mekanizëm i Regjistrin Elektronik të Pyetje-Përgjigjeve.¹³⁶ Sipas të dhënave në Regjistrat e Kërkesave (2022-2020) rezulton se publiku/media kanë marrë përgjigje nga KLP brenda një kohe shumë të shkurtër. Mbetet e paqartë efektshmëria e kthimit të përgjigjeve, nëse këto të fundit i kanë adresuar plotësisht nevojat e subjekteve për informacion.

Në Raportin Vjetor të KLP 2022 përmendet se gazetarët mund të paraqesin kërkesën e tyre nëpërmjet një formulari, sipas modelit të Lidhjes 1 “Formular akreditimi për Median”. Formulari i kontaktit nuk gjendet.

Në vijim të përmirësimit të komunikimit institucional, gjatë vitit 2022, KLP ka gjeneruar komunikimin me publikun, duke ardhur më pranë tij përmes krijimit të

platformave të reja komunikuese, si llogaria zyrtare në Twitter, Instagram apo edhe kanali zyrtar në Youtube. Sikundër është proceduar edhe me faqen zyrtare të internetit, www.klp.al, edhe komunikimi në rrjetet sociale ka sjellë një qasje dhe afërsi më të madhe me publikun, duke pasqyruar aty të gjithë aktivitetin e Këshillit gjatë gjithë vitit 2022 përmes publikimeve multimediale. Periodikisht në një hark njëmuor realizohet përmbledhja e publikimeve të KLP-së, përmes publikimit të një Buletini Informativ.

Përgjatë kësaj periudhe 1-vjeçare, KLP ka marrë dhe trajtuar një numër prej 35 kërkesash, në formatin elektronik dhe përmes shërbimit postar, të cilat janë trajtuar dhe kanë marrë përgjigje brenda afateve ligjore, ku një pjesë e mirë e tyre vijnë nga operatorë mediatikë, studio ligjore dhe përmbardimore dhe po ashtu qytetarë, lidhur me punën e Këshillit dhe mbi çështje specifike që përfshijnë Këshillin. Po ashtu, ka pasur kërkesa për informacion edhe nga organizata jofitimprurëse apo institucione të tjera.

4.3. Mekanizma të tjerë anti-korrupsion

- **Sinjalizimi dhe Mbrojtja e Sinjalizuesve**

Ligji për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve parashikon, i miratuar në vitin 2016 është konsideruar is një mekanizëm i rëndësishëm në luftën ndaj korrupsionit dhe raportimit të rasteve korruptive. Sipas ligjit, pranë çdo autoriteti publik, i cili ka më shumë se 80 të punësuar caktohet një njësi përgjegjëse, e cila regjistron, heton administrativisht dhe shqyrton sinjalizimet.¹³⁷

Aktualisht në faqen e Prokurorisë së Përgjithshme nuk ka një informacion të publikuar në lidhje me miratimin e akteve respektive në zbatim të ligjit për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve, të cilat përfshijnë miratimin e rregulloreve përkatëse si dhe formularët për rastet e sinjalizimit të brendshëm, të jashtëm dhe kërkesës për mbrojtje nga hakmarrja.

Duke patur parasysh numrin e organikës së institucioneve, vetëm institucioni i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka publikuar në faqen zyrtare të institucionit formularët përkatës.¹³⁸

¹³⁵ Këshilli i Lartë i Prokurorisë, Model kërkesë për informim: <https://klp.al/programi-i-transparences/model-kerkesa-per-informim/>

¹³⁶ Këshilli i Lartë i Prokurorisë, Raporti Vjetor 2022

¹³⁷ Ligj Nr. 60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”, ndryshuar me Ligjin nr.150/2020, datë 17.12.2020, Neni 10, pika 1.

¹³⁸ Inspektor i Lartë i Drejtësisë (ILD), Formularë Sinjalizimi: <https://ild.al/sq/formulare-sinjalizimi/>



Bashkëpunimi dhe angazhimi me organizata të Shoqërisë Civile

Megjithëse nuk ka një dokument, i cili ti dedikohet një politikë e qartë për format e bashkëpunimit të prokurorisë me organizatat e shoqërisë civile, ky bashkëpunim nuk ka munguar.

Në rekomandimin e Rezolutës së Kuvendit specifikohet *“së bashku me strukturat përgjegjëse shtetërore, **organizatat e shoqërisë civile** dhe asistencën e nevojshme ndërkombëtare të kontribuojë në krijimin e një qasje të integruar të politikës penale në luftën kundër kriminalitetit si një nevojë tashmë imediate e shoqërisë sonë, me fokus parandalimin e kriminalitetit të të miturit dhe të rinjtë”*.

Prokuroria e Përgjithshme në vijim të mbikëqyrjes së zbatimit të udhëzimeve të përgjithshme nr. 5/2018¹³⁹ dhe nr. 17/2020¹⁴⁰ evidentohet se prokuroritë e juridiskionit të përgjithshëm dhe Prokuroria e Përgjithshme, kanë vijuar bashkëpunimin me organizata të shoqërisë civile, ndërkohë që me mbështetjen/asistencën e nevojshme ndërkombëtare është mundësuar krijimi i një alternative të politikës penale në luftën kundër dhunës tek të miturit në konflikt me ligjin dhe viktimë, ndërsa një politikë e ashpër ndaj dhunës në familje dhe ndaj të miturve si nevoja imediate me fokus parandalimin e kriminalitetit në këtë fushë.¹⁴¹

¹³⁹ Prokuroria e Përgjithshme, Udhëzim i Përgjithshëm Nr. 5 datë 26.10.2018 “Për garantimin e asistencës ndaj viktimave dhe dëshmitarëve të veprave penale”

¹⁴⁰ Prokuroria e Përgjithshme, Udhëzim i Përgjithshëm Nr. 17 datë 23.12.2020 “Për hetimin dhe ndjekjen penale

efektive të veprave penale kundër dhunës ndaj grave, dhunës në familje, dhe dhunës me bazë urrejtje”

¹⁴¹ Raport i Prokurorit të Përgjithshëm mbi gjendjen e kriminalitetit në Shqipëri për vitin 2022, fq. 47-48

Tabela IV: Vlerësimi i Indikatorëve që lidhen me TRANSPARENCËN, INTEGRITETIN dhe ETIKËN

Dimensioni	Nën-Dimensionet	Kategoritë	Indikatorët	Vlerësim negativ	Vlerësim i pjesshëm	Vlerësim pozitiv	Vlerësim i munguar
Transparenca/ Integriteti/Etika	Publiku dhe Media	Publikimi i informacionit mbi mbikyrjen e brendshme	Shërbimi i prokurorisë publikon informacion të përditësuar në lidhje me planet strategjike të punës				
			Shërbimi i prokurorisë publikon informacion të përditësuar në lidhje me raportet e monitorimit				
			Shërbimi i prokurorisë publikon dokumente të tjera që përmbajnë tregues të performancës së PP				
		Publikimi i Informacionit Financiar të Shërbimit të Prokurorisë	Shërbimi i prokurorisë publikon informacion të përditësuar në lidhje me zbatimin e buxhetit vjetor				
			Shërbimi i prokurorisë publikon informacion të përditësuar në lidhje me procedurat e prokurimit/procedurat konkurruese të koncesionit/partneritetit publikprivat				
			Shërbimi i prokurorisë publikon informacion të përditësuar në lidhje me auditimin financiar				
		Përgjegjshmëria ndaj kërkesave për informacion	Shërbimi i prokurorisë ka miratuar dhe bërë publik Programin e Transparencës				
			Të gjitha rubrikat e Programit të Transparencës janë të aksesueshme				
			Institucioni ofron përgjigje të shpejtë ndaj kërkesave për informacion				
			Institucioni ka mekanizma të brendshëm formal në lidhje me përgjigjet ndaj kërkesave për informacion				
			Institucioni zbaton afate të caktuara në lidhje me përgjigjen ndaj kërkesave për informacion				
			Përgjatë 3 viteve të fundit janë zbatuar në mënyrë korrekte afatet kohore që lidhen me kthimin e përgjigjeve ndaj kërkesave për informacion				
			Ekzistojnë udhëzime të qarta në rastet kur informacioni konsiderohet i rezervuar për shkak të privatësisë ose çështjeve të tjera që lidhen me sigurinë				
		Politika që lidhet me Publikun dhe Median	Shërbimi i prokurorisë ka publikuar listën e kontakteve të prokurorëve për marrëdhëniet me publikun				
			Shërbimi i prokurorisë ka publikuar kontaktet e koordinatorit për të drejtën e infomimit dhe formatet respektive të kërkesave dhe ankesave				
			Shërbimi i prokurorisë ka publikuar kontaktet e këshilltarit për median në Prokurorinë e Përgjithshme				

			Shërbimi i prokurorisë ka vendosur në zbatim programin institucional të transparencës				
			Shërbimi i prokurorisë ka protokollet e duhura për angazhimin me organet e medias				
			Ekzistojnë protokolle të shkruara të cilat ofrojnë udhëzime se kur dhe si personeli do të duhet të ndërveprojë me median				
			Protokollet adresojnë kërkesat që lidhen me konfidencialitetin dhe të drejtën e publikut për informim				
			Protokollet adresojne nevojën për të mbrojtur integritetin e procedimeve penale				
			Ekzistojnë protokolle për prokurorët dhe personelin në lidhje me përdorimin e medias sociale				
			Institucioni ka një departament të dedikuar për informimin e publikut ose një zëdhënës, i cili është i angazhuar me median në kuadër të një strategjie proaktive komunikimi				
			Prokurorët dhe personeli i prokurorisë marrin trajnim për të komunikuar në mënyrë efektive dhe të duhur me median, në mënyrë të veçantë në raste me interes të lartë kombëtar dhe publik				
	Integriteti dhe Etika e prokurorëve	Rregullat e Etikës dhe Sjelljes së Prokurorëve	Është finalizuar përzgjedhja e Këshilltarit për Etikën				
			Këshilltarit për Etikën ka hartuar, publikuar dhe përditësuar vazhdimisht një manual informues mbi çështje që lidhen me etikën				
			Këshilltarit për Etikën ka raportuar me shkrim, jo më pak se një herë në vit, përpara KLP lidhur me veprimtarinë e tij				
			Prokurorët dhe stafi i prokurorisë janë subjekt i rregullave të sjelljes profesionale dhe etike, të cilat bazohen në standarde të njohura ndërkombëtare për rregullat e sjelljes dhe etikës				
			Rregullat e sjelljes profesionale dhe etike kërkojnë që prokurorët dhe stafi prokurorisë të veprojnë në përputhje me standardet më të larta të integritetit, paanësisë dhe pavarësisë në interes të publikut				
			Rregullat përmbajnë dispozita të cilat kërkojnë shmangien e konfliktit të interesave dhe ndalimin e dhuratave, të cilat çenojnë paanësinë dhe pavarësinë				
			Rregullat ndalojnë prokurorët nga veprimi ose tendenca për të vepruar sipas udhëzimeve nga burime të jashtme, përfshirë interesa personale, sektoriale, politike dhe presione nga publiku dhe media				
Ekzistojnë rregulla për ruajtjen e konfidencialitetit të informacionit dhe mbrojtjen e privatësisë							

Mekanizma të tjerë anti-korrupsion	Trajnime mbi etikën dhe rregullat e sjelljes	Kodi/Rregullat janë të zbatueshme për të gjithë prokurorët, stafin dhe subjekte të tjera të kontraktuara				
		Prokurorët dhe stafi i prokurorisë kryejnë trajnim të thelluar, të detyrueshëm dhe periodik mbi standardet e etikës, integritetit dhe rregullat e sjelljes				
		Trajnimet fokusohen në risqet e korrupsionit ose perceptimit të korrupsionit				
		Trajnimet mbi etikën janë të detyrueshme dhe kërkohen për avancimin në karrierë të prokurorëve				
		Ekzistojnë përditësime periodike (të paktën një herë në vit) të moduleve të trajnimeve mbi etikën				
		Temat që lidhen me etikën dhe integritetin i kushtojnë një fokus të veçantë trajnimeve që lidhen me mbikqyrjen, menaxhimin ose lidhshirësinë				
	Mbrojtja e Sinjalizuesve	Shërbimi i prokurorisë ofron mbrojtje të plotë ndaj sinjalizuesve				
		Shërbimi i prokurorisë ka miratuar rregulla për mbrojtjen e sinjalizuesve, të cilat zbatohen tek të gjithë punonjësit e institucionit				
		Sinjalizuesve ndjehen në presione të formave të ndryshme me qëllim për ti penguar për të ngritur shqetësime ose adresuar ankesa				
		Anonimiteti i sinjalizuesit garantohet përgjatë procesit të hetimit				
		Ekzistojnë mekanizma, të cilët sigurojnë që nuk ka forma të ndryshme hakmarrje				
		Institucioni siguron imunitet në lidhje me masat disiplinore për personat që ngrenë shqetësime/ankesa të ndryshme				
		Institucioni është subjekt i masave disiplinore në lidhje me personat të cilët keqtrajtojnë sinjalizuesit				
		Përgjatë 3 viteve të fundit ka patur raporte të institucioneve, mbulime mediatike, procedime disiplinore në institucion ose padi që tregojnë se persona të cilët ankohen tek dikush i brendshëm në institucion janë për rrjedhojë viktimizuar, ngacmuar ose abuzuar				
	Në rast të rrezikimit të sigurisë së sinjalizuesit, ekziston një mekanizëm për vendosjen e personit në program mbrojtjeje					
	Angazhimi me Shoqërinë Civile	Institucioni angazhohet në mënyrë pro-aktive me organizatat e shoqërisë civile dhe publikun për të informuar publikun dhe marrë feedback nga grupet kryesore të komunitetit				
		Institucioni angazhohet në mënyrë aktive me grupe interesi të tillë si shoqata të avokatëve dhe profesionistë ligjorë, grupeve për të drejtat e njeriut ose shërbimeve për viktimat				
		Institucioni organizon takime të rregullta me grupet/aktorët e interesit				

			Institucioni merr feedback-un e komunitetit/grupeve të interesit mbi problematika/çështje/shqetësime të caktuara				
		Mbështetja e Mbikëqyrjes Civile të Institucionit	Shërbimi i prokurorisë pranon dhe bashkëpunon në drejtim të mbikëqyrjes civile të institucionit				
			Shërbimi i prokurorisë është i gatshëm të ofrojë informacion për organizatat e shoqërisë civile të cilat kryejnë studime/hulumtime, mbikëqyrje dhe monitorim ndaj institucionit, përfshirë buxhetin dhe analiza të të dhënave				
			Organizatat e shoqërisë civile (sidomos ato në fushën e drejtësisë) bashkëpunojnë dhe marrin pjesë në trajnimin e personelit të institucionit				
			Organizatat e shoqërisë civile të cilat ofrojnë asistencë ligjore/juridike për të pandehurit, të miturit ose persona të tjerë vulnerabël, ose viktimat e krimit, angazhohen në mënyrë konstruktive me institucionin e prokurorisë				



5. Efikasiteti dhe Performanca




Tabela V/A Standardet ndërkombëtare në lidhje me Efikasitetin dhe Performancën

<p>Statusi dhe roli i prokurorëve, Guida e Zyrës së Kombeve të Bashkuara për Drogën dhe Krimin dhe Shoqatës Ndërkombëtare të Prokurorëve (2014)</p>	<ol style="list-style-type: none"> 1. Menaxhimi i kujdesshëm dhe gjurmimi i çështjeve është thelbësor për të siguruar që të gjitha çështjet të gjykoen paanshmërisht dhe në zbatim të plotë të ligjit, ose të ndalohet procedimi penal pasi të jenë marrë në konsideratë aspekte ligjore të përshtatshme. 2. Llogaridhënia, transparenca dhe efektiviteti operacional kërkojnë që shërbimi i prokurorisë të jetë në gjendje të gjurmojë dhe të shpjegojë çfarë po bëhet me çdo dosje që është hapur ose mbyllur nga çdo zyrë në shërbimin e prokurorisë. Në shumicën e juridiksioneve, kjo do të kërkojë përpjekje të konsiderueshme nga ana e administratës së bashku me menaxhimin dhe vetë prokurorët për të siguruar që dosja të dokumentohet dhe ndiqet siç duhet gjatë gjithë jetës së saj, duke përfshirë edhe periudhën e arkivimit. Ka disa avantazhe të gjurmimit të dosjeve në këtë mënyrë: <ul style="list-style-type: none"> • Aftësia për të prodhuar statistika mbi dosjet që mund të ndihmojnë në përmirësimin e efikasitetit të shërbimit të prokurorisë, si dhe për të ofruar informacion mbi performancën dhe për të mbështetur përgjegjshmërinë publike. • Garantimi që prokurorët nuk mbingarkohen me dosje. • Garantimi që prokurorëve u caktohen dosje dhe një kohë e mjaftueshme për ta përgatitur me kujdes rastin. • Aftësia për të patur qasje të shpejtë në dosje për të informuar zyrtarët e lartë ose palët e interesuara të tilla si viktimat ose dëshmitarët rreth statusit të dosjes. • Aftësia për të shqyrtuar një dosje që është mbyllur për të parë cili ishte rezultati (p.sh., mbyllje për mungesë të provave,shfajësimi dhe në çfarë bazash, dënim dhe vendim, rekomandime për apel). • Aftësia për të ndarë kërkesa, vendime ose metodologji midis prokurorëve që kanë raste të ngjashme, me qëllim ndarjen e mësimave të nxjerra në mënyrë që ato të shpërndahen dhe të ndihmojnë në sigurimin e një përgjigje të qëndrueshme. • Aftësia për të prodhuar statistika mbi dosjet që mund të ndihmojnë në përmirësimin e efikasitetit të shërbimit të ndjekjes penale, si dhe në sigurimin e informacionit të performancës për të mbështetur llogaridhënien publike. 3. Rëndësia e mbajtjes së statistikave: <ul style="list-style-type: none"> • Normat e përfundimit të rasteve, veprimet të ndërmarra, numri i rasteve që trajtohen në ditë, javë, muaj ose vit mund t'i tregojnë shumë Prokurorit të Përgjithshëm mbi shpërndarjen e stafit, efikasitetin, mbi veprimet që duhen ndërmarrë dhe si mund të zgjidhen sfidat. • Shqyrtimi i kujdesshëm i numrit të çështjeve të trajtuara nga çdo prokuror dhe norma e përfundimit të tyre mund t'i japë informacion zyrtarëve të lartë mbi veprimet që duhet të ndërmarren. • Efikasiteti mund të arrihet thjesht duke siguruar që ngarkesa e punës së secilit prokuror të jetë e barabartë. • Statistikat gjithashtu mund të jenë të dobishme në adresimin e perceptimeve negative të grupimeve ose individëve lidhur me efikasitetin e prokurorisë. Statistikat i lejojnë prokurorisë të përgjigjet në mënyrë transparente duke forcuar kështu besimin e publikut 11. Luajnë një rol aktiv në procedurat penale, përfshirë institucionin e ndjekjes penale dhe, ku lejohet nga ligji ose në përputhje me praktikat lokale, në hetimin e krimit, mbikëqyrjen e ligjshmërisë të këtyre hetimeve, mbikëqyrjen e zbatimit të vendimeve gjyqësore dhe ushtrimin e funksioneve të tjera si përfaqësues të interesit publik. 12. Kryejnë detyrat e tyre në mënyrë të rregullt, konsistente dhe të shpejtë, dhe të respektojnë dhe mbrojnë dinjitetin e njeriut dhe të përmbajnë të drejtat e njeriut, duke kontribuar në sigurimin e procedurës së duhur dhe funksionimit tërësor të sistemit të drejtësisë penale.
--	---

14. Nuk duhet të nisin ose vazhdojnë ndjekjen penale, ose duhet të bëjnë përpjekje të mëdha për të ndaluar procedurat, kur hetimet objektive tregojnë që akuza është e paarsyeshme.
15. Duhet t'i kushtojnë vëmendje të duhur ndjekjes penale të krimeve të kryera nga zyrtarët publikë, veçanërisht korrupsionit, abuzimit të pushtetit, shkeljeve të rënda të të drejtave të njeriut dhe krimeve të tjera të njohura nga ligji ndërkombëtar dhe, ku lejohet nga ligji ose në përputhje me praktikat lokale, hetimit të këtyre veprave penale.
16. Ndërmarrë të gjitha hapat e nevojshme kur marrin në dorëzim prova kundër të dyshuarve që ata e dinë ose besojnë në mënyrë të arsyeshme se janë marrë përmes metodave të paligjshme, të cilat paraqesin një shkelje të rëndë të të drejtave të të dyshuarit, veçanërisht duke përfshirë torturë ose abuzime të tjera të të drejtave të njeriut. Në këtë rast, ata duhet të refuzojnë përdorimin e këtyre provave kundër kujtdo tjetër përveç atyre që kanë përdorur këto metoda, ose të informojnë Gjykatën për këtë, dhe duhet të ndërmarrin të gjitha hapat e nevojshëm për të siguruar që ata përgjegjës për përdorimin e këtyre metodave do të vendosen para drejtësisë.

Lidhur me rolin e prokurorëve në procedimet penale, standardet theksojnë se (4.2) prokurorët duhet të kryejnë një rol aktiv në procedurat penale si më poshtë:

- a. Kur lejohet të marrin pjesë në hetimin e krimit, ose të ushtrojnë autoritet mbi policinë ose hetuesit e tjerë, ata do ta bëjnë këtë në mënyrë objektive, të paanshme dhe profesionale;
- b. Kur mbikëqyrin hetimin e krimit, ata duhet të sigurojnë që shërbimet hetimore të respektojnë parimet ligjore dhe të drejtat themelore të njeriut;
- c. Kur japin këshilla, ata do të kujdesen të mbeten të paanshëm dhe objektiv;
- d. Në rastin e procedurave penale, ata do të veprojnë vetëm kur një rast është i bazuar mirë në prova që besohet se janë të besueshme dhe të pranueshme, dhe nuk do të vazhdojnë me ndjekjen penale në mungesë të këtyre provave;
- e. Gjatë zhvillimit të procedurave, rasti do të ndiqet me vendosmëri por në një mënyrë të drejtë; dhe jo më tepër se ç'tregojnë provat;

Neni 5 (b): Gjithashtu, nënvizohet që të sigurohet drejtësia dhe efektshmëria e ndjekjeve penale, prokurorët duhet t'u ofrojnë ndihmë shërbimeve të ndjekjes penale dhe kolegëve të juridiksione të tjera, në përputhje me ligjin dhe me një frymë bashkëpunimi reciprok.

Neni 39: Për më tepër theksohet nxitja e bashkëpunimit ndërmjet prokurorëve në përgjithësi, ndërgjegjësimi për nevojën e pjesëmarrjes aktive në bashkëpunimin ndërkombëtar, dhe specializimin e disa prokurorëve në fushën e bashkëpunimit ndërkombëtar.

Raportit “Mbi standardet evropiane lidhur me pavarësinë e sistemit gjyqësor: Pjesa e II – Shërbimi i Prokurorisë”, adoptuara në datë 17-18 Dhjetor 2010, nga Komisioni i Venecias”

Rekomandim (2000) 19, “Mbi rolin e prokurorisë

Neni 37: Këshilli i Europës nxis bashkëpunimin ndërkombëtar gjyqësor, nëpërmjet nxitjes së kontaktit direkt midis prokurorëve të shteteve të ndryshme, brenda kuadrit të marrëveshjeve ndërkombëtare nëse ato ekzistojnë, ose në bazë të marrëveshjeve praktike.

publike në sistemin e drejtësisë penale”

Theksohet rëndësia e ndërmarrjes së disa hapave në fusha të ndryshme për të nxitur kontaktet direkte midis prokurorëve në kontekstin e bashkëpunimit ndërkombëtar gjyqësor. Hapat e tilla duhet të përfshijnë në veçanti:

- a. përcjelljen e dokumentacionit;
- b. përgatitjen e një liste me të dhënat e personave të kontaktit në autoritetet e ndjekjes penale të shteteve të ndryshme;
- c. krijimin e kontakteve personale të rregullta midis prokurorëve nga vende të ndryshme, veçanërisht përmes organizimit të takimeve të rregullta midis Prokurorëve të Përgjithshëm;
- d. organizimin e seancave trajnuese dhe ndërgjegjësuese;
- e. zhvillimin e funksionit të oficerëve të ndërlidhjes ligjore të vendosur në një vend të huaj;
- f. trajnimin në gjuhë të huaja;
- g. përdorimin e transmetimit elektronik të të dhënave;
- h. organizimin e seminareve me shtete të tjera, lidhur me ndarjen e ndihmës reciproke dhe çështjeve të përbashkëta kriminale.



5.1. Planifikimi Strategjik

Hartimi dhe zbatimi i një strategjie për sistemin e prokurorisë, e cila të përfshijë një plan strategjik të shoqëruar me plane operacionale veprimi dhe të përmbajë tregues të qartë për performancën si dhe burimet e nevojshme njerëzore, materiale dhe financiare është vlerësuar si një hap i rëndësishëm dhe thelbësor në nxitjen e një performace efçente të shërbimit të prokurorisë.¹⁴²

Legjislacioni parashikon që Këshilli i Lartë i Prokurorisë, në bashkëpunim me Ministrin e Drejtësisë, harton, miraton dhe zbaton një plan strategjik për sistemin e prokurorisë në koordinim me strategjinë e sektorit të drejtësisë dhe sipas kriterëve të përcaktuara,¹⁴³ ndërkohë që dispozitat ligjore nuk parashikojnë në mënyrë të specifikuar përfshirjen e prokurorisë në hartimin e këtij dokumenti. Bazuar në sa më lart, Këshilli i Lartë i Prokurorisë ka miratuar Planin Strategjik 2021 – 2024 për Këshillin e Lartë të Prokurorisë, i cili përcakton objektivat strategjike të Këshillit për këtë periudhë kohore. Objektivat përfshijnë përpjekjet për sigurimin e: (i) pavarësisë; (ii) llogaridhënies; (iii) meritokracisë dhe objektiv jo i drejtpërdrejtë (iv) efçencën e prokurorëve në Republikën e Shqipërisë.

Komisioni i Planifikimit Strategjik, i Administrimit dhe Buxhetit pranë KLP-së është struktura e cila është planifikuar të realizojë planifikimin dhe monitorimin e strategjisë nën mbikëqyrjen e KLP. Megjithëse strategjia gjendet e publikuar në faqen zyrtare të KLP nuk gjenden të publikuara raporte, të cilat pasqyrojnë të dhëna dhe një informacion më të detajuar mbi monitorimin e strategjisë.¹⁴⁴

PP ka miratuar përgjatë viteve 2015-2020 Strategjinë Afatmesme të Prokurorisë së Përgjithshme 2015-2017 dhe 2018-2020 si dhe planet respektive të veprimit.¹⁴⁵ Pas kësaj periudhe nuk rezultojnë të ketë një strategji për periudhën në vijim. Pavarësisht se strategjia parashikonte ngritjen e Grupit të Punës të kryesuar nga Kabineti i Prokurorit të Përgjithshëm, i cili raportonte me shkrim çdo 6 muaj tek Prokurori i Përgjithshëm duke pasqyruar progresivisht shkallën e realizimit të masave për çdo gjashtëmuaj, nuk ka të publikuara raporte, të cilat pasqyrojnë nivelin e plotësimit të objektivave të parashikuara.

Strategjia afatmesme e Prokurorisë së Përgjithshme 2018-2020 përfshinte 7 objektiva kryesore: 1) rritjen e efektivitetit të hetimit; 2) forcimin e luftës ndaj korrupsionit dhe krimit të organizuar; 3) forcimin e bashkëpunimit me partnerët ndërkombëtarë; 4) forcimin e integritetit dhe garantimin e pavarësisë së prokurorit; 5) respektimin e të drejtave të njeriut; 6) forcimin e besimit të publikut në funksionimin e organeve shtetërore, nëpërmjet zbatimit rigoroz të kuadrit ligjor për dekriminalizimin dhe 7) rritjen e transparencës në komunikimin dhe marrëdhëniet me publikun.

Ndërkohë, prokuroria është pjesë e Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë dhe Planit të Veprimit të saj 2022-2025,¹⁴⁶ e cila parashikon për zbatim gjatë 5 viteve të implementimit të saj 17 Objektiva Specifikë dhe 184 masa. Bazuar në raportin e monitorimit për vitin 2022, përgjatë këtij viti nga 16 Objektivat Specifike, 1 është zbatuar plotësisht, 13 janë zbatuar pjesërisht dhe 2 objektiva nuk janë zbatuar. Pavarësisht se në progres nga viti i kaluar objektivi specifik 3.2 që lidhet me një sistem prokurorie efikas dhe proaktiv që funksionon sipas standardeve evropiane me qëllim hetimin dhe ndjekjen efikase të korrupsionit dhe krimit të organizuar rezultojnë të jetë realizuar pjesërisht.

Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka përgatitur gjithashtu “Planin Strategjik dhe planin e veprimit për Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë 2020-2022”, i cili përmban 4 objektiva kryesorë strategjike dhe 15 objektiva specifikë/nën-objektiva, 44 aktivitete/masa dhe 2 indikatorë nga Pasaporta e Indikatorëve/Treguesve (sipas SND). Duhet theksuar se ILD është i vetmi institucion, i cili ka publikuar raportin vjetor mbi zbatimin e planit strategjik dhe planit të veprimit për periudhën janar-dhjetor 2021, ndërkohë që nuk është publikuar ende raporti i monitorimit të strategjisë për vitin 2022.

Duke qenë se objektivat dhe drejtimet prioritare të veprimit të prokurorisë si edhe masat/aktivitetet për zbatimin dhe monitorimin e tyre janë të përfshira në një sërë dokumentash të tjerë strategjik dhe planesh veprimi evidentohet si i nevojshëm unifikimi në një dokument të plotë strategjik dhe të njehsuar i të gjitha objektivave në përputhje me masat/aktivitetet dhe treguesit.

¹⁴² OECD (2021), Performance of the Prosecution Service in Latvia, A comparative Study, Chapter 4

¹⁴³ Ligj 115/2016, Neni 180

¹⁴⁴ Këshilli i Lartë i Prokurorisë, “Plani Strategjik 2021 – 2024 për Këshillin e Lartë të Prokurorisë”

¹⁴⁵ Prokuroria e Përgjithshme, Dokumente, Strategji:

<https://www.pp.gov.al/Dokumente/Strategji/>

¹⁴⁶ VKM nr. 823, datë 24.12.2021 “Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë 2021-2025 dhe Planit të saj të Veprimit”



5.2. Roli i Prokurorëve në Procedimet Penale dhe bashkëpunimi me Policinë Gjyqësore

Kushtetuta sanksionon se Prokuroria ushtron ndjekjen penale si dhe përfaqëson akuzën në gjyq në emër të shtetit.¹⁴⁷ Kodi i Procedurave Penale parashikon rregullat e zhvillimit të procedimit penal në të gjitha fazat e tij, duke filluar nga hetimi, gjykimi, nxjerrja e vendimit dhe zbatimi i vendimit. Prokurori drejton dhe kontrollon hetimet paraprake dhe veprimtarinë e policisë gjyqësore, kryen vetë çdo veprim hetimor që e çmon të nevojshëm, si dhe ushtron funksionet e bashkëpunimit gjyqësor me autoritetet e huaja, sipas rregullave të caktuara në KPP.¹⁴⁸

Kodi i Procedurave Penale sanksionon se ndjekjet penale fillohen nga prokurorët ose me nismën e tyre ose në bazë të kallëzimeve penale të marra nga qytetarët, zyrtarët shtetërorë, personeli mjekësor, etj., të cilat ose paraqiten drejtpërdrejt në prokurori ose në Policinë e Shtetit, e cila ia referon ato më pas prokurorisë.¹⁴⁹ Legjislacioni përcakton se prokurori ka të drejtë të mos fillojë ndjekjen penale, të pushojë akuzat apo çështjen, t'i kërkojë gjykatës pushimin e akuzave apo të çështjes, të kërkojë dërgimin e çështjes për gjykim, si dhe të lidhë marrëveshje bashkëpunimi ose marrëveshje në kushtet e pranimit të akuzave.

Kuadri ligjor ekzistues nuk e kufizon mundësinë që prokurori të kërkojë sqarime përpara se të vendosë fillimin e një procedimi. Nga njëra anë, këto sqarime nuk përbëjnë kërkesë për kryerjen e veprimeve të tjera hetimore, por më shumë përqëndrohen në informacionin dhe provat që policia ka mbledhur para depozitimit të referimit dhe që mund të mos jenë ndarë me prokurorin. Nga ana tjetër, për të regjistruar një procedim, prokurori duhet të sigurohet që të mos ketë pengesa ligjore për fillimin e një procedimi.

Legjislacioni identifikon tri faza kryesore gjatë hetimit, përkatësisht: (i) planifikimi i hetimit, (ii) kryerja e hetimit dhe (iii) mbyllja e hetimit. Secila prej këtyre fazave ka specifikat e veta që kërkojnë qasje të ndryshme të rolit drejtues nga ana e prokurorit. Legjislacioni përcakton rolin drejtues të prokurorit në

menaxhimin e çështjeve. Roli drejtues i prokurorit është një pozicion menaxherial që kryhet gjatë hetimit, i cili përfshin organizimin e përgjithshëm të hetimit, drejtimin e veprimeve hetimore dhe mbikëqyrjen e zhvillimit të çështjes duke siguruar zbatimin e duhur të të gjitha rregullave procedurale.¹⁵⁰

Pas përfundimit të hetimeve paraprake, prokurori ose ndërmerr veprime për pushimin e akuzave apo të çështjes ose e dërgon çështjen për gjykim. Që të dyja këto veprime kryhen me vendim të gjykatës dhe kërkojnë seanca paraprake në sesione të hapura. Në këtë fazë, gjykata mund të vlerësojë se hetimet paraprake janë të paplota dhe të urdhërojë përfundimin e tyre, duke dhënë orientimet e duhura dhe, nëse është e nevojshme, veprimet që duhet të kryhen, duke përfshirë përsëritjen e akteve të pavlefshme dhe provave të papërdorshme nëse është e mundur.

Megjithëse rritja e rolit proaktiv të prokurorit ka qenë një nga rekomandimet e përsëritura, roli i prokurorëve në iniciimin e procedimeve penale me nismën e tyre mbetet i ulët. Gjithashtu një nga problematikat ende prezente mbetet koordinimi dhe bashkëpunimi efikas i prokurorëve me oficerët e policisë gjyqësore.

Ligji i ri për organizimin dhe funksionimin e policisë gjyqësore i miratuar në vitin 2019 pati si qëllim të adresonte një sërë mangësish të mëparshme të evidentuara në veprimtarinë e oficerëve të policisë gjyqësore, duke përmirësuar organizimin strukturor dhe funksional të policisë gjyqësore, si dhe duke rikonfirmuar rolin e prokurorit si drejtues i hetimeve paraprake.¹⁵¹ Pavarësisht këtyre ndryshimeve policia gjyqësore vazhdon të mbetet një nga pikat e dobëta të sistemit të prokurorisë, ndërkohë që për shkak të dinamikave të krijuara pas ndryshimeve që solli reforma në sistemin e drejtësisë marrëdhëniet dhe bashkëpunimi me prokurorët paraqet sfida të ndryshme.

Disa prej këtyre sfidave përfshijnë: lëvizjen e shpeshtë të oficerëve të policisë së shërbimeve në Policinë e Shtetit; shkeljet e konfidencialitetit; varësinë e dyfishtë të oficerëve të policisë të shërbimeve; ngarkesën e ekzagjeruar të oficerëve të policisë së shërbimeve e cila shihet si pasojë e mungesës së numrit të mjaftueshëm të personelit të

¹⁴⁷ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Neni 148, pika 1 (Ndryshuar me Ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016)

¹⁴⁸ Po aty, Neni 24

¹⁴⁹ Po aty, Nenet 304 - 317

¹⁵⁰ OSBE, (2020), Manual për Prokurorinë, Roli Drejtues i Prokurorit, fq. 49

¹⁵¹ Kuvendi i Shqipërisë, Relacion Për Projektligjin "Për Organizimin dhe Funksionimin e Policisë Gjyqësore"



kualifikuar në policinë e Shtetit dhe në agjenci të tjera qeveritare që merren me hetime; mungesën e një sistemi vlerësimi apo mekanizmi para regjistrimit apo dorëzimit të raporteve të policisë në prokurori të cilat janë të pakënaqshme; mungesën e trajnimeve të përshtatshme, të mjaftueshme dhe të përbashkëta me prokurorët.¹⁵²

Pavarësisht disa hapave pozitiv të ndërmarrë në drejtim të vlerësimit objektiv dhe rritjes së performancës dhe raportimit të oficerëve të policisë gjyqësore,¹⁵³ nevojitet forcimi i bashkëpunimit ndërmjet palëve dhe të kuptuarit qartë të roleve. Njëkohësisht nevojitet të përmirësohet cilësia e referimit të çështjeve si edhe komunikimi nëpërmjet krijimit të modeleve dhe protokolleve për komunikim por edhe vlerësimit të punës.¹⁵⁴ Masa të tjera në funksion të këtij bashkëpunimi lidhen me përmirësimin e aspekteve ligjore, organizative si dhe ndërtimin dhe forcimin e kapaciteteve të oficerëve të policisë gjyqësore.¹⁵⁵

5.3. Statistikat dhe Menaxhimi i Çështjeve

Sikurse është evidentuar edhe më parë në këtë studim,¹⁵⁶ përmirësimi dhe bërja tërësisht funksionale e aspekteve që lidhen me kapacitetet teknologjike, ku përfihen edhe statistikave dhe sistemet për menaxhimin e çështjeve, përbëjnë një sfidë për thujtë të gjitha institucionet e drejtësisë.¹⁵⁷ Ndryshimet ligjore të ndërmarrë në kuadër të reformës në drejtësi parashikojnë ngritjen e një sistemi të statistikave. Përkatësisht, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë¹⁵⁸ parashikon krijimin dhe mbarëvajtjen e strukturave të teknologjisë së

V. Efikasiteti dhe Performanca

informacionit në prokurori përmes një vendimi të Këshillit të Ministrave.

Ndërkohë, Ligji “Për organet qeverisëse të sistemit të drejtësisë”,¹⁵⁹ parashikon zhvillimin e sistemit të teknologjisë së informacionit që do të sigurojë akses të plotë për Inspektorët e Lartë të Drejtësisë në të dhënat që përmban i gjithë sistemi i teknologjisë së informacionit në lidhje me Këshillin e Lartë Gjyqësor, gjykatat, Këshillin e Lartë të Prokurorisë dhe prokuroritë.

Ligji parashikon që derisa sistemi elektronik i menaxhimit të çështjeve të jetë plotësisht funksional, Këshilli i Lartë i Prokurorisë mundëson menaxhimin e çështjeve gjyqësore me mjete të tjera.¹⁶⁰ Për më tepër, legjislacioni përcakton ngritjen e Qendrës për Teknologjinë e Informacionit për Sistemin e Drejtësisë¹⁶¹ pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor. Qendra synon të mbështesë sistemin e informacionit në organet e drejtësisë duke përfshirë ndër të tjera prokurorinë dhe KLP-në. Gjithashtu, janë miratuar edhe rregullat për organizimin, funksionimin dhe kompetencat e qendrës.¹⁶² Theksojmë se, faqja e internetit e Qendrës është ende në ndërtim dhe nuk mund të merret mjaftueshëm informacion rreth funksionalitetit të saj dhe standardeve.¹⁶³

Mbajtja, plotësimi dhe raportimi i të dhënave statistikore në prokurori është i rregulluar ligjërisht.¹⁶⁴ Prokuroritë mbajnë të dhëna statistikore 3-mujore, 6-mujore, 9-mujore dhe vjetore. Nga ana tjetër, Prokurori i Përgjithshëm publikon brenda muajit mars të çdo viti, raportin vjetor mbi ngarkesën e punës së prokurorive për vitin kalendarik paraardhës¹⁶⁵ si dhe dërgon periodikisht në Ministrinë e Drejtësisë evidenca statistikore¹⁶⁶. Mirëpo, për shkak të mungesës së sistemit elektronik

¹⁵² OSBE (2019), Rritja e bashkëpunimit dhe koordinimit ndërmjet prokurorisë dhe policisë gjyqësore në Shqipëri, faqe 39-41

¹⁵³ Prokuroria e Përgjithshme, Udhëzim i Përgjithshëm nr 10/2021 i përditësuar "Për ushtrimin e funksionit të monitorimit në sistemin e prokurorisë dhe bashkëpunimin me institucionet kushtetuese dhe ligjore", Neni 8

¹⁵⁴ OSBE, (2020), Manual për Prokurorinë, Roli Drejtues i Prokurorit, fq. 98-103

¹⁵⁵ OSBE (2019), Rritja e bashkëpunimit dhe koordinimit ndërmjet prokurorisë dhe policisë gjyqësore në Shqipëri, faqe 42-43

¹⁵⁶ Pika 3.5., Kapacitetet Teknologjike

¹⁵⁷ SND 2021-2025, Raporti i Monitorimit 2022, Objektivi Specifik 4.1.

¹⁵⁸ Neni 148/b, pika c

¹⁵⁹ Ligj nr. 115/2016 “Për organet qeverisëse të sistemit të drejtësisë”, Neni 92

¹⁶⁰ Po aty, Neni 281 (Ngritja e strukturave administrative dhe organizative të Këshillit të Lartë të Prokurorisë)

¹⁶¹ Vendimi Nr. 971, datë 2.12.2020 Për miratimin e rregullave për politikën e përgjithshme shtetërore, për sistemin e teknologjisë së informacionit, për sistemin e drejtësisë

¹⁶² Vendim Nr. 972, datë 02.12.2020 Për organizimin, funksionimin e përcaktimin e kompetencave të qendrës së teknologjisë së informacionit për sistemin e drejtësisë

¹⁶³ Qendra e Teknologjisë së Informacionit për Sistemin e Drejtësisë: <https://qti.al/>, Aksesuar më 03.06.2023

¹⁶⁴ Urdhër i Prokurorit të Përgjithshëm nr. 284, datë 19.12.2002, plotësuar me urdhërin nr. 104, datë 24.03.2023

¹⁶⁵ Ligj nr. 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, neni 19, pika 1

¹⁶⁶ Po aty, neni 38, pika 2, gërma “h”



të menaxhimit të dosjeve, të dhënat në zyrat e prokurorive hidhen manualisht dhe kjo pengon gjenerimin e të dhënave të sakta statistikore.¹⁶⁷ Gjithashtu, mbështetur në raportimin e Prokurorit të Përgjithshëm, evidentohen probleme me të dhënat statistikore periodike që prokuroritë e rretheve i përcjellin Prokurorit të Përgjithshëm.

Sistemi CAMS për shkak të gjendjes së përgjithshme teknike jashtë funksionimit nuk mundëson asnjë veprimtari tjetër të teknologjisë së informacionit në administrimin e çështjeve apo të dhënave statistikore në prokurori. Kuvendi i Shqipërisë ka akorduar një fond për Prokurorinë e Përgjithshme, si fazë e parë për investimin/ngritjen e sistemit të menaxhimit të çështjeve (CAMS), në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm.¹⁶⁸ Bazuar në raportimin e Prokurorit, vërehet se puna është në fazën e mbledhjes së të dhënave për sistemin e ri CAMS, draftimin e tyre për standartizimin final të termave të referencës për këtë sistem dhe integrimin e sistemit IMPRO në Prokurorinë e Përgjithshme me sistemin M-File të Ministrisë së Drejtësisë dhe me sisteme të tjera ndërvepruese.¹⁶⁹

Ndërkohë, sistemi e-tracking PRESTO i cili filloi funksionimin në vitin 2021 është konsideruar një fazë e ndërmjetme, për të mundësuar zhvillimin e mëtejshëm të programit PRESTO për përfitimin e një sistemi statistikor që do të mundësojë përfitimin e të dhënave statistikore për gjithë grupveprat penale, deri në ngritjen e sistemit të ri CAMS.¹⁷⁰ Në sistemin elektronik e-tracking PRESTO, përditësohet brenda ditës ecuria e veprimeve procedurale penale për secilin kallëzim/referim dhe/ose çështje penale dhe/ose procedim/hetim pasuror, sipas fazave të procedimit dhe tipologjive përkatëse, me synim për të përfutur të dhëna statistikore gjithëpërfshirëse, të hollësishme dhe të besueshme, si dhe për të analizuar dhe evidentuar arritjet dhe problematikat për këtë grupveprash penale.¹⁷¹

Në vitin 2022 u parashikua gjithashtu vënien në funksionim e sistemit elektronik (SVHOPGJP) për oficerët e policisë gjyqësore të seksioneve në prokurori, për plotësimin/hedhjen e numrit të veprimeve hetimore që kryejnë për secilin procedim

penal apo procedim/hetim pasuror, me synim administrimin e të dhënave dhe përfitimin e statistikave periodike 15 ditore, me të dhëna për numrin e veprimeve hetimore apo ekzekutimin e vendimeve gjyqësore penale në kuadrin e procedimit penal ose për numrin e veprimeve verifikuese pasurore në kuadrin e procedimit pasuror, të kryera nga secili oficer i policisë gjyqësore të seksionit në prokuroritë përkatëse.¹⁷² Sistemi elektronik, mundëson administrimin e punës të secilit oficer të policisë gjyqësore të seksioneve në prokurori, ashtu dhe monitorimin periodik jo më pak se dy herë në muaj të ngarkesës dhe disiplinës në punë gjatë veprimtarisë së tyre nga strukturat mbikëqyrëse.

Vërehet se sistemi ICMIS përdoret në mënyra të ndryshme nga gjykatat, prokuroritë, policia dhe zyrat e përmbarimit, të cilat raportojnë shifra të ndryshme kur vjen fjala tek çështjet e korrupsionit (çështje të iniciuara nga policia, të ndjekura nga prokuroria dhe të gjykuara nga gjykatat).¹⁷³

5.4. Matja e Performancës të Shërbimit të Prokurorisë

Raporti vjetor i Prokurorit të Përgjithshëm për vitin 2022 evidenton se në kuadrin ligjor në fuqi ka një boshllëk ligjor në drejtim të vlerësimit të performancës së prokurorive me juridiksion të përgjithshëm, e cila ndryshon nga vlerësimi individual i performancës së drejtuesve apo prokurorëve.

Nga ana tjetër raporti thekson se vlerësimi i performancës së prokurorisë kërkon një përfshirje më të madhe të Prokurorit të Përgjithshëm në procesin e llogaridhënies dhe evidentimit të përgjegjësive në zbatimin e masave administrative e organizative, për sa kohë ka impakt mbi funksionimin në përditshmërinë e aktivitetit të prokurorive me juridiksion të përgjithshëm.

Nisur nga sa më sipër ndër objektivat prioritarë në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2023 përfshihet edhe rritja më tej e veprimtarisë monitoruese për zbatimin e udhëzimeve të përgjithshme të

¹⁶⁷ Këshilli i Lartë i Prokurorisë, Raporti Vjetor 2022

¹⁶⁸ Ligj nr. 85/2022 "Për buxhetin për vitin 2023"

¹⁶⁹ Prokuroria e Përgjithshme, Raport i Prokurorit të Përgjithshëm mbi gjendjen e kriminalitetit në Shqipëri për vitin 2022

¹⁷⁰ Po aty

¹⁷¹ Po aty

¹⁷² Udhëzimi i përgjithshëm nr. 4/2022, datë 18.10.2022

"Për disa shtesa në udhëzimin e përgjithshëm nr. 10/2021, datë 30.12.2021 "Për ushtrimin e funksionit të monitorimit në sistemin e prokurorisë dhe bashkëpunimin me institucionet kushtetuese dhe Ligjore"

¹⁷³ Këshilli i Evropës (2019), Udhëzues për zbatimin e instrumenteve të përzgjedhura CEPEJ në Republikën e Shqipërisë, fq. 12



detyrueshme¹⁷⁴ dhe e bashkëpunimit me ILD dhe KLP në drejtim të problemeve të performancës së zyrave të prokurorive.

Krijimi i një mekanizmi i cili të bëjë të mundur monitorimin e realizimit të objektivave të institucionit të prokurorisë në tërësi dhe efektivitetin në arritjen e rezultateve konkrete përbën një aspekt kyç të matjes së performancës, ndërkohë që përdoret si një instrument në shumë prej vendeve në Evropë.¹⁷⁵

5.5. Bashkëpunimi Ndërkombëtar

Për shkak të dinamikës dhe shtrirjes që ka pësuar ndër vite krimi i organizuar, nevoja për t'ju përgjigjur në mënyrë efektive këtij fenomeni ka sjellë që bashkëpunimi gjyqësor në çështjet penale të jetë një nga objektivat por edhe nevojat kryesore të Shqipërisë. Ky bashkëpunim rregullohet nga disa ligje përfshirë Kodin Penal, Kodin e Procedurës Penale dhe Ligjin për Marrëdhëniet Juridiksionale me Autoritetet e Huaja në Çështjet Penale.

